

Për t'u ringjallur si bashkësi

Në shpirt kishte bashkësinë

Kurani i fal jetë shoqërisë

Pendimi dhe loti

Zgjohu rini

Osmanët

Xhamia e Parrucës



Uniteti i muslimanëve

Editorial

I dashur lexues!

Ankesa jonë e përbashkët është mungesa e autoritetit të bashkësisë. Problemi i përbashkët i bashkësisë është mosarritja e një mirëkuptimi, pra është problemi i gjuhës. Besimtarët që mbushin dy qytetet e paprekshme me rastin e haxhit, kup-tohen në lutje dhe adhurime. Ata ndajnë të njëjtat lutje, por është me dyshim nëse i ndajnë të njëjtat halle dhe telashe. Secili përpiqet të mos lëndojë njëri-tjetrin, të pasqyrojë dhembshuri të njëri-tjetri me sytë e tyre dhe të transmetojë ndjenja dashurie, por kjo nuk ecën më tutje. Që në fazën e njohjes bile lëkundën. Njëri-tjetrin e njohin vetëm për nga vendlindja, ndoshta edhe pak nga emri, por nuk arrijnë t'i qajmë hallet njëri-tjetrit. Muslimani i Evropës nuk arrij t'ia shpjegoj problemet dhe vështirësitë e muslimanëve të Evropës. Afrikani nuk arrin ta shpjegojë Tunizinë. Ndërkohë sa shumë dëshirojnë që të merren vesh dhe ta informojnë njëri-tjetrin. Këtë bashkësi duhet ta bëjmë të kuptueshëm për njëri-tjetrin. Po çështjet e përbashkëta të Islamit si do të fliten? Një gjuhë e përbashkët dhe kjo ma merr mendja duhet të jetë një kërkesë e përbashkët e "të ftuarve të Mëshiruesit". Një gjuhë e përbashkët dhe padyshim që fillimisht është gjuha e Kuranit. Fëmijët tanë duhet patjetër ta mësojnë këtë. Ata nuk duhet ta ndiejnë shkaputjen nga kjo botë e madhe. Edhe bashkësia mund të arrijë në një forcë të plotë vetëm me një gjuhë të përbashkët. Koha jonë është koha e informacionit, por ne nuk kemi arritur akoma në çështjet e botës Islame.

Një nga dobësitë themelore të bashkësisë është mungesa e dijes dhe e përvojës. Duke mos e njohur mirë Islamin nuk mund t'i dimë as adhurimet, as etikën, as traditën dhe as përvojën. Ne jemi të painformuar për drejtësinë dhe sistemin e drejtësisë në Islam. Ata që dimë zakonisht janë një material i trashëguar ndaj të cilit nuk jemi të vetëdijshëm. Është i nevojshëm një material informimi i gjerë. Bashkësia duhet të edukohet me dashuri.

Sikur ta shndrisim këtë forcë në shpirtrat e vëllezërve në vendin tonë... Sikur ta fshehim pastrimin dhe forcimin në shpirtrat tanë si një porosi që duhet të mos priset për gjithë jetën... Nëse shpirtrat tanë sillen rreth kësaj ndjenje pastrimi... Nëse i fshehim brenda nesh Qaben dhe Arafatin... Ja pra, kështu hapet rruga e bashkësisë së madhe... Ajo është edhe bashkësia e lartësuar...

Në këtë numër do të lexoni:

Për t'u ringjallur si bashkësi

Ahmet Tashgetiren

Është shkëlqimi... ndjenja dhe besimi në sytë e fëmijës, ndoshta dhe disa muajsh, që qëndron në shpatullat e ba-bait, i cili sillet rreth Qabes me tavaf...

4



Për t'u ringjallur si bashkësi
Ahmet Tashgetiren

8 | Koshienca për të qenë nga bashkësi e Muhamedit (a.s.)
Asuman Dogru

Identiteti islam dhe dinamizmi i bashkësisë muslimane

Ismail Lytifi Çakan

Si fillim mendojmë se duhet të ndalemi mbi dy shprehje që gjenden në tekstin e hadithit. Shprehja profetike se "kënaqësia e Allahut ndaj diçkaje"...

18



Në shpirt kishte bashkësinë
Xhafer Durmush

16 | Grupim njerëzish apo bashkësi
Ekrem Sagiroglu

Identiteti islam dhe dinamizmi i bashkësisë muslimane
Ismail Lytifi Çakan

22 | Kurani i fal jetë shoqërisë
Mahmut Toptash

Vëllazëri apo bashkim?

Evans Drishti

Fakti që ne jemi besimtarë do të thotë që kemi arritur në një pjekuri të tillë që të kuptojmë më së miri disa aspekte mjaft të rëndësishme të jetës...

25



Vëllazëri apo bashkim?
Evans Drishti

28 | Vëllazëria në Islam
Naim Drijaj

Pendimi dhe loti

Osman Nuri Topbash

Siç shihet edhe në këtë tregim, robërit kanë një mijë e një pengesa të kësaj bote, më e keqja prej të cilave është shtyrja për më vonë pendimin e synqertë.

32



Ajete dhe hadithe
Naim Drijaj

32 | Pendimi dhe loti
Osman Nuri Topbash

Ftesa Kuranore për unitetin e gjithë njerëzimit
Zymer Ramadani

38

Viti: III Numri: 15

Nëntor - Dhjetor 2008

Dhul kade - Dhul hixhe 1429

Boton

Progresi Sh.p.k:

Shkodër / Shqipëri

Përkthyes:

Adelina Muça
Alban Kali
Ali Bardhi
Artur Tagani
Elona Sytari
Elvira Puka
Ermal Nurja
Evans Drishti
Edvin Lohja
Klementina Rrepa
Naim Drijaj

Redaktor: gjuhësor-letrar:

Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Nëntor - Dhjetor 2008

|41| Zgjohu rini!
Gëzim Meaj

| |

Feja burimore (primordiale)
e njeriut si bazë e feve të
shpallura
Nexhat Ibrahim

|42|

| |

|44| Kurani dhe shkencën në
krijimin e planetit të Tokës
Ibrahim Ramja

| |

Osmanët
Evans Drishti

|48|

| |

|52| Artet islame
Ali Bardhi

| |

Relikte historike
Islam Dizdari

|54|

| |

|58| Aktualitet
Ermal Nurja

| |

Shëndeti dhe familja
Naim Drijaj

|60|

| |

|62| Teknologji
Ali Bardhi

| |

| |

| |

| |

| |

| |

| |



**Feja burimore (primordiale) e njeriut
si bazë e feve të shpallura**
Nexhat Ibrahim

Studimi i feve të mëdha botërore tregon se ato posedojnë bazën e përbashkët doktrinare por edhe historike,...

42



Osmanët
Evans Drishti

Popujt dhe kombet i japin vazhdimësi vitalitetit të tyre në skenën e historisë në sajë të elementëve të vetëdijshëmërisë besimorë-fetare...

44



Xhamia e Parrucës (Relikte historike)
Islam Dizdari

Shkodra është qytet mijëra vjeçar, në historinë kombëtare zë një vend nderi. Në mugëtirën e shekujve

54



Shëndeti dhe familja
Naim Drijaj

Deklarohet se zemra artificiale e ideuar për të shmangur vështirësitë në dhurimin e organit do të bëhet gati për provat klinike në vitin 2011.

60

Adresa:

L: Vasil Shanto Rr: Çajupi
Shkodër

Tel: +355 69 20 76 768

Shtyp: ArbëriaDesign, Tetovë

Tel: +389 44 35 33 71

Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@hotmail.com

etikaeditor@yahoo.com

Çmimi: 1 Euro / 150 Lek / 60 DEN

Ngjyra: Progresi

Tel: +355 69 20 76768

+355 67 20 86767

Për t' u ringjallur si bashkësi

Ditët e haxhit janë çaste dhe momente ku besimi përjetohej si një ujvarë ndjenjash... Ata që janë duke i dhënë lamtumirën fëmijëve të tyre sypërloitur në vendlindje për pak sa nuk nisnin të qajnë duke bërë dua tek buzët e tyre belbëzojnë. Është shkëlqimi... ndjenja dhe besimi në sytë e fëmijës, ndoshta dhe disa muajsh, që qëndron në shpatullat e babait, i cili sillet rreth Qabes me tavaf...

Janë drithërimat e shpirtrave që duken në dhikrin që fillon me ilahi në autobus dhe që kurorëzohet me fjalën hyjnore... Janë lotët që përzihen me belbëzime... Ndjenja.. Haxhi... Be-


simi...

Haxhi është ndoshta edhe një zierje besimi... Është emocioni kombëtar i umetit... Është të jetuarit e një kënaqësie adhurimi së bashkë me një umet të tërë...

BASHKËSIA

Haxhi dhe bashkësia... Është ndjenja e parë që të dhuron Haxhi, ajo që ndien njeriu duke e parë veten si pjesë e një bashkësie të madhe. Nuk je vetëm o vëlla, ja shiko, pranë ke nga Malajzia... Kenia... Tunizia... Algjeria... Nigeria... Pakistani dhe Turkistani... Je në një rresht me ta. Të gjithë së bashku e shihni pikën ku bashkohen sytë tuaj.

Këtu nuk ka shejtanë që pëshpëritin xhelozit të ndryshme në veshin e secilit prej jush. Je në të njëjtin rresht. Janë lutjet që së bashku thonë "O i dashur dhe i shtrenjtë! O Mëshirues dhe Falës! O Zoti i Botëve! Ja, ne jemi fluturat që sillemi rreth Qabes. Ja pra, vatra e dashurive tona. Jemi ne që të lidhur me njëritjetrin krah për krah, hap pas hapi, zemër për zemër dhe sy me sy, sillemi rreth simbolit të besimit tonë të përbashkët. Jemi pjesë e 5 miliardëve të ardhur nga i gjithë rruzulli tokësor. Ja pra kjo është edhe bashkësia... Kjo është edhe forca e Islamit... Ti je dhe një fije peri që thur këtë forcë. Ndiej sikur çdonjëri



prej nesh, i ri apo i moshuar, grua apo burrë, ai që është i përgjyruar në tokë apo ai që qëndron i papërkultur, mbart me vete një nder, një respekt, një urtësi nga Bilali... Ja pra, ti je bashkësia e thurur si lulja e kamomilit përreth mbulesës së zezë të Qabes... "Nëse i besoni jeni patjetër superiorë!" Nëse forcën e kësaj bashkësie e mbarim në vendet tona... për besimtarët e vendit tonë... Nëse e mbarim haxhin si një ilaç force për bashkësinë... Sikur ta shndrisim këtë forcë në shpirtrat e vëllezërve në vendin tonë... Sikur ta fshehim pastrimin dhe forcimin në shpirtrat tanë si një porosi që duhet të mos prishet për gjithë jetën... Nëse shpirtrat tanë sillen rreth kësaj ndjenje pastrimi... Nëse i fshehim brenda nesh Qaben dhe Arafatin... Ja pra, kështu hapet rruga e bashkësisë së madhe... Ajo është edhe bashkësia e lartësuar...

LUTJA

Unë jam një pjesë e kësaj bashkësie që i dhuron shpirt malit dhe gurit, që stolis qiellin me një goditje shpirti... Unë jam njëri nga këto miliona zemra që vërshojnë nëpër rrugë nga Haremi Sherif. Edhe unë marr në vetvete frymën e miliona besimtarëve. Zoti im, edhe unë jam pjesë e lutjes së nipit të Bilalit që i ka hapur duart sikur dëshiron të përqafojë qiellin, që i ka ngulur sytë në qiellin e yjeve të Mekës sikur sheh qenien tënde, që digjet dhe përvëlohet sikur do ti dalë shpirti dhe do të mbështetet në mëshirën tënde... Për këtë jam i sigurt. Jam i sigurt që ai njeri me shpirt të gjerë lutet edhe për mua edhe për gjithë bashkësinë. Ai është edhe në lutjet e mia. Ai ka nder dhe liri. Lutja e tij është një lutje që nuk kthehet prapa, jam i sigurt për këtë. Nuk kthehet mbrapa lutja e atij djaloshi të ri që në dorë ka dheun e Afrikës dhe që mbërrin në Qaben tënde... Ti thua: "Për çfarë vleni nëse nuk është lutja juaj?" ... Ja pra, miliona njerëz këtu vetëm një lutje i bashkon: Zoti im, mundësoji kësaj bashkësie të jetojnë ditë madhështore!

FËMIJËT

Qabeja dhe fëmijët... Nuk e di sa herë e kam jetuar këtë ndjenjë. Sa herë i kam kërkuar fytyrat e fëmijëve të mi në fytyrat e fëmijëve të vegjël të veshur me ihram. Kam kërkuar në sytë e tyre sytë e fëmijëve të mi, në lutjet e tyre lutjet e fëmijëve të mi. Sa shumë u shkon këtyre syve të vegjël, këtyre vështrimeve të pafajshme të si-

Ja pra kjo është edhe bashkësia...

Kjo është edhe forca e Islamit...

Ti je dhe një fije peri që thur këtë forcë.



llen përreth kësaj shtëpie të hareshme. Sa herë që shoh këta fëmijë zezakë që ngajnë sikur vilat e rrushit të zi më vjen të them me vete: "Zoti im! Sikur të na kishe lënë gjurmë prej tyre në një anë tonën kjo bukuri e zezë dhe e pafajshme, do të ishte një vepër e Jotja, një pasqyrim i besimit tek Ti". Dje përkëdhela fytyrën e një fëmijë që ishte pranë gjyshit të tij që qëndronte ulur në cepin e një vendi. Në fakt më vinte t'i thosha "Eja të lutemi së bashku", por nuk munda t'ia them. I përkëdhela fytyrën. E ndjeva thellë në shpirt lëkurën e tij të njomë si një sinjal dashurie. Vallë a e kuptoi edhe ai këtë dashuri? E ka kuptuar, jam i sigurt për këtë. Aq shumë i shkëlqenin sytë...

Këto vajza të vogla me shami... Që të gjitha mbartin në vendin e tyre të sigurt pafajësinë e ngrohtësisë së një pëllumbi. Unë i kushtoj shumë kujdes kësaj pafajësie, e kam shumë zili dhe e i jam dhënë pas saj.

TË MOS ARRISH TË KUPTOSH

Sot është e xhuma. Pranë kam një të ri fytyrëqeshur nga Tunizia. Njihemi me të. Më thotë se quhet inxhinier Xhemali. Ai flet për "botën Islame

dhe kolonializmin". Ankesa jonë e përbashkët është mungesa e autoritetit të bashkësisë. Duke parë miliona njerëz të mbledhur në Harem e përfundojmë bisedën para xhumaje me shpresën se "Bashkësia Islame është në ringjallje e sipër".

Problemi i përbashkët i bashkësisë është mosarritja e një mirëkuptimi, pra është problemi i gjuhës. Besimtarët që mbushin Haremin kuptohen në lutje dhe adhurime. Ata ndajnë të njëjtat lutje, por është me dyshim nëse i ndajnë të njëjtat halle dhe telashe. Secili përpiqet të mos lëndojë njëritjetrin, të pasqyrojë dhembshuri të njëritjetri me sytë e tyre dhe të transmetojë ndjenja dashurie, por kjo nuk ecën më tutje. Që në fazën e njohjes bile lëkundemi. Njëritjetrin e njohin vetëm për nga vendlindja, ndoshta edhe pak nga emri, nuk arrijmë t'i qajmë hallet njëritjetrit. Unë nuk arrij t'ia shpjegoj problemet dhe vështirësitë e muslimanëve të Evropës. Tuniziani nuk arrin të ma shpjegojë Tunizinë. Ndërkohë sa shumë e dëshiron këtë. Secili në vetvete përpunon një gjuhë zogu. Si do shkojë kjo puna jonë? Këtë bashkësi duhet ta bëjmë të kuptueshëm për njëritjetrin.

Problemi i përbashkët i bashkësisë është mosarritja e një mirëkuptimi, pra është problemi i gjuhës. Besimtarët që mbushin Haremin kuptohen në lutje dhe adhurime. Ata ndajnë të njëjtat lutje, por është me dyshim nëse i ndajnë të njëjtat halle dhe telashe.



Mekasi kishte mësuar numrat në Turqisht, pasi merrej me tregti. Po çështjet e përbashkëta të Islamit si do të fliten? Një gjuhë e përbashkët dhe kjo ma merr mendja duhet të jetë një kërkesë e përbashkët e "të ftuarve të Mëshiruesit". Një gjuhë e përbashkët që fillimisht është gjuha e Kuranit. Fëmijët tanë duhet patjetër ta mësojnë këtë. Ata nuk duhet ta ndiejnë shkëputjen nga kjo botë e madhe. Edhe bashkësia mund të arrijë në një forcë të plotë vetëm me një gjuhë të përbashkët. Koha jonë është koha e informacionit, por ne nuk kemi arritur akoma në çështjet e botës Islame. Allahu Teala urdhëron e thotë: "Ne u ndamë ju në popuj e fise që të njiheni me njëritjetrin" por nuk kemi arritur të njihemi, pasi ne nuk kemi një gjuhë të përbashkët. Ne përpiqemi të kuptohemi në frëngjisht dhe anglisht, por gjuha e Kuranit paska mbetur e fshehtë në Kuran. Nuk mund të ndodhë kështu. Çështjet dhe problemet e përbashkëta të paktën duhet të pasqyrohen dhe të transmetohen tek bashkësia. Marrëdhënia e dashurisë duhet të jetë edhe një marrëdhënie hallësh e problemesh. Duhet të krijohet një ide e përbashkët e popullatës Islame. Secili duhet të kthehet në vendin e tij me mendimin dhe idenë që ti dijë problemet e përbashkëta të botës Islame dhe të mendojë se si mund të kontribuojë në shkallë kombëtare.

Në ditët e haxhit mund të arrihet në përfundime edhe më të frytshme me anë të një organizimi dhe komunikimi të begatshëm. Problemet shkencore, politike, ushtarake të Islamit dhe të botës Islame duhet të merren në shqyrtim në komisione. Mund të përgatiten ligjërata për gjithë vitin dhe të organizohen kongrese që konceptojnë në botën Islame.

DITURIA

Një nga dobësitë themelore të bashkësisë është mungesa e dijes dhe e përvojës. Duke mos e njohur mirë Islamit nuk mund t'i dimë as adhurimet, as etikën, as traditën dhe as përvojën. Ne jemi të painformuar për drejtësinë dhe sistemin e drejtësisë në Islam. Ato që dimë zakonisht janë një material i trashëguar ndaj të cilit nuk jemi të vetëdijshëm. Është i nevojshëm një material informimi i gjerë. Bashkësia duhet të edukohet me dashuri. Te secili prej muslimanëve afrikanë gjendet në dorë një tesbih dhe vazhdimisht merren me adhurim. Por përse i përket marrëdhënieve me problemet e tjera të bashkësisë ngadalësohet

sjellja e hijshme. Në të gjitha sjelljet ka pak hapësirë të lirisë së vetvetes. Kuptohet që në gjuhën e tyre është zhvilluar një mënyrë informimi që ka arritur në adhurimet e tyre. Kuptohet që një dijetar – Zoti qoftë i kënaqur me ta – e ka mësuar gjuhën dhe dorën me tesbih. Tani duhen dijetarë të rinj t'i thurin veshjeve të tyre bukuritë e Islamit.

Kjo nuk është e tillë vetëm për një mysliman afrikan. Çdo popull dhe që të gjithë bile e kemi të nevojshme të kalojmë nëpër sitën e islamit dhe të arsimit në një mënyrë apo në tjetrën. Njeriu i cili përpiket që të zërë radhën e njëri-tjetrit në radhën e bukës në kthim në Habur duhet të merret në shqyrtim sikurse edhe i domosdoshmërisë së dhënies së një edukate Islame bashkë me Haxhin, apo jo?

Në darkë në Medinë tek po dëgjoja ligjëratat fetare vura re edhe njëherë mangësitë që kisha dhe në tavaf u turpërova për mllefin që kisha ndaj atyre që ngushtoheshin si në të majtë dhe në të djathtë në vizitat e tyre në këtë vend. Të mos lëndosh një mysliman tjetër padyshim që është një edukatë e rëndësishme. Por ti thuash një myslimani që të ka hasur bërnylin te ti dhe që ndoshta ke ndjerë dhembje “ndoshta të vrava në bërnyl” është edhe më e mira. Kur do të arrijmë ta kuptojmë këtë o Zoti im? Arsimimi në Islam nuk ka fund... Pastrimi i epshit nuk ka fund.

DASHURIA

Ndodhemi në xhaminë e të Dërguarit të Allahut dhe pikërisht në Ravda. Këtu prehet miku i tij më i ngushtë Ebu Bekri. Këtu është vendi i Umerit, këtu i Ehli Suffas. Këtu janë ulur miqtë e ngushtë të Dërguarit të Allahut dhe kanë falur namazin. Kurani ka zbritur në këtë vend. O Zoti im! Edhe shpallja ka zbritur në këtë tokë. Ky vend ka mbartur mbi supë shpalljen. Pejgamberi i Allahut ka qenë imam në këtë mihrab. Në këtë minber ai i ka paraqitur bashkësisë së tij njoftimin e pavdekshëm të Islamit. Ja pra, është ky vend të cilin e kemi ëndërruar me shumë mall. Ah sikur të kisha ardhur para 14 shekujsh! Të kisha parë atë fytyrë të hijshme dhe t'i isha bindur atij dhe kështu të kisha vazhduar në rrugën e tij. Kam shumë mall... në Harem mbahet një ligjëratë, gjatë së cilës lexohet ajeti: “Mos t'ju dalë zëri juaj më i lartë se i Pejgamberit”. Si flitet këtu? Ai flet dhe vetëm flet. Ka 15 shekuj që flet. Unë e dëgjoj këtë zë. Zoti mos ma largo nga brenda

Në ditët e haxhit mund të arrihet në përfundime të frytshme me anë të një organizimi dhe komuniteti të begatshëm. Problemet shkencore, politike, ushtarake të Islamit dhe të botës Islame duhet të merren në shqyrtim në komisione. Mund të përgatiten ligjëratat për gjithë vitin dhe të organizohen kongrese që konceptojnë botën Islame.



meje këtë zë. Bëje këtë zë udhëzuesin tonë të përtshëm. Bëje dashurinë e tij udhëzuesin tonë. Ti bashkëve dashurinë tënde me atë të Profetit. Ti bashkëve bindjen tënde me atë të Profetit. Zoti im, mos na ndaj ne nga këto dashuri. Ti je Ai që i drejton zemrat tona. Laji dhe pastroji zemrat tona me këtë dashuri. Zoti im, na bëj të ngjashëm me brezat e tij. Na përço një tregues dhe një shebull në shpirtrat tanë. Na përço shembuj nga Ebu Bekri, Umeri, Muadhi, Bilali, Musabi, Aliu, Uthmani... bëje të mundur që ai brez të jetojë me ne dhe fëmijët tanë. Me shekuj me radhë është i freskët pendimi i Lubabes. Ç'pendim i hijshëm është ai që i Dërguari i Allahut e zgjodhi menjëherë. Ç'pendim i hijshëm është i atyre që shpallja njofton se janë falur. Bëji pendimet tona të ngjashme me të tyret. Fshiji gjynahet tona që në këtë botë. Mos na bëj të dalim të turpëruar para Teje dhe të Dërguarit tënd. Na mundëso që të kemi nderin të jemi bashkësia Jote. Zoti im, Ty të mjafton fuqia Jote për gjithçka.

Koshienca për të qenë nga bashkësia e Muhamedit (a.s.)

Allahu na ka dhënë shumë mirësi, që kemi të vështirë edhe t'i numërojmë të gjitha, por nderi dhe superioriteti ynë që kemi ardhur në këtë jetë si "bashkësia e Muhamedit (a.s.)" është një mirësi aq e madhe, sa nuk mund të krahasohet me asnjë tjetër. Kjo sjell me vete edhe një përgjegjësi të madhe dhe me nder.

Çdo mysliman, që përpiket të gjejë Islamit në ditët e sotme, është i detyruar të pyesë "Kush është bashkësia e Muhamedit (a.s.)?", "Ç'dallim ka nga bashkësitë e tjera?", "Cilat janë përgjegjësitë të cilave duhet t'u kushtohet kujdes për të qenë bashkësia e Muhamedit (a.s.)?". Një gjë e tillë ashtu sikurse është e rëndësishme për

përcaktimin e identitetit tonë, është e rëndësishme edhe në përcaktimin e qëllimeve, të mënyrës dhe formës së jetës, bile edhe për formën e dashurive tona. Kjo është e rëndësishme edhe për arritjen në pikën kulmore për të kuptuar qëllimin final të jetës.

Kush është bashkësia e Muhamedit (a.s.)?

Bashkësia e Muhamedit (a.s.) janë ata njerëz të cilët kanë arritur të kuptojnë se Pejgambëri është "Mëshirë për Botët", janë njerëzit të cilët mund të kuptojnë se Ai është udhëzuesi për shpëtim i të gjitha kohëve dhe vendeve, janë njerëzit që pranojnë udhëzimin e Tij dhe vetëm të Tij në të gjitha njësitë e kohës dhe të vendit për je-

tën, janë njerëzit që e kuptojnë Kuranin si Ai, që e jetojnë si Ai dhe që e shohin Atë si zgjidhje të vetme për gjithë njerëzimin deri në ditën e gjykimit.

Cili është dallimi i bashkësisë së Muhamedit (a.s.) nga bashkësitë e tjera?

Ajo është një bashkësi e cila në Kuran është cilësuar nga Zoti i botëve si "më e dobishmja", "më superiorja", "më e ekuilibruara", "e dërguar për njerëzimin", "dëshmitare e së Drejtës", "që mban në këmbë të drejtën".

Atë bashkësi Allahu e ka lartësuar në Kuran, hebrenjtë dhe të krishterët i kanë dhënë një vlerë shumë të veçantë dhe nuk kanë arritur ta ndajnë mes tyre,

është bashkësia më e afërt e Ibrahimit dhe e rrugës së tij. (Ali Imran 68)

Ajo është bashkësia që përpiqet dhe mundohet ta jetojë dhe ta përqafojë Islamit për të cilin Allahu i Lartë ka thënë "Unë e plotësova Atë si fe dhe vetëm Atë e kam pëlqyer"

Ajo është bashkësia e Islamit si fe e fundit dhe si rrjedhojë e Kuranit si libër i fundit dhe e mrekullive të Tij. E thënë ndryshe, duke u nisur nga rruga që ndjek, ajo është një bashkësi që vërteton me Kuranin, të vërtetën dhe të drejtën si dhe mungesën e një alternative të një prioriteti e cila do të zgjasë deri në ditën e gjykimit.

Ajo është e vetmja bashkësi që ka njësuar Kuranin dhe shkençën, pasi ajo është bashkësia e Pejgamberit të fundit që nuk është dërguar vetëm një populli apo një kombësia, por gjithë njerëzimit.

Është bashkësia që ka marrë në mbrojtje Librin e Shenjtë nga ana e Allahut si Zoti i botëve në mënyrë që veçoritë e tij të dalin në pah më të qarta dhe të diskutueshme.

Ajo është bashkësia që i beson dhe i bindet Pejgamberit më të madh që mbështetet me mrekullinë e Kuranit, një mrekulli kjo që do të mundësojë të vërtetojë vetë atë dhe të zgjasë deri në ditën e gjykimit.

Është bashkësia që Zoti e ka cilësuar si "të ekuilibruar dhe superiore" (Bekare, 143)

Ajo është një bashkësi që ka pasur mirësinë dhe privilegjin të jetë bashkësia dëshmuar si në këtë botë ashtu edhe në ahiret. (Bekare, 143) Ajo është një bashkësi e cila ka pasur nderin dhe kënaqësinë të jetë "dëshmitarja e të Drejtës" dhe "dora që shpërndan drejtësi"

Ajo bashkësi ka për bazë të vetmen fe të drejtë, atë që është më e mrekullueshme dhe më e fundit, që nuk është ndryshuar asnjëherë dhe që parimet e saj do të zgjasin deri në ditën e gjykimit.

Ajo është një bashkësi e cila i përcjell deri në ditën e gjykimit kufijtë e përgjegjësisë që mbart duke i bashkuar me të gjitha përgjegjësitë e kohës dhe të vendit në botë.

*Allahu na ka dhënë
shumë mirësi, që e
kemi të vështirë edhe t'i
numërojmë të gjitha, por
nderi dhe superioriteti
ynë që kemi ardhur në
këtë jetë si "bashkësia
e Muhamedit (a.s.)"
është një mirësi aq e
madhe, sa nuk mund
të krahasohet me asnjë
tjetër. Kjo sjell me vete
edhe një përgjegjësi të
madhe dhe me nder.*

Ajo është një bashkësi e dërguar për njerëzimin, e caktuar me detyrën për të qenë qendra e njerëzimit, udhëzuesi, lideri, drita e tij dhe për të qenë "dëshmitarja e të Drejtës" (Bekare, 140; Ali Imran, 110)

Ditën e gjykimit çdo Pejgamber do të dëshmojë për bashkësinë e vet, kjo bashkësi do të dëshmojë për të gjithë Pejgamberët. (Nisa, 41)

Kjo bashkësi është pastruar nga të gjitha çrregullimet dhe çekuilibrimet duke u bërë kështu baza kryesore e një ekuilibri të qëndrueshëm, duke u bërë një bashkësi e mrekullueshme. Prandaj është edhe një bashkësi e Lartë, superiore, një bashkësi Më e dobishme. Ajo dallon nga Prioriteti i saj.

Përgjegjësitë e bashkësisë së Muhamedit (a.s.) dhe dimensionet e saj.

Kjo bashkësi para së gjithash është e detyruar të përfshij në vetvete të gjithë njerëzimin pa dallim kombësie, ngjyre, gjuhë apo feje, duke qenë se është "një bashkësi e dërguar për njerëzit". Prandaj edhe ai që jeton në Amerikë, edhe ai që jeton

Ajo është një bashkësi e cila në Kur'an është cilësuar nga Zoti i botëve si "më e dobishmja", "më superiorja", "më e ekuilibruara", "e dërguar për njerëzimin", "dëshmitare e së Drejtës", "që mban në këmbë të drejtën".

në Afrikë janë të detyruar që të jenë përgjegjës dhe të ndiejnë në shpirt dhembjen e atyre që nuk e dinë dallimin e asaj që është e drejtë dhe asaj që është e shtrembër, që shkojnë te e shtrembëta duke menduar se është e drejtë dhe që shkatërrojnë veten e tyre.

Përgjegjësia e tij nuk është vetëm e vetes së vet, e familjes apo e popullit, por e gjithë njerëzimit. Kurani që ka në dorë nuk i zbriti as vetëm atij dhe as vetëm popullit të tij, ai i zbriti të gjithëve që kërkojnë dritë. Kjo

bashkësi ka qenë e detyruar t'ia transmetojë gjithë njerëzimit këtë dritë si një shoqëri që e ka dalluar Dritën e Kuranit dhe që është përpjekur ta jetojë atë. Zoti ynë e ka shprehur kufirin që duhet të përcjellim Kuranin si "nëna e qyteteve dhe rrethi i saj" dhe me thënien "nëna e qyteteve" ka dashur të tregojë për qytetin e parë që ka formuar dhe krijuar njeriu ndërsa me "Meka dhe rrethi i saj" janë qytetet që ka krijuar njeriu në çdo kënd të botës dhe që të gjitha qytetet kanë kuptimin e njerëzimit.

Kjo bashkësi është e detyruar që fillimisht ta mësojë Islamin dhe më pas ta praktikojë dhe të jetë dritë dhe shembull për gjithë njerëzimin dhe jo vetëm për familjen dhe popullin e tij. Ai është i detyruar që dritën e Kuranit ta pasqyrojë jo vetëm në jetën e tij, por te të gjithë njerëzit kudo që jetojnë në rruzullin tokësor. Ai duhet që të përvetësojë në atë mënyrë Kuranin, të bëhet një me të në atë mënyrë që me mesazhin e marrë dhe me dritën e fituar të përqafojë gjithë kohët dhe hapësirat. Ai duhet t'ia transmetojë njerëzimit Kuranin, universalitetin e Islamit dhe faktin që nuk ka



alternativë tjetër në mënyrë të prerë sikurse faktin e padiskutueshëm të ekzistencës së hënës dhe diellit.

Bashkësia, me Islamin që jeton duhet të transmetojë një bukuri dhe një mrekulli të pasqorë në mënyrë që ti tërheq vëmendje syrit, mendjes dhe shpirtit të njerëzimit dhe duhet të bëhet një shoqëri lider dhe udhëzuese që të jetë qendër e njerëzimit. Çdokush duhet të jetë një shoqëri që të jetë një e vetme me veten dhe ta meritojë të jetë më e vlefshme dhe më e dobishmja.

Ajo është një bashkësi që e ka për detyrë të respektojë të drejtën për hir të Allahut, është një bashkësi që duhet të bëjë përpjekje në emër të së Drejtës dhe për të drejtën dhe kjo përpjekje dhe ky mundim është një mundim që i tejkalon kombësitë, popujt dhe shtete. Ajo është një përpjekje pa asnjë qëllim material dhe të kohës, bile pa u marrë në qëllim as xheneti vetëm për të fituar pëlqimin e Allahut.

Kjo bashkësi nuk është e obliguar vetëm të bëjë përpjekje por edhe të fitojë përpjekje sepse të

*Ai duhet që të
përvetësojë në atë mënyrë
Kur'anin, të bëhet një
me të në atë mënyrë që
me mesazhin e marrë
dhe me dritën e fituar të
përqafojë gjithë kohët dhe
hapësirat.*

mbashgjallë të Drejtën dhe drejtësinë bëhet e mundur vetëm duke fituar përpjekje. Përgjegjësitë e kësaj bashkësie mund të përmbliidhen në "mbajtja në këmbë e së Drejtës"

Kjo është një bashkësi që duke qene se është "dëshmitare për njerëzit" është e obliguar të jetë edhe "dëshmitare për Të Drejtin" (Bekare, 143) Ajo është një shoqëri që mundëson forcimin e Të Drejtës që pasqyron besim dhe siguri dhe drejtësi për gjithë njerëzimin çfarëdo lloj feje, kombësie apo popullate të jetë,

është një shoqëri që me fjalë do të përçojë Drejtësi. Ajo është e detyruar të jetë një shoqëri që e sheh Të Drejtën dhe që i mundëson edhe njerëzimit ta shikojë Atë.

Pra kjo bashkësi është e detyruar që të vërë drejtësi në emër të Allahut, të heqë dhunën, të shtrojë drejtësinë dhe për të gjitha këto të jetë dritë e gjithë rruzullit tokësor.

Arsyeja që i janë dhënë kësaj shoqërie të gjitha këto përgjegjësi dhe ky nder është se kjo bashkësi ka për bazë pikërisht të vetmen fe që nuk ka pësuar ndryshime dhe që është më e mrekullueshmja dhe e fundit e zbritur për njerëzimin. Prandaj është edhe shoqëria e vetme që ka tiparin e një besimtarit të vërtetë. Është ajo shoqëri që ka fituar të drejtën për të qene si halifeja e Allahut në tokë. Por me kushtin e vetëm që të jetë Bashkësia Muhamedane në kuptimin e vërtetë. E gjithë çështja jonë në këtë moment është të jemi bashkësia e Muhamedit në kuptimin e vërtetë të saj.

Në shpirt kishte bashkësinë

Njeriu nganjëherë mbyllet në dhomë dhe dëshiron të qëndrojë vetëm për vetëm me Kuranin. Sipas gjendjes shpirtërore që e ka mbërthyer atë ditë, dëshiron që ashtu pa fjalë dhe i qetë, të derdh lot mbi fjalët e Kuranit, të lexojë ajetet, në ndonjë vend të ndalet e të mendojë dhe të lexojë përsëri disa faqe.

A ka ndodhur të lexoni ajetet e fundit të surës Tevbe kur keni ndierë një nevojë të tillë? A keni menduar që t'i lexoni dhe t'i kuptoni këto ajete dhe njëkohësisht të mendoni edhe dashurinë e madhe që kishte Pejgamberi ynë i dashur ndaj bashkësisë së tij?

A jeni gati tani të lexojmë përsëri kuptimin e pashembullt të fjalës së Allahut, të detit të mëshirës me dashurinë e të cilit njerëzimi për shekuj me radhë nuk u ngop me dashurinë e tij, dhe nëse ambienti është i përshtatshëm, ky ajet të dëshmojë edhe për lotët tuaj? **“Juve ju erdhi një Pejgamber për të vendosur drejtësinë dhe Ai është nga mesi juaj, Ai është mjaft i nderuar dhe i vlerësuar, Atij i vjen rënde që ju të ndjeheni ngushtë, Ai dridhet para jush, është i butë dhe i mëshirshëm për besimtarët”** (Tevbe 9/128)

Tani të mendojmë cili është mesazhi që na jepet në këtë ajet Kuranor:

“Ju erdhi profeti nga mesi juaj...”

Ndjeshmëria e Tij ndaj bashkësisë, në ajet, shpjegohet me shprehjen “ai ngulmon për ju”. Aq i mëshirshëm është ai Pejgamber, sa që ai dridhet para bashkësisë së vet dhe është më i dhembshur edhe se nënat nën këmbët e të cilave ndodhet xheneti. Çdonjëri prej tyre përpiqet që të jetë prej të shpëtuarve dhe të udhëzuarve dhe të gjitha përpjekjet janë në dobi të njerëzimit. Ai dëshiron që të hyni në xhenetit Ridvan dhe të takoheni me Zotin tuaj.

Ai është “Rauf” dhe “Rahim” për besimtarët, është mjaft i dhembshur dhe i mëshirshëm, nuk rri i qetë edhe për hallin tuaj më të vogël, me dhembshurinë dhe mëshirën e tij ai merr pranë vetes edhe mëkatarët. Ai mërzitet shumë për ata që ngrenë krye dhe shkatërrohen... Sa shpirtgjere është ai që i përqafton të gjithë dhe zemra i rreh për gjithë bashkësinë, pa bërë asnjë dallim. Me qetësinë dhe dhembshurinë e Tij, ruan dhe mbron gjithë bashkësinë, sikurse prindërit që me dhembshuri mbrojnë dhe përqaftojnë tre apo pesë fëmijët e tyre. Me ashabët e tij ai sillet mjaft mirë dhe sipas nevojave që kanë. Ai është shumë i durueshëm ndaj dyfytërisë. Ai i mbron ashabët e tij, ndihmon ata që do të marrohen, i jep mbështetje atij që i ngordh deveja në rrugë. Nëse në një udhëtim një sahabi mbetet në një gjendje të vështirë dhe në momentin që ai lutet “Zoti im, njoftoje Pejgamberin për gjendjen time”, ai e ndien në shpirt atë dhembje.

Ashtu sikurse i përqafton me dhembshuri besimtarët e periudhës së lumturisë, ruan dhe mbron edhe bashkësinë e Tij që do të vijë pas shumë shekujsh. Ai i këshillon të jenë të zgjuar dhe të tregohen të kujdesshëm ndaj ngatërresave të dëmshme dhe këtë mëdyshje, Ai e shpreh duke thënë “Kam frikë se pas meje do t’u ofrohen mirësitë e kësaj bote dhe ju, do të anoni pas tyre”

Ai u mëson atyre që kanë mall për luftën e Bedrit, atyre që nxjerrin një “ah’ nga thellësia e shpirtit sa herë që lexojnë Uhudin në libra, punët që kanë sevape të mëdha sa e njëqind

Me qetësinë dhe dhembshurinë e Tij, ruan dhe mbron gjithë bashkësinë, sikurse prindërit që me dhembshuri mbrojnë dhe përqaftojnë tre apo pesë fëmijët e tyre.



dëshmorëve. Allahu i Lartë Muhamedin (as) në librin e Tij të shenjtë e përshkruan si Rauf dhe Rahim ndaj besimtarëve dhe një njeri që dridhet për ta...

Ai nuk u jep rëndësi atyre që i dalin kundër, nuk u jep rëndësi as atyre që e gjuajnë me gurë, i fal ata që i flasin pas krahëve, i dëgjon të gjitha këto, i di ata që bëhen, por përsëri bën dua që ata që i bëjnë këto punë të gjejnë Zotin “Zoti im, ata nuk e dinë, të paktën shpëtoji fëmijët e tyre.” Ai lutet dhe përpiqet për shpëtimin e bashkësisë së Tij.

Ai e di dhe e sheh që shpëtimi i bashkësisë mund të bëhet e mundur vetëm nëse ajo bashkësi i bindet ftesës së Tij. E sheh këtë dhe pajtohet me shumë vështirësi në sa e sa të vërteta që ka parë sikurse nata e Miraxhit. Ai thotë “Sikur ta dinit atë që di unë do të qanit shumë dhe të qeshnit pak” Ai është burim mëshire

Në e dimë dhe i besojmë faktit që nën rrezatimin e syve të mbushur me dashuri, Ai kujdesej jo vetëm për ata që ndodheshin pranë tij, por edhe për besimtarët e ardhshëm që do të vinë pas shekuj e shekuj me radhë deri në ditën e gjykimit.



dhe det i dhembshurisë, ai është në dijeni të atyre që ndodhin dhe që do të ndodhin aq sa e ka njoftuar Allahu i Lartë.

Jeta e të dërguarit të Allahut mund të themi se është përfshirë në ajetet Kuranore sepse Ai e ka bërë pjesë të pandarë të Tij Librin e Shenjtë, duke u quajtur njëkohësisht edhe si Libër i gjallë. Kurani në një aspekt është ana e prekshme e historisë së Profetësisë.

“O Muhamed thuaju mosbesimtarëve që... thuaju besimtarëve... thuaj o njerëz... bisedo me ata në punët e tyre... Pse i lejove ata pa e pyetur dhe studiuar të vërtetën” ... Këto dhe të ngjashme hedhin dritë mbi faktin se si është thurur mëshira Muhamedane, Kurani për njëzet e tre vjet me radhë tek i Dërguari i Allahut. Një kuptim tjetër i këtyre ajeteve kur mendohen në tërësinë e tyre tregojnë edhe për për-

pjekjet e Tij për të shpëtuar bashkësinë.

Në Kuran janë shpjeguar cilësitë e Tij të larta dhe është njoftuar se pasuesit e librave të tjerë do ta njohin sikurse e dinë. Në libër është njoftuar se ai është një shembull i mirë për ata që besojnë te Allahu dhe në Ditën e Gjykimit. Gjithashtu është njoftuar se ai me mëshirën e Allahut sillet butë me besimtarët. Siç e kemi dhënë edhe në komentimin e mësipërm është njoftuar se atij i janë dhënë dy cilësi nga emrat e Allahut që nuk i ka asnjë Pejgamber tjetër.

Kur lexoj ajetet e fundit të sures Tevbe, kënaqem me një kujtim të këndshëm të cilin e kam fshehur në veten time si gjënë më të shtrenjtë. Në vitet kur ishim studentë, në vendin e myezinit të quajtur mahfil të xhamisë Fatih, zhvillonim orën e Kuranit. Një shoku ynë lexoi këto ajete në fillim të orës. Mes atyre që dëgjonin ishte një mysafir nga Saudia. Si kushdo tjetër, ndoshta edhe më shumë, u ndikua tepër nga ky lexim.

Pas namazit të sabahut, sikur e kishte prekur një dorë e magjishme grupin e mbledhur nën kubetë e mrekullueshme të xhamisë. Mysafiri na vështrioi të gjithëve me sytë e përbotur dhe na foli me një zë qarës. Duke falënderuar Zotin që kishte dhënë mundësinë që të ndodhej në mesin e bijve të popullit që e lexojnë kaq bukur Kuranin, foli për mëshirën që ka Pejgamberi (as) ndaj bashkësisë së Tij...

Në një lagje në të cilën i besojmë se është shfaqur edhe begatia e “hadithit që njofton për çlirim”, në xhaminë Fatih po bëheshim dëshmitarë edhe të një mrekullie tjetër të Pejgamberit (as). Grupi i Shërimit që kishte menduar mirë për veçoritë dhe tiparet dalluese të dërguarit të Allahut si mëshirë për gjithë njerëzimin me begatinë e ajeteve të lexuara kishte kaluar në një tjetër ambient të frytshëm. Mendoj se të gjithë ata që merrnin pjesë atë ditë në atë orë mësimi kishin përjetuar të njëjtat ndjenja. Shpirtin tonë e kishin rrethuar ndjenja të ngrohta nga

bota shpirtërore e Pejgamberit (as) që ka rrethuar bashkësinë e tij si një re dashurie. Si në periudhën e lumturisë... Thuajse ai ishte mes nesh dhe po ledhatonte kokën e jetimëve duke u bërë një shpresë për të pashpresët.

Kur e kujtoj këtë, ndiej një qetësi në shpirt. Ndiej një kënaqësi të madhe kur jetoj ndjenja të tilla në një grup mësimi, në një kuvend Kurani dhe kërkoj nga Allahu të më dhurojë mundësi të tilla për të qetësuar zemrën.

Padyshim që Ai ishte robi dhe i Dërguari i Allahut, mbi të gjitha ishte një njeri. Lindi, u rrit, u martua, u bë me fëmijë dhe me nipër si gonxhet e jetës. Erdhi dita që në trupin e tij të bekuar ndjeu dhembje.


Ne e dimë dhe i besojmë faktit që nën rrezatimin e syve të mbushur me dashuri, Ai kujdesej jo vetëm për ata që ndodheshin pranë tij, por edhe për besimtarët e ardhshëm që do të vinë pas shekuj e shekuj me radhë deri në ditën e gjykimit. Duart e shndritshme që kishin prekur Hasanin kishin kaluar vitet duke mbërritur deri te ne. Kjo dashuri na mësonte ne mëshirën. Ai na mësonte të gjithëve ne në emër të Umerit se nuk do të ishim besimtarë të denjë nëse nuk do ta donim me gjithë shpirt Atë dhe përherë thoshte "Bashkësia ime, bashkësia ime" Ai na kërkonte në Miraxh dhe në shpirt kishte përherë bashkësinë.

Duhet të shtrojmë këtë pyetje: A mund të themi se dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut është më ringjallëse dhe ripërtëritëse sesa pa-

suria, fëmijët tanë dhe se dëshira për ujë e një njeriu të etur?

Ajo që duhet të bëjmë në këto ditë është të përpiqemi që të jemi sa më pranë dashurisë së Pejgamberit (as), të pranojmë me shpirt ftesën e Tij dhe të mundohemi të jetojmë Sunetin e Tij në ditë të vështira. Nëse çelësi për të qenë një besimtar i vërtetë është të ndjekim gjurmët e shndritshme të Dërguarit të Allahut dhe të marrim mësim nga çdo gjendje e Tij, çdo ditë duhet të marrim mësim nga shpirti i Tij që përpiqet të shpëtojë njerëzimin dhe nga mëshira e Tij që përqafton të gjithë besimtarët.

A ka kuptim jeta pa shpenzuar frymërat që janë me numërim, ajo jetë që nuk e meriton dashurinë e Tij? Duhet të dimë fatin e madh që kemi, të jemi Bashkësia e Pejgamberit të Mëshirës.



GRUPIM NJERËZISH APO BASHKËSI

Shoqëria e injorantëve që janë mbledhur rastësisht duke formuar një grupim të pavlerë i ngjan një "kodre" prej rëre. Ajo kodër është kaq e paqëndrueshme sa me një erë mund të shpërbëhet.

Në gjuhën arabe *guruh* do të thotë një grumbull njerëzish. Ai është një grup shoqëror, një grupim i thatë njerëzish që përbëhet nga individë të pavetëdijshëm dhe të zakonshëm, një grup njerëzish që kanë ndjenja dhe mendime të ngurtësuar, shkallë ideore të ulët, një zemër dhe shpirt të vjetruar, që s'kanë ndonjë qëllim dhe si rezultat njerëz pa ndonjë nivel njerëzor.

Këta grumbuj njerëzish kanë disa tipare fiziko-biologjike dhe te ata nuk ka "tipare dalluese"

Ky lloj njeriu, i cili kur është në grup përbën këtë turmë njerëzish, si individ është sikurse "kafsha që flet", një lloj "qenieje" biologjike që ha, pi, shëtit, dëfrehet, punon dhe shumohet.

Në qendër të jetës së tyre është vetëm dëshira, qetësia materiale dhe ekonomia. Sipas tyre çdo lloj pune duhet t'i shërbejë zhvillimit shkencor dhe teknologjik si dhe të gjitha këtyre përpjekjeve të cilat duhet të arrihen. Jeta

është për prodhim dhe konsumim. Në jetën e tyre nuk ka ndonjë kuptim tjetër të lartë, sepse ata i kanë kthyer shpinën rregullit që ka vendosur Allahu për t'i dhënë kuptim dhe drejtim jetës së njeriut dhe nuk janë mjaftuar me kaq, por kanë ngritur edhe bllokada.

Këto janë grupime njerëzish pa qëllime dhe të pavetëdijshëm. Punët e tyre, ndjenjat dhe mendimet e tyre janë vetëm për qëllime të jetës materiale dhe epshore. Është një shoqëri e një kufome të gjallë që nuk di pse është krijuar, që bie pre e sundimit të epshit dhe që nuk e ka kuptuar akoma qëllimin e robërisë, një shoqëri që përbën lloje të njeriut të mjerë që gjoja e quan veten "të lirë" meqenëse është i tillë, që nuk mund ta kuptojë se një gjendje e tillë është thjeshtë "e zbrazët" dhe që ka rënë në një pavetëdije të thellë.

Edhe "barinjte" e këtyre turmave janë sikurse këto grupe njerëzish nga aspekti shpirtëror. Ata nuk mbar-

tin asnjë kënaqësi në shpirtrat e tyre. Ka një gjë që, shkalla e qetësisë materiale të këtyre barinjve shpirtërorë dhe standardet e jetës janë më të larta. Shkencat dhe teknologjitë e tyre, pra shkurt qytetërimi i tyre është në një shkallë të përparuar, pra janë të zhvilluar. Edhe “mendjet” u punojnë mirë, por i kanë të zhvilluar në rrugë të “së mbrapshtës”. Qëllimi dhe përpjekja e vetme e çobanëve është t’i drejtojnë këto grupe apo turma njerëzish në mënyrën më të lehtë të mundur. Prandaj si parapërgatitje është t’u mundësohet atyre që “të jenë një qytetar i mirë” dhe kështu t’i drejtosh ata sikurse çon përpara një kope me dele, të drejtosh dhe njëkohësisht edhe t’i mbrosh.

Në filozofinë e tyre nuk ka asnjë rëndësi “vlera”, cilësia e individit. Ato që kërkojnë te ajo qenie që quhet njeri, nuk është cilësia, shkalla shpirtërore dhe etike, pra shkurt nuk është cilësia njerëzore. Ajo nuk është gjë tjetër veçse, ajo që shpreh edhe mjeshtri i pendës Nexhip Fazëll në poezinë e tij “Letër Mehmetit nga Burgu”: “Në burg njerëzit janë si individë, kocka me veshje, mish me këmisha...” Në syrin e drejtuesit është një shoqëri e individëve që duhet të jenë të bindur, të përshtatshëm në rreth”.

Barinjtë e dinë që kullotat janë të pavetëdijshme, nuk gjykojnë dhe do të jetë edhe më e lehtë kështu të kullosin mjaftueshëm. Prandaj edhe injoranca dhe mungesa e ideve është një gjë që ata e dëshirojnë vazhdimisht.

Mosbesimtarët dhe turmat e njerëzve duken sikur përbëjnë një bashkësi ndërkohë që ata dalin kundër “Zotit” sikurse një kope delësh, por këto bashkësi janë thjeshtë artificiale dhe sa për sy e faqe. Megjithëse në dukje janë të bashkuar, në fakt, kontradiktat mes tyre janë të forta. Ne kujtojmë se janë të bashkuar, por zemrat e tyre janë të shpërndara dhe kjo pasi, ata janë një shoqëri pa mendje dhe logjikë, pra janë një grupim pa vlerë. (Kurani, Hashr, 14)

Kurse bashkësia muslimane (xhemati) në një rreth më të gjerë nuk është një “grupim

Kurse bashkësia muslimane (xhemati) në një rreth më të gjerë nuk është një “grupim pa vlerë” i popullit dhe bashkësisë. Grupimi i tyre është një bashkim i vetëdijshëm.



pa vlerë” i popullit dhe bashkësisë. Grupimi i tyre është një bashkim i vetëdijshëm.

Shoqëria e injorantëve që janë mbledhur rastësisht duke formuar një grupim të pavlerë i ngjan një “kodre” prej rëre. Ajo kodër është kaq e paqëndrueshme sa me një erë mund të shpërbëhet.

Ndërsa xhemati dhe bashkësia muslimane janë si një ndërtesa, tullat e së cilës janë të ndërthurura mirë me njëra-tjetrën. Shoqëria është thujse një trup i vetëm. Xhemati është sikurse një trup ku, nëse një pjesë e tij ndien dhembje, të njëjtën gjë e ndien të gjitha pjesët e tjera të trupit.

Xhemati dhe bashkësia do të jetojnë me riptëritjen e Islamit, njeriu dhe shoqëria që janë edhe një lloj pamje e vdekur, do të gjejnë përsëri jetë.


Identiteti islam dhe dinamizmi i bashkësisë muslimane

Allahu është I kënaqur me tre gjëra prej jush:

Të adhuroni vetëm Atë dhe të mos I mveshni ortak Atij! Të kapeni të gjithë pas litarit të Zotit dhe mos ta lëshoni atë. Të këshilloni dhe t'u bindeni prijësve tuaj (Muslim, Akdiye 10).

Hadithi profetik i regjistruar me dy-tre ndryshime të parëndësishme fjalësh edhe nga dijetari i hadithit, Muslimi, në Sahihun e tij, na mëson se cilat janë, përballë humbjes së pastërtisë kulturore që intensifikohet çdo ditë e më shumë në botën e sotme, rrugët e ruajtjes së identitetit dhe dinamizmit me të cilat dallohet bashkësia muslimane. Nga ky aspekt mesazhet dhe mësimet që marrim nga ky hadith janë jashtëzakonisht aktuale dhe interesante.

Si fillim mendojmë se duhet të ndalemi mbi dy shprehje që gjenden në tekstin e hadithit. Shprehja profetike se “kënaqësia e Allahut ndaj diçkaje” do të thotë se ai veprim apo akt është i urdhëruar prej Tij. Në këtë linjë llogjike, “zemërimi ndaj diçkaje” apo “vlerësimi hyjnor si e pahijshme e një veprimi” do të thotë ndalim i



kryerjes së atij veprimi. Prandaj edhe koncepti i “kënaqësisë hyjnore”, ashtu edhe i “zemërimit hyjnor” nënkuptojnë një shprehje të vullnetit hyjnor.

Njësia e Allahut (Tevhid)

Formimi dhe realizimi i identitetit islam si në planin individual, ashtu edhe në atë social para së gjithash është e lidhur me besimin në njësinë

e Zotit. Për këtë arsye, e para nga tri aktet të cilat Allahu i urdhëron dhe me të cilat Ai është i kënaqur është përcaktuar dhe shpallur “të adhurorsh Allahun dhe vetëm Atë pa i bërë të barabartë (ortak)” ç’ka do të thotë se aty ku nuk gjendet besimi në njësinë e Zotit, nuk mund të bëhet fjalë për një individualitet islam. Në ato vende ku besimi në njësinë e Zotit përjashtohet në ndonjë mënyrë dhe me ndonjë pretekst do të thotë se aty është përjashtuar dhe braktisur edhe identiteti islam. Prandaj para së gjithash dhe në mënyrë të veçantë është e rëndësishme dhe e nevojshme që ta mbajmë gjallë në zemra besimin në njësinë e Zotit sëbashku me të gjithë veçoritë karakteristike që e dallojnë atë. Besimi në njësinë e Zotit është kushti parësor dhe themelor që të mund të fitohet kënaqësia hyjnore dhe karakteristika dalluese e personalitetit të një muslimani. Këto janë arsyet nga buron edhe pashmangshmëria prej saj.

Të kapesht fort pas litarit të Allahut

Është principi bazë që do të mundësojë ruajtjen e identitetit islam. Brenda kuptimit

të kësaj fraze që na sjell ndër-
mend ajeti 103 i sures Ali Im-
ran në Kuran, është e qartë se
përfshihet edhe tradita profete-
tike si fthilluese e kuptimit të
Kuranit. Nuk mund ta rrokësh
dhe të kapësh fort pas diçkaje
pa e njohur dhe kuptuar mirë
më parë atë. Profeti Muhamed
që ai që ua publikoi Kuranin
muslimanëve dhe ua komen-
toi atë, prandaj në traditën
profetike është skicuar dhe
ilustruar në planin universal
udha që të shpie drejt të kuptuarit
dhe të jetuarit në përputhje me
to. Dinamizmi i bashkësisë së
Muhamedit dhe vazhdimësia
e identiteti të Islamit mund të
arrihet vetëm duke u kapur
pas litarit të Allahut në sajë
të komentit me traditën profete-
tike. Allahu është i kënaqur
me profetin e Tij të dashur. Po
ashtu Ai është i kënaqur edhe
me jetesën islame që u jetua
dhe u sendërtua me aktet dhe
veprimet e tij. Allahu e urdhëroi
profetin Muhamed që të
shpallte haptazi këtë të vërtetë:
"Thuaju o Muhamed! Po
që se ju e doni Allahun, atëherë
më pasoni mua." Edhe vetë
profeti Muhamed e ka bërë të
qartë personalisht me këto fjallë
faktin që ruajtja e identitetit
dhe vijës së mësimëve islame

është e mundur vetëm në sajë
të përqaimit pa rezerva të
librit të Allahut dhe traditës
së tij, kur është shprehur se:
"Po ju lë pas dy gjëra. Për sa
kohë që do të kapeni fort pas
tyre nuk do të shmangeni nga
udha e drejtë. Ato janë libri i
Zotit dhe praktika ime profete-
tike."

Kushti "në masë (xhemian)"
që përmendet si në ajetin ku-
ranor, ashtu edhe në traditën
profetike na tregon rrugën e
mbrojtjes dhe ruajtjes së iden-
titetit islam në shkallë bashkë-
sie fetare. Të gjithë kategoritë
e shoqërisë nga ato më të ultat
deri tek ato më të lartat janë
të obliguara që të kapen fort
pas litarit të Allahut. Në të
është e varur edhe vitaliteti i
bashkësisë muslimane. Kush-
ti "kujdes, se mos përçaheni"
në ajetin e përmendur më si-
për gjendet edhe në hadithit
e transmetuar prej Muslimit.
Atëherë, identiteti islam, do të
mund të realizohet duke u ka-
pur të gjithë në masë si umet
pas librit të Allahut dhe duke
mos rënë në krijimin e gru-
pacioneve kundërshtarë me
njëra-tjetrën brenda muslima-
nëve. Tradita profetike është
baza e vetme që do të mundë-
sojë unitetin në botëkuptimin

dhe praktikën e bashkësisë
muslimane, megjithëse ek-
zistencën e disa dallimeve
formale që janë edhe këto në
të vërtetë të varura nga shka-
qe të natyrshme dhe jetësore.
Bashkësia e Muhamedit do
ta sigurojë edhe identitetin,
edhe vitalitetin e saj me anë të
përqaimit të librit të Allahut
nën dritën e shpjegimeve pro-
fetike. Kjo është rruga e vetme
me të cilën ajo mund të ruajë
vetveten ndaj çdo lloj presioni
kulturor, ekonomik, politik.

Bamirësia

Pohimi nga ana e Allahut
që individi duhet të sillet me
sinqeritet ndaj personave që
Allahu u ka lënë në dorë fatin
e drejtimit të popullit para së
gjithash na mëson se adminis-
trimi i fateve të njerëzve është
një amanet dhe përgjegjësi e
madhe, dhe se duhet dëshiruar
mbarësia për personat që
e kanë marrë mbi supe këtë
barrë përgjegjësie. Ashtu sikur
se shprehet edhe në hadithin
ku thuhet se "feja është kë-
shillë për mirë" themi se feja
islame përbëhet prej sinqeritetit,
bamirësisë dhe dëshirës
për të bërë mirë. Këshillim do
të thotë të duash të mirën për
personin që ke përballë. Të



*Bashkësia e
Muhamedit do ta
sigurojë edhe identitetin,
edhe vitalitetin e saj me
anë të përgjimit të librit
të Allahut nën dritën e
shpjegimeve profetike.*

kërkosh të mirën për udhëheqësit dhe drejtuesit e shoqërisë do të thotë të lutesh për më të mirën për ta, por edhe t'ua tërheqësh vërejtjen apo ti orientosh atëherë kur është e nevojshme. Bindja ndaj urdhrave të tyre legjitimë vjen në krye të këtij sinqeriteti dhe dëshire për të mirën e tyre.

Bamirësia ndaj drejtuesve është jashtëzakonisht e rëndësishme nga pikëpamja e ruajtjes së identitetit, sepse humbja e identitetit realizohet të shumtën e rasteve nën lirinë e veprimit të politikës apo administratës shtetërore, pra me forcën e shtetit. Shembujt e panumërt të kësaj të vërtete janë regjistruar në histori dhe shihen edhe në ditët e sotme.

Në qoftë se i qasemi problemit nga pozicioni i identitetit

islam dhe vitalitetit të bashkësisë muslimane atëherë shprehemi se të sillesh me mirësi ndaj klasës drejtueses nuk do të thotë kurrë që të mbahet qëndrim pranues ndaj veprimeve të gabuara të tyre.

Përkundrazi, të përpiqesh të bëhesh shkak për ndreqjen e atyre gabimeve do të thotë të marrësh parasysh ca sakrifikime. E shprehur ndryshe, bamirësia është jo vetëm një bukuri morale dhe etike, por edhe dinamizëm shoqëror, guxim civil dhe rigjallërim. Reagimi publik do të thotë presion dhe paralajmërim me anë të votës së lirë. Ajo që në ditët e sotme nënkuptohet dhe shpjegohet nën konceptin e "përdorimit të të drejtave demokratike" është shprehur në hadithin profetik me anë të konceptit bamirësi.

Besimi në një Zot të vetëm, të kapesht fort pas litarit të Allahut dhe bamirësia janë tri prirjet që Allahu është i kënaqur që ti kenë shoqëria muslimane. Edhe identiteti islam, edhe dinamizmi i tij ndodhen brenda këtij trekëndëshi.

Thashethemet

Hadithit ynë na prezanton edhe me tri "gjëra që Allahu nuk është i kënaqur dhe i ka ndaluar ato" të cilat kanë efekt negativ mbi ruajtjen e identitetit islam dhe vitalitetin e bashkësisë muslimane. E para prej tyre janë thashethemet.

Thashethemet janë shkak kryesor i krijimit të një ambienti mosbesimi midis individëve dhe kategorive të

ndryshme të shoqërisë. Në qoftë se një kategori e bashkësisë muslimane sillet në përputhje me pandehmat dhe përgojimet që ka dëgjuar me një kategori tjetër të shoqërisë, kjo situatë shkakton formimin e përplasjeve të mëdha dhe problemeve të pazgjidhshme për shoqërinë. Për këtë arsye, ta marrësh seriozisht duke e pranuar për të vërtetë çdo përgojim pa e sheshuar më parë mirë vërtetësinë e saj nuk ka dyshim se, përbën fatkeqësinë më të madhe për formacionet shoqërore që zotërojnë vlera të përbashkëta. Me këtë rrugë shoqëritë apo kategoritë e një shoqërie shndërrohen lehtë në armiq të njëra-tjetrës. Popujt dhe kombet që kanë jetuar në atmosferën e luftës së ftohtë në të cilën u zbatuan metodat më të zhvilluara të luftës propagandistike, janë dëshmitarët e gjallë të asaj se ç'kuptim kishte atëherë "humbja e kënaqësisë hyjnore".

Duhet të sillemi jashtëzakonisht të mprehtë dhe vigjilent edhe ndaj lajmeve me qëllim dhe prapaskenë të qartë dhe caktuar që lançohen nga organet e shtypit dhe radiotelevizionit, si përherë në përputhje me urdhrin hyjnor që "të bindemi kategorikisht rreth njoftimeve të marra". Nuk duhet harruar se të merresh me thashetheme dhe përgojime do të thotë të merresh me gjëra të kota dhe të çosh dëm kohën.

Shpërdorimi i pasurisë

Dalja duarsh e vlerave ekonomike me anë të shpenzimit të tyre në vende të panevojshme dhe jo legjitime nga as-

pekti fetar është një qëndrim dhe sjellje që Allahu nuk e pëlqen.

Kjo që thamë vlen jo vetëm në planin e individit, por edhe në planin shoqëror. Individit apo shoqëritë që nuk dinë t'i përdorin me mend mundësitë ekonomike që posedojnë në fund fare kthehen në nevojtarë për të tjerët, madje ndodh që i zgjasin dorën e nevojtarit edhe armiqve dhe kundërshtarëve të tyre. Shtetet detyrohen të marrin kredi me kushte të rënda, ndërsa individit i thjeshtë në rast pamundësie për të marr hua detyrohet të përpëlitet në akte vjedhjeje. Ata që i hyjnë valles së kredivë bankare do ta kenë të vështirë të ruajnë personalitetin dhe individualitetin e tyre. Ata që ia dorëzojnë midesë së tyre mendjen dhe zemrën shndërrohen në mundësi e hapët për asimilim politik dhe kulturor.

Kombet që nuk i dalin për zot vlerave ekonomike që zotërojnë shtojnë urinë e shteteve të tjera kolonizuese. Po qe se "kjo situatë" shndërrohet në një sistem ekonomik, kjo do të thotë se dimensionet e fatkeqësisë janë rritur në dimensione jashtëzakonisht të mëdha. Ky është kuptimi i zemërngurtësisë të sistemit të sotëm kapitalist. Identiteti islam dhe dinamizmi i bashkësisë muslimane duket se është e varur me përdorimin në mënyrë racionale nga ana e shteteve muslimane të vlerave ekonomike që posedojnë. Nuk ka dyshim se gjynahu që meritojnë ato shtresa të shoqërisë të cilat lejojnë që mundësitë ekonomike të vendit të përdor-


ren si lëndë e parë për industrinë e rëndë dhe të armëve të kundërshtarëve të besimit dhe kombeve muslimane, do të jetë shumë i rëndë për ta. Edhe ajeti ku Allahu u drejtohet besimtarëve "Në qoftë se jini falënderues për begatitë dhe mirësitë e kësaj bote, nuk ka dyshim se Unë ua shtoj ato. Po qe se nuk dini t'i vlerësoni ato dijeni se dënimi Im është shumë i ashpër." e shpall dhe e siguron qartazi këtë situatë.

Pyetje të shumta dhe pa vend

Hadithi, si përfundim, na informon se krijimi i konfuzionit me anë të pyetjeve të panevojshme dhe që nuk janë realizuar ende dhe ngulitja në kulturën e shoqërisë të teorive dhe pandehmave të pavlefshme përbëjnë qëndrime që meritojnë hidhërimin hyjnor të Allahut. Feja është praktikë dhe aksion, ndërsa pyetjet pavlefshme bien në kundërshtim me këtë cilësi themelore të fesë duke i larguar në të njëjtën kohë besimtarët prej praktikizmit dhe realizmit të jetës.

Komentatorët e hadithit nënvizojnë faktin se koncepti i pyetjeve të shumta dhe pa vend në këtë hadith nënkupton edhe kërkimin e lëmoshës megjithëse nuk ke nevojë reale apo kalimi i masës në kërkesat tona ndaj të tjerëve. Me këtë kuptim pyetjet e shumta dhe të pa vend janë veprime me të cilat Allahu nuk është kurrë i kënaqur.

Për të ruajtur identitetin islam dhe dinamizmin e bash-



*Në traditën profetike
është shkruar dhe ilustruar
në planin universal
uallha që të shpie drejt të
kuptuarit të mësimave të
Kur'anit dhe të jetuarit
në përpulje me to.*

kësisë islame duhet që njeriu musliman i ditëve tona të jetë i mirëinformuar rreth problemeve dhe çështjeve praktike të jetës së përditshme, të përpiqet t'i japë formë të nesërme në atë mënyrë që nuk do t'i dëmtonte vlerat themelore dhe të jetë i mirintegruar brenda një procesi edukativ dhe shkencor. Kusht për ta janë të mos shkojnë pas debateve që nuk japin zgjidhje reale dhe konkrete, të ruajnë përherë vlerat e mëdha që janë të detyruar ti mbrojnë, të sillen si individë dhe kombe vigjilentë që shqetësohen rreth fatit të tyre. Vetëm kështu mund të realizohet shpëtimi nga dënimi hyjnor dhe rrugëtimi drejt kënaqësisë së Zotit.



Kurani i fal jetë shoqërisë

Një tjetër emër i Kuranit është edhe “dritë”. Shoqëria jonë ndjen nevojën e ndriçimit nga fryma e mësimëve të Kuranit, ashtu sikur se e ka nevojë të domosdoshme dritën e diellit.

Ashtu sikur se ngjan në rastin që për këmbën e njeriut nuk i vlen që rruga të jetë e gjerë në qoftë se këpuca që ka veshur është e ngushtë, edhe në rastin e njeriut, zemra dhe shpirti i të cilit është e mbushur me “izm”-a dhe e errësuar me hijen e mosbesimit, nuk i vlen aspak

drita e hënës së plotë. Ndriçimi i mendjes për ta është shndërruar në një mjet që i tregon kombet që ka për të asgjësuar dhe i ndriçon vendet që ka për të bastisur dhe grabitur.

Fjalët e urta janë ato që i ndriçojnë shpirtat. Mendimet dhe meditimet që i kanë ndezur njerëzit si të qenë qirinj ndriçues për ta fiken nga era e kohës që kalon. Kurani, që është fjala e Allahut, i cili krijoi hapësirën dhe kohën, e ndriçon njeriun e kufizuar në kohë dhe hapësirë të caktuar me përqindjen e kul-

turës që ai ka dhe dëshirës që ka për t’u ndriçuar. Errësira që e rrethon personin, shpirti dhe zemra e të cilit janë të ndriçuar, nuk i shkakton edhe aq dëm të madh atij.

Një tjetër emër me të cilin përmendet Kurani është edhe “shpirti, fryma”.

Ashtu sikur se shpirti dhe fryma i falin jetë trupit të njeriut, ashtu edhe Kurani i fal gjallëri shoqërisë njerëzore. Në të njëjtën linjë logjike themi se ashtu sikur se trupi zë të prishet atë-

herë kur shpirti e lëshon kurmin, edhe në kurmin shoqëror fillojnë të duken shenjat e prishjes sociale në qoftë se ajo largohet nga mësimet kuranore.

Shoqëria në të cilën është zhdukur fryma dhe shpirti i vërtetë është një botë në të cilën shtohen dita-ditës me miliona hajdutë, vrasës, narkoman, terrorist, zhatës, mashtrues dhe të tjerë të këtij lloji.

Kurani është fjala e Allahut. Prandaj atë duhet ta vlerësojmë mbi çdo gjë tjetër.

Ai është besimi ynë, kultura jonë shpirtërore, nderi ynë, miku ynë në këtë botë, bashkuhdhëtari ynë në varr, pranvera e shpirtit tonë, melhemi i bren-gave tona, udhërrëfyesi i udhës sonë, drita ndriçuese e mendjeve dhe logjikës sonë dhe krenaria për të gjithë besimtarët muslimanë.

Ne kemi nevojë për Kuranin dhe mësimet e tij po aq sa kemi nevojë për ajrin dhe ujin, madje në aspektin shpirtëror edhe më shumë se këto të dyja, sepse, në qoftë se uji është nevojë fiziologjike vetëm për këtë jetë, Kurani dhe mësimet e tij është libri që do të na mundësojë që të përfitojmë nga begatitë e xhenetit.

Në shekullin e teknologjisë më të lartë njeriu i ditëve tona krijon komoditet dhe prehje në masën që ai arrin të qëndrojë kokë më kokë me natyrën që e rrethon. Kthimi pas në natyrshmëri ka filluar dhe bashkë me të edhe rikthimi në mësimet e Kuranit. Libri i Allahut që ka krijuar gjithësinë, është në

përputhje me shpirtin, fizikun, jetën shoqërore dhe ligjet e natyrës.


Qirinjtë dhe shkëndijat që krijon mendja dhe logjika e njeriut vjen një ditë dhe fiken. Pikëpamjet e njeriut për të nesërmen që nuk do të ketë mundësi ta krijojë ose janë të gabuara, ose janë të zbrazëta. Me sprovat dhe gabimet që ka jetuar njerëzimi e kuptoi këtë dhe teksa do t'i rikthehet natyrës, atëherë ai do të kthehet edhe tek Kurani. Mund të dëgjoni të thuhet "Ç'të keqe ka?! Mund të jetohet edhe duke mos besuar në një libër. Ka njerëz që jetojnë edhe pa besuar tek Kurani." Mos harroni se ju nuk mund të jetoni me nder të nëpërkëmbur, por në botë ka gra dhe meshkuj që e kanë humbur atë, e megjithatë vetëm marrin frymë.

Dallimi mes fjalës së Zotit dhe fjalës së njeriut është e ngjashme me dallimin ndërmjet lules plastike që prodhon njeriu dhe lules së vërtetë që ka krijuar Zoti.

Siç është ndryshimi ndërmjet njeriut që krijoi Allahu dhe statujës që krijon njeriu. Por nuk duhet harruar se edhe në rastet e prodhimit njerëzor ai lëndën e parë e merr të gatshme nga mjedisi që e rrethon, që edhe ai është krijuar nga Allahu.

Allahu është Ai që krijoi mendjen e artistit dhe dorën që mban pendën për të shkruar.

Duhet të kapemi pas Kuranit në mënyrën që kapej pas mësimëve të tija edhe profeti ynë Muhamedi (a.s.). Këtu buron edhe rëndësia e haditheve. Ne



duhet të përpiqemi që të jetojmë në mënyrën që e jetoj Kuranin gjatë gjithë jetës së tij profeti Muhamed, i cili u edukua nën edukatën hyjnore.

Ata që thonë dhe shprehen se "profeti Muhamed që njeri, edhe unë jam njeri. Edhe unë mund ta lexoj Kuranin dhe ta kuptojë atë." le ta dinë se edhe Ebu Xhehli dhe Ebu Bekri dinin që të dy gjuhën arabe që ishte gjuha e tyre e nënës, si dhe dy persona me kulturë dhe bashkëmohatar që e kuptonin Kuranin në të njëjtin nivel. Dallimi mes tyre qëndronte në faktin që Ebu Bekri e konsideronte profetin Muhamed si Kuranin e gjallë që jetonte dhe vepronte për ditë dhe çdo veprim të profetit e kuptonte si të tillë. Ka pasur edhe në të kaluarën njerëz që mendonin siç ata që sapo thashë, të cilëve Mevlana Xhelaludin Rumi u drejtohet me këto fjalë: "Dy kallama pinë nga i njëjti ujë, por njëri quhet kallam sheqeri, ndërsa tjetri është bosh përbrenda."



Dallimi mes fjalës së Zotit dhe fjalës së njeriut është e ngjashme me dallimin ndërmjet lules plastike që prodhon njeriu dhe lules së vërtetë që ka krijuar Zoti.

Bleta dhe grethi thithin nga nektari i së njëjtës lule, por bleta jep mjaltë, ndërsa grethi helm.

Sorkadhja dhe gomari kullojnë në të njëjtën natyrë, por prej sorkadhës prodhohet parfumi, ndërsa prej gomarit ke vetëm bajga.

Si është e mundur që sociologjinë do ta lexoni prej Durkhaimit, filozofinë prej Frojdit, ekonominë prej Adam Smithit, të drejtat e njeriut në gjuhën angleze, ato që do ti lexoni do ti hidhni në rreshta, pastaj netët e xhuma do të mjaftoheni vetëm me një lexim të Jasinës dhe do të pretendoni se jeni të lidhur fort pas Kuranit.

Ajeti 121 i sures Bekare dhe ajetin e sures Muzemil në të cilat kërkohet leximi i ajeteve kuranore siç u ka hije dhe duke ua dhënë hakun që meritojnë dy sahabë të mëdhenj siç janë Abdullah b. Abasi dhe Aliu (r.a.) i kanë kuptuar dhe komentuar me fjalët: “Këtu bëhet fjalë për

leximin e Kuranit në të cilin tregohet kujdes ndaj texhvidit dhe përpiqemi të jetojmë në përputhje me ato që kuptojmë.”

Kurani duhet të jetë në jetën tonë siç është shpirti brenda trupit të njeriut. Ai duhet përhapur në çdo qelizë tonën ashtu sikur se përhapet uji nëpër pemë dhe yndyra nëpër qumësht. Pse të mos i kushtojmë kujdes dhe rëndësi ushqimit tonë shpirtëror, përderisa i kushtojmë rëndësi ushqimit që fusim në mide?!

Tregoni kujdes ndaj librave që lexoni. Ushqimi i farmakosur mund tu lë pa frymë, ndërsa librat e farmakosur mund t’u lënë pa fe. Në qoftë se shihni se mbi rroba u ka rënë ndonjë njollë atëherë e pastroni atë, po qe se dikush pështyn në drejtimin tuaj nxeheni dhe revoltoheni, atëherë përse e shndërroni mendjen tuaj në një çanak për pikëpamjet kutërbuese të një njeriu që është sikur se ju.

Memorizojini ajetet e Allahut duke e kuptuar domethënien e tyre. Vendlindja e kuptimeve të ajeteve kuranore është më e gjërë se toka dhe qiejt bashkë. Nga harta shohim se rruzulli tokësor është i rrumbullakët dhe ndoshta keni pasur mundësinë që të vizitoni disa nga pjesët e globit. Mendoj se për askënd në këtë botë nuk do të jetë e mundur që të mund të shkelë çdo pëllëmbë tokë të globit gjatë jetës së tij. Ky shembull vlen edhe për Kuranin, të cilin e kemi ndër duar të gjithin në trajtën e mushafit, por të shëtitis ndër suret e tija kontinente, ajetet e tij qytete, fjalët e tija si tregje dhe geramat e tyre si rru-

gica jo vetëm një jetë, por mijëra të tilla nuk do të mjaftonin. Ashtu sikur se gjashtë miliard njerëz sodisin botën, edhe e gjithë bashkësia muslimane duhet ti japë formë kësaj bote dhe të caktojë vendin e saj në ahiret duke vështruar Kuranin. Nga aspekti i metit ne jemi si organet e një trupi që e marrin ushqimin të gjitha të ndara nga njëra-tjetra, por që i shërbejnë të gjitha të njëjtit trup.

Lulet e kësaj bote thithin dritën e të njëjtit diell, por kanë ngjyra të ndryshme për të formuar një dekor të mrekullueshëm. Besimtarët që marrin dritë nga Kurani, me anë të reflektimeve të tyre nëpër vende të ndryshme të globit kthehen në stolitë e kësaj bote dhe banorët e botës tjetër.

Allahu e ka ruajtur Kuranin edhe nëpërmjet hafizëve të tij që nuk kanë munguar në asnjë shekull. Ata që dëshirojnë ta shuajnë vlerën e tij me frymën e tyre nuk bëjnë gjë tjetër përveç se i fryjnë më shumë zjarrit të xhehenemit tek i cili kanë për të përfunduar.

Kurani është fjala e Allahut. Po qe se në zemrat tona ka zënë vend vetëm ai dhe me të ne shpërngulemi për në botën tjetër mund të jemi prej atyre njerëzve për të cilët profeti Muhamed është shprehur se “xhehenemi nuk e djeg personin në zemrën e të cilit ka zënë vend Kurani.”

Vëllezëri apo bashkim?

Në Kuran thuhet:

*“Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër
me njëri-tjetrin”*

Ky ajet kuranor është i njohur pasi në shumë hutbe të xhumasë apo në vase të ndryshme, apo edhe në biseda të ndryshme që bëhen në shoqëri mes besimtarësh përdoret shpesh duke transmetuar domethënie të shumta apo më mirë të themi duke e komentuar në mënyra të ndryshme.

Fakti që ne jemi besimtarë do të thotë që kemi arritur në një pjekuri të tillë që të kuptojmë më së miri disa aspekte mjaft të rëndësishme të jetës. Jemi brumosur me një botë shpirtërore mjaft të pasur e cila padyshim që nuk mund të thuhet se ka arritur kulmin e plotësimin të saj. Ne jemi besimtarë dhe kjo do të thotë se kemi arritur në një shkallë të caktuar besimi. Kemi arritur të krijojmë një vizion në lidhje me besimin tonë, pra ajo që kemi bërë nuk është gjë tjetër veçse një mbështetje diku, kemi gjetur një ngrohje shpirtërore diku, dhe te një Krijues. Të arrish të gjesh një mbështetje shpirtërore diku nuk është aspak e lehtë pasi kjo mbështetje tregon dhe paraqet edhe një siguri që i kemi dhënë atij që i kemi besuar. Ky lloj besimi në fakt, lidhet drejt për drejtë

me zemrën dhe shpirtin tonë, pasi siç e dimë, është zemra thelbi i çdo gjëje, çdo lëvizjeje të pjesëve të trupit, të çdo qelize të trupit bile, pasi çdo lëvizje ne e bëjmë të vetëdijshëm dhe rrjedhimisht edhe me shpirt. Një fenomen i tillë vihet re shumë herë në jetën tonë të përditshme. Kështu psh:

Që në momentin kur i japim dorën një njeriu qoftë ky besimtar apo jo, shfaqim ndaj tij një lloj mbështetjeje dhe sigurie. Në plan të parë ne tregojmë një lloj respekti ndaj atij individ duke i shtrënguar dorën dhe duke i dhënë të kuptojë se ne jemi të paktën miq me njëri-tjetrin. Këtu është pikërisht ajo kënaqësi shpirtërore e cila na lidh me të, pra është një ndjenjë dashamirësie dhe mirëkuptimi që na çon më pas edhe në një lloj bashkimi zemrash.

Nga ana tjetër duke shtrënguar duart me njëri-tjetrin lëmë të kuptojmë se jemi në paqe dhe harmoni dhe se e duam njëri-tjetrin në të mirë dhe në të keqe. Por këtu duhet pranuar edhe ajo që, jo çdo shtrëngim dore tregon të

*Sipas një hadithi të Profetit tonë thuhet:
"Nuk është prej nesh ai i cili nuk mendon
për vëllain e tij besimtar atë që mendon edhe
për vete"*



njëjtën siguri dhe mirëkuptim. Pikërisht, këtu qëndron edhe thelbi i çdo gjëje, sepse çdo gjë është e lidhur me gjendjen shpirtërore të individit. Ashtu sikurse e thotë edhe Pejgamberi ynë Muhamedi (as) në një hadith: **"Veprat vlerësohen sipas qëllimit"** askush nuk mund ta dijë se ky veprim ishte me të vërtetë sipërfaqësor apo jo. Askush nga ne nuk mund ta kuptojë të vërtetën e saj përveç Allahut të Lartë, një dhe të vetëm, por ne gjithmonë i besojmë faktit që pavarësisht se nuk i dimë sjelljet dhe veprimet e drejta të njerëzve, të paktën kemi mundësi të përcjellim ngrohtësi dhe sinjeritet tek ata.

Një element mjaft goditës për të kuptuar sa më mirë këtë, është edhe "buzëqeshja". Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s.) e ka dhënë mesazhin e tij duke thënë: **"Edhe një buzëqeshje është një sadaka"**

Në momentin kur dhurojmë një buzëqeshje tregojmë dhe transmetojmë te tjetri ngrohtësi dhe afrimitet. Dhurimi i një buzëqeshjeje i hap zemrën njeriut duke e bërë atë me tjetrin një të vetëm. Në atë moment organizmi ndien një lloj çlirimi dhe dukesh se je më i lirë dhe më i qetë në vetvete dhe njëkohësisht ndien një lloj gatishmërie edhe më të madhe për t'u pajtuar me problemin e tjetrit. Prandaj edhe dhurimi i një buzëqeshjeje është quajtur si një sadaka sepse ashtu sikurse një sadaka e gëzon tjetrin duke e vlerësuar si një kontribut ashtu edhe buzëqeshja vlerësohet si një lloj kontributi duke bërë të mundur forcimin e një marrëdhënieje dhe krijimin e një baze për mbështetje.

Pozicionimi i individit në momentin e parë të komunikimit dhe sinjalet e para të këtij komunikimi janë përsëri elemente që të afrojnë në një siguri dhe mbështetje. Mënyra se si qëndrojmë kur flasim me dikë, mimika e fytyrës, lëvizjet e para të trupit përbëjnë disa elemente të cilat formojnë imazhin e parë të besimit dhe të mbështetjes së kërkuar. Reflektimi pozitiv te individit që kërkon të marrë një mesazh nuk është gjë tjetër vetëm një shprehje besimi dhe sigurie si dhe një kurajë për të ecur me hapa të sigurtë përpara.

Njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm në çdo moment dhe kohë për çdo hap që merr pasi rrethi shoqëror nuk mund të jetë përherë ai që dëshirohet në të vërtetë. Jo çdo herë, bile me keqardhje mund të themi se shpesh herë mbetemi pre e reagimeve të ndryshme, të papritura dhe të papëlqyeshme. Nëse kërkojmë një mbështetje dhe besim diku apo te dikush duhet të kontrollojmë veten tonë se sa jemi në gjendje të reflektojmë te tjetri mirëbesimin dhe mbështetjen në momente dhe raste të ndryshme. Sa e kemi forcuar besimin në vetvete dhe sa e kemi pastruar veten tonë për t'u bërë vend edhe të tjerëve aty ku jemi. Sipas një hadithi të Profetit tonë thuhet: **"Nuk është prej nesh ai i cili nuk mendon për vëllain e tij besimtar atë që mendon edhe për vete"** Në këtë rast kemi një tregues mjaft të rëndësi-

shëm të formimit të besimit dhe të mbështetjes, **“të qënurit human”**, një virtyt njerëzor ky mjaft serioz dhe domethënës. Ky tipar përbën edhe një urë lidhëse mes dy apo më shumë njerëzve pasi paralelisht me anën shpirtërore ndihmesa dhe kontributi konsiston edhe në aspektin material sado modest qoftë ai. Mjafton të kemi pak bujari në shpirtin tonë dhe modestia del në plan të parë. Mjafton të jemi zemërgjerë dhe njeriu gjen patjetër mbështetje dhe përkrahje. Ajo që ka rëndësi këtu është që mbështetjen e siguroar ta çosh më tutje dhe ta përcjellësh edhe te rrethi shoqëror, pasi shoqëria është e krijuar nga grupe individësh që megjithëse janë të botëkuptimeve të ndryshme kanë disa gjëra të përbashkëta, bujarinë, mirënjohjen, respektin për të tjerët, besnikërinë dhe tolerancën dhe të gjitha këto të çojnë drejt një qëllimi final, formimin i **“vëllazërisë shoqërore”**

Por a kemi të bëjmë me të vërtetë me një vëllazëri shoqërore apo thjeshtë me një njohje shoqërore e cila formon më pas atë që quhet bashkim shoqëror apo grupim shoqëror që ka si një emërues të përbashkët vetëm përshëndetjen e rastit dhe asgjë tjetër? Përshëndetjet e rastit janë të përkohshme dhe nuk përbëjnë një bazë të shëndetshme të një shoqërie të plotë. Në një shoqëri të tillë nuk mund të thuhet se krijohen bazat e një besimi dhe mbështetjeje pasi edhe njohja me individin është shumë e paktë dhe e pamjaftueshme për të realizuar një veprim të duhur megjithatë edhe në këto raste duhet të tregohemi të kujdesshëm në kultivimin e vlerave të larta njerëzore dhe normave kulturore pasi këto njohje të çastit mund të bëhen baza për një njohje më konkrete edhe për një të nesërme më të begatë. Edhe Pejgamberi ynë Muhamedi (a.s.) thotë: **“Mos e duaj mikun plotësisht pasi nesër mund të bëhet edhe armiku yt, por edhe armikun mos e urrej plotësisht pasi nesër mund të bëhet edhe miku yt”**

E vërteta është se çdo njohje e re sjell një shoqëri të re e cila nesër mund të kthehet në një vëllazërim të ri dhe njëkohësisht edhe në

E vërteta është se çdo njohje e re sjell një shoqëri të re e cila nesër mund të kthehet në një vëllazërim të ri dhe njëkohësisht edhe në një zgjerim të vëllazërisë aktuale, por në këtë situatë, kujdesi duhet të jetë akoma edhe më i madh, pasi jo çdo njohje e re dhe shoqëri e re luan një rol pozitiv në formimin e vëllazëri.



një zgjerim të vëllazërisë aktuale, por në këtë situatë, kujdesi duhet të jetë akoma edhe më i madh, pasi jo çdo njohje e re dhe shoqëri e re luan një rol pozitiv në formimin e vëllazëri. Këtu pikërisht një rol parësor luan edhe çështja e besimit pasi nëse e duam dhe e afrojmë një individ për hir të Allahut dhe për të fituar kënaqësinë e Tij atëherë kjo shoqëri me të vërtetë do të ketë frytet e saj në të ardhmen dhe do të na ndihmojë në forcimin e vëllazërisë, kështu ajo nuk do të jetë një vëllazëri e përkohshme, por e qëndrueshme mbi baza të forta aty ku besimi është më i fortë, gjithmonë me qëllim fitimin e pëlqimit të Allahut, aty ku urdhrat e Allahut dhe jeta e Profetit kanë gjetur një zbatim mjaft të gjerë, padyshim që aty mbështetja është edhe më e madhe dhe më e sigurtë. Atëherë edhe njerëzit forcojnë besimin te njëri-tjetrin duke krijuar kështu një unitet të pathyeshëm që i qëndron të gjitha kohërave.

VËLLAZËRIA NË ISLAM

Në lidhje me këtë temë Allahu xh.sh. në Kur'anin famlartë urdhëron e thotë: "S'ka dyshim se besimtarët janë vëllazër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllazërve tuaj dhe kini frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti)." (**Huxhurat,10**) Siç kuptohet dhe nga ajeti Kur'anor besimtarët janë vëllazër pa marrë parasysh ngjyrën, racën, gjuhën, kombin etj. Besimtarët duhet që të jenë të dashur në mes tyre.

Muhammedi (a.s.) duke dashur të tregojë rëndësinë e vëllazërisë në islam ka thënë: "Nuk do të hyni në xhennet derisa të besoni dhe nuk do të besoni derisa të mos duheni ndërmjet jush. A dëshironi t'ju tregoj një gjë të cilën, nëse e bëni, do të respektoheni mes vete? Përhapeni selamin midis jush" (**Muslim**) Përsëri Pejgamberi a.s. në një hadith të tij ka thënë: "Mos kini smirë për njëri-tjetrin, mos mashtroni, mos urreni njëri-tjetrin, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit. Jeni vëllazër. Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i bën padrejtësi, nuk e gënjen dhe nuk e përçmon atë. Devotshmëria është këtu (e tha këtë tri herë, duke bërë me shenjë nga zemra e tij). (**Muslim**)

Transmetohet prej Omer ibn Hattabit, i cili thotë: Se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ka disa njerëz, të cilët nuk janë as pejgamberë e as dëshmorë, por në Ditën e Gjykimit do t'ua kenë lakmi pejgamberët dhe dëshmorët për pozitën e tyre te Zoti. Shokët i thanë: O Pejgamber i Allahut, na trego kush janë ata? Ai u përgjigj; Ata janë njerëzit të cilët janë dashur mes veti në emër të Zotit, pa patur lidhje fisnore mes vete dhe pa pasur ndonjë interes material të përbashkët. (**Ahmedi**)

Pra vëllazëria për të cilën na porosit dhe na nxit Muhammedi (a.s.) është vëllazëria që i ka rrënjët thellë në besim. Ajo nuk është sipërfaqësore e bazuar në interesa meskine të kësaj jete. Ajo është dashuria e vërtetë që shprehet me fjalë dhe mirësjellje. Kjo është dashuria që e nxit besimtarin të dëshirojë për vëllan e tij në fe, atë që dëshiron për veten e tij. Dhe kush nuk e arrin këtë nivel dashurie do të thotë qe besimi i tij nuk është i plotë. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Askush prej jush nuk është besimtar (i vërtetë) përderisa atë që e dëshiron për vete nuk e dëshiron edhe për vëllanë e tij". (**Buhari Muslim**) Në një hadith tjetër Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

"Ai që i largon muslimanit një brengë ne këtë botë, Allahu ia largon brengën Ditën e Kijametit; Ai që i mbulon muslimanit një të metë në këtë botë, Allahu do t'ia mbulojë të metat e tija në Ditën e Kijametit."

Në kohët aktuale muslimanët kanë nevojë më tepër se kurrë të forcojnë lidhjet vëllazërore në mes tyre. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Shtatë persona Allahu do t'i vendosë nën hijen (mbrojtjen) e Tij atë ditë kur nuk do të ketë tjetër mbrojtje përveç hijes së Tij..." e ndërta janë. "Dy njerëz të cilët në emër të Allahut duhen, janë shoqëruar dhe të tillë kanë mbetur deri në ndarje (vdekje)". (**Buhari Muslim**)

Tregohet se një mbret urdhëroi t'i priten kokat tre njerëzve të mirë, ndër të cilët ishte edhe Ebul Husej en Nuri, i cili u afërua i pari te vendi i ekzekutimit. I habitur nga veprimi i tij, mbreti e pyti: Përse u afrove i pari? Ai iu përgjigj: "Që t'i jap kohë për të jetuar vëllazërve të mi". Kjo fjalë e sinqertë preku zemrën e atij mbreti, i cili i falë që të tre më pas.

Ndërsa sot, krejt ndryshe nga ky moral i lartë njerëzor e Islam, shumë njerëz në shoqëri mundohen të të marrin jetën, jo

të japin kohë ta jetosh atë. Prandaj duhet të jemi të bashkuar njëri me tjetrin sepse po nuk hyri përçarja në një popull në atë popull armiku nuk hynë. Allahu i madhëruar në Kuranin famlartë urdhëron e thotë: “Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kuranin) e Allahut, e mos u përçani”!

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur muslimani lutet për vëllanë e tij, pa ditur gjë (ky i fundit), lutja pranohet. Te koka e lutësit qëndron një melek që ka për detyrë që, pas çdo lutjeje të mirë për vëllanë musliman të thotë Amin, ta dhëntë

Allahu edhe ty të njëjtën gjë!”
(Muslim)

Tregon El-Adviu (sipas transmetimit të Kurtubiut): “Ditën kur u bë lufta e Jermukut unë shkova ta kërkoj djalin e xhaxhait. Me vete kisha marrë pak ujë për t’ia dhënë ta pijë për të shuar etjen. Kur e takova, i thashë që të pijë dhe ai pohoi me kokë. Ndërkohë u dëgjua një njeri që rënkonte... djali i xhaxhait ma bëri me kokë që të shkoj tek ai që rënkonte për t’i dhënë ujë. Ishte Hisham Bin el Asi ai që rënkonte dhe kur i thashë të pijë ujë, ai pohoi me kokë, por kur dëgjoi (Hishami)

një tjetër dukë rënkuar për ujë ma bëri me kokë që të shkoj tek ai (për t’i dhënë ujë). Kur arrita, pashë se ai kishte vdekur. U ktheva përseri te Hishami, por edhe ky tashmë kishte vdekur. Kur u ktheva tek djali i xhaxhait, as atë s’e gjeta në jetë.” Siç shihet asnjëri prej këtyre nuk piu ujë (edhe pse ishin të etur), sepse u vetëdijuan për vëllezërit muslimanë. E kështu Allahun xh.sh. që ka dashur të ri ta fusin në emrat e gjithë muslimanëve.



Ajetet dhe Hadithe

“Ju jeni populli më i mirë se të gjithë të tjerët që janë paraqitur ndonjëherë, sepse ju kërkoni të bëhen vepra të mira dhe pengoni nga të këqijat.” (Ali Imran, 110)

“Besimtarët dhe besimtareet janë miq të njëri-tjetrit, porosisin për vepra të mira dhe pengojnë nga veprat e këqija.” (et-Teube, 71)

“O besimtarë, shmanguni morisë së pandehjeve! Disa pandehje me të vërtetë janë mëkat. Dhe mos spiunoni njëri-tjetrin e as mos përgeshni njëri-tjetrin! A do dikush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Ju atë e dini se është shumë keq - prandaj, ruajuni Allahut; All-llahu vërtetën pranon pendimet dhe është shumë i mëshirshëm”. (Kuzhurat, 12)

“Mos paso atë për çka nuk di! Edhe shikimi, edhe dëgjimi, edhe të kuptuarit, për të gjitha këto me siguri do të japësh llogari”. (Isra, 36)

“Kurse ata që ofendojnë besimtarët dhe besimtareet për diçka që nuk e meritojnë, ngarkohen vetë me shpifje dhe mëkat haptazi”. (Ahnab, 58)

“Assesi në asnjë mënyrë mos e nënçmoni asnjë vepër të mirë, goftë edhe ta takoni vëllanë tuaj me buzëqeshje”. (Muslimi)

Askush nga ju nuk beson (plotësisht) përderisa nuk dëshiron për vëllain e vet atë që e dëshiron për vetveten”. (Buhari dhe Muslim)

“Kush i ka bërë një padrejtësi (zullum) vëllait të vet në nderin e tij apo në diç tjetër, le t'i kërkojë falje atij po atë ditë, para se të vihen veprat në llogari: nëse e ka një vepër të mirë - do t'i paguhet me të padrejtësia; por nëse nuk do të ketë vepra të mira, atëherë do t'i merren mëkatet e të dëmtuarit dhe do t'i jepen atij”.
(Buhari)

“Muslimani është vëlla i muslimanit: nuk i bën atij padrejtësi e as nuk e lë në baltë. Ai që gjendet në nevojë të vëllait të tij, All-llahu do t'i gjendet në nevojën e tij. Ai që e shiron një barrë nga muslimani, All-llahu do ta shirojë nga ai një nga barrët e ahiretit. Ai që e mbulon një musliman All-llahu do ta mbulojë atë Ditën e Kiametit.” (Buhari dhe Muslim)

“Mos i bëni xili njëri-tjetrit, mos e mashtroni njëri-tjetrin; mos e urreni njëri-tjetrin; mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, duke u hidhëruar; mos i ndërhyrni me shitblerjen tuaj tjetrit në shitblerje. Bëhuni rob të Allahut, vëllexër të vërtetë. Muslimani është vëlla i muslimanit. Nuk i bën atij padrejtësi, nuk e degradon e as nuk e poshtëron. Devotshmëria është këtu”. Tri herë tha duke bërë shenjë në gjoksin e tij. Një njeriu i del mjaft e keqja, nëse e degradon vëllain e tij musliman. Secilit musliman patjetër i janë të shenjta dhe të paprekshme: jeta, pasuria dhe nderi i tij”. (Muslimi)

“Muslimani ndaj muslimanit i ka gjashtë detyra. - kur ta takosh, jepi selam; kur të fton, përgjigju; kur prej teje kërkon këshillë, këshilloje; kur të teshtijë dhe falënderon All-llahun me “elhamdulillah” përgjigju me “jerhamukallah”; kur të sëmuret, vixitoje dhe kur të vdes, përcille deri në varr”. “Kush e vixiton një të sëmurë ose e vixiton vëllain e tij për hir të Allahut, do t'i thërras një engjëll: ti je i mirë dhe është e mirë ecja jote dhe po ashtu ke përgatitur një vend në ‘Phennet’”. (Tirmidhi)

“Kur ndonjëri prej jush e takon vëllain e vet, ta përshëndesë me selam, nëse ata i ndanë ndonjë dru ose ndonjë mur dhe përsëri takohen, le ta përshëndesë atë”. (Ebu Davud)

“Lutja e një njeriu musliman për vëllain e tij jo të pranishëm është e pranueshme. Te koka e lutësit është një engjëll i autorizuar, i cili kur lutësi kurdo goftë bën një lutje në dobi të vëllait të tij, thotë: “Pranoje o Lot, edhe try të goftë po ashtu!” (Muslimi)

“Mos iu gëzo fatkeqësisë së vëllait tënd, sepse All-llahu mund ta mëshirojë atë, kurse fatkeqësinë e tij të ta caktojë try”. (Tirmidhi)



Pendimi dhe loti

*Pendimi i pranuar
heq pengesat mes robit
dhe Zotit dhe ky nivel
shpirtëror është shumë i
rëndësishëm për punët
e mira, sepse kapërcimi
i pengesave që na
dalin përpara rrugës së
realizimit të qëllimeve
tona është i nevojshëm
dhe kështu shpirti duhet
bërë gati për qëllimin
kryesor. Për këtë arsye,
në të gjitha rrugëtimet
mistike pastrimi i shpirtit
fillohet me pendim.*

Në rrobaqepës pyeti një burrë të devotshëm:

- Çmendoni për fjalën profetike: "Allahu i Lartmadhëruar e pranon pendimin e robit të Tij gjynahqar pa i dalë shpirti"?

Burri pyeti:

- Po, kështu është. Po ti, ç'punë bën?

- Jam rrobaqepës.

- Cila është gjëja më e thjeshtë në rrobaqepësi?

- Të presh copën me gërshërë.

- Sa vjet ke që e bën këtë punë?

- 30 vjet.

- A mund ta presësh copën kur të vijë shpirti për të dalë?

- Jo, nuk mund ta pres.

- O rrobaqepës! Nëse një punë të cilën në fillim e ke pasur të vështirë ta bësh, por më vonë e ke mësuar dhe për 30 vjet e ke bërë me lehtësi dhe më pas nuk mund ta bësh, si mund të pendohesh në atë moment kur ti nuk je penduar

për gjithë jetën tënde? Pendohu sot sa ke forcë! Në të kundërt, kur të japësh frymën e fundit mund të mos arrish të pendohesh dhe të thuash fjalën e dëshmisë... A nuk e ke dëgjuar fjalën profetike: "Pendohuni sa më shpejt para se t'u vijë vdekja"?

Më pas rrobaqepësi pranoi të pendohet dhe kështu u bë prej të devotshmëve.

Siç shihet edhe në këtë tregim, robërit kanë një mijë e një pengesa të kësaj bote, më e keqja prej të cilave është shtyrja për më vonë pendimit të sinqertë. Pranimi i pendimit është haja e gjithë jetës tonë. I Dërguari i Allahut u pati thënë miqve të Tij të ngushtë që derti më i madh është gjynahu, ndërsa ilaçi më i mirë për të është pendimi në errësirën e natës.

Pendimi, që do të thotë t'i drejtohesh Allahut, luan një rol të rëndësishëm në ngritjen dhe forcimin e zemrës dhe është rruga e vetme edhe për t'u pastruar nga papastërtitë shpirtërore. Pendimi i pranuar heq pengesat mes robit



Me të lexohen sa e sa faqe urtësishë të palexueshme, sepse loti është një gjuhë hyjnore së cilës i ngarkohen kuptime që fjalët nuk mund t'i mbartin dhe dhe robi që i shpreh ato njëkohësisht me kërkon prej Zotit të tij gjëra që as nuk mund ti imagjinojë...

dhe Zotit dhe ky nivel shpirtëror është shumë i rëndësishëm për punët e mira, sepse kapërcimi i pengesave që na dalin përpara rrugës së realizimit të qëllimeve tona është i nevojshëm dhe kështu shpirti duhet bërë gati për qëllimin kryesor. Për këtë arsye, në të gjitha rrugëtimet mistike pastrimi i shpirtit fillohet me pendim.

Pendimi i parë pati filluar me Pejgamberin e parë, Ademin (a.s.). Ai qe penduar duke u lutur kështu: "O Zoti ynë! Ne e dhunuam veten tonë. Nëse nuk na fal dhe nuk na trajton me dhembshuri, patjetër, që do të jemi prej të humburve." (el-A'raf, 23) Kjo lutje është shembulli i pendimit për brezat që do të vijnë pas tij deri në ditën e gjykimit.

Miqtë e ngushtë të Allahut e ndajnë pendimin në tre grupe:

1- Pendimi i njerëzve të thjeshtë: Këta pendohen për gjynahet e tyre.

2- Pendimi i robërve të zgjedhur (havas): Këta pendohen nga pavetëdija.

3- Pendimi i robërve më të zgjedhur: Këta pendohen që të jenë më afër Allahut.

Si në çdo punë tjetër të mirë, edhe në pendim është kusht, sinqeriteti. Shumë miq të ngushtë të Zotit janë penduar edhe për pendimet e bëra. Pra është e domosdoshme që të ndjehemi nevojtarë për pendesë, t'i mbështetemi Allahut dhe të meritojmë atë që në ajetin Kuranor cilësohet si "**pendimi i sinqertë**", sepse egoja dhe shejtani, dalin në pah dhe bëhen mjeshtër për t'u dhënë kah bukurive të thelbit njerëzor atëherë kur nuk gjejnë rrugë për të ndryshuar shpirtin. Kështu duke e futur në kurth njeriun i shkojnë dëm edhe pendimet e tij. Ndërsa kthimi në pendim, siguron një falje që do të shpëtojë lumturinë e ahiretit.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

"Nëse pendoheni mund të

mendonit se Zoti do të ju mbrojë; por nëse përsëri humbisni edhe ajo kthehet në pendim për ju." (Isra, 8)

Ai që vazhdimisht e prish pendimin e tij bëhet maskara i shejtanit. Ai tashmë, sa herë që të pendohet e prish menjëherë atë, mjafton që shejtani dhe ata që janë bërë pre e tij t'i thonë një herë "Jazëk të qoftë!". Prandaj edhe në ajetin Kuranor është thënë:

"O ju që besuat! Kthehuni te Allahu duke u penduar me besnikëri dhe fisnikëri të plotë." (Tahrim, 8)

Në librin e Hadithit me titull Xhamiu's-Sagir thuhet që meleku që regjistron gjynahet e njeriut i shkruan ato pas gjashtë orësh nga çasti që është kryer mëkati dhe pret se mos vallë pendohet për atë që ka bërë. Njeriu nuk duhet të mendojë: "Unë prapë kam për t'u treguar i dobët dhe kam për ta bërë këtë gjynah, prandaj më mirë të mos pendohem!".

Hadithi "Pendimi është përulje dhe shqetësim në zemër

Nisur nga kjo, nganjëherë për faljen e një gjynahu duhet një mijë lot dhe nganjëherë një pikë loti fshin një mijë gjynahe.



për atë që ke bërë” nënvizon pendimin që nuk të çon në gjynah.

Transmetohet që:

Një gjynahqari të penduar iu dha lista e gjynaheve, ndërkohë që ai ishte i vetëdijsëm plotësisht për to, dhe iu tha: “Lexoje këtë!”. Aq shumë qau njeriu fajtor përballë kësaj situate, sa që nga lotët e tij gjynahet nuk u dukën. Më në fund këta lot të singertë i fshinë plotësisht ato mëkate dhe kështu fajtori u fal.

Nisur nga kjo, nganjëherë për faljen e një gjynahu duhet një mijë lot dhe nganjëherë një pikë loti fshin një mijë gjynahe.

Loti është një burim pendimi për ata që lidhen me dashurinë hyjnore. Loti i pastron gjynahet dhe është falënderim për Zotin. Loti është vendi i shpresës së Allahut të lartë.

Për ata që e vështrojnë botën me lot të singertë, çdo pikë loti është si pasqyra që pasqyron

një mijë oqeane dhe në çdo pikë e thërrmijë është mjaft e dukshme dhe e qartë e fshehta hyjnore. Me të lexohen sa e sa faqe urtësishë të palexueshme, sepse loti është një gjuhë hyjnore së cilës i ngarkohen kuptime që fjalët nuk mund t’i mbartin dhe dhe robi që i shpreh ato njëkohësisht me kërkon prej Zotit të tij gjëra që as nuk mund ti imagjinojë... Prandaj dashuritë gjejnë shprehje në krye të burimit të lotit. Të lodhurit pushojnë në bregun e saj.

Sa bukur e shpreh ky tregim vlerën e një pike loti që derdhet për hir të Allahut:

Xhunejd Bagdadi një ditë duke ecur rrugës pa engjëjt që zbritën nga qielli dhe që po grumbullonin diçka në tokë. Pyeti njërin prej tyre:

- Çfarë po grumbulloni?

Engjëlli iu përgjigj:

- Një mik i ngushtë i Allahut duke kaluar këndeje lëshoi një “ah!” nga vetja dhe u derdhën disa pika loti. Me këtë rast, po i grumbullojmë ato pika loti që të bëhemi pjesë e mëshirës dhe e faljes së Zotit.”

Në hadith thuhet:

“Nuk ka pikë loti më të frytshme për Allahun se këto dy pika. Njëra është pika e lotit e derdhur vetëm për frikën dhe dashurinë e Allahut në errësirën e natës, ndërsa tjetra është pika e gjakut e derdhur në luftë në rrugën e Allahut.

Shembullin se si pendimi dhe lotët e pastrojnë gjynahqarin, Mevlana e tregon me ujërat që ndoten, kthehen në avuj dhe përsëri bien në tokë si mëshirë e pastër.

“Uji kur ndotet, turbullohet, ashtu si njeriu nuk rri i qetë...”

“Fillon t’i përgjërohet Zotit. Pas këtyre përgjërimeve Zoti e kthen në avull dhe e merr në qiej. Aty e pastron duke e kaluar në lloj-lloj rrugësh. Më pas e bën që të bie në tokë ose në formë shiu, ose bore apo breshëri. Më në fund e çon në një det të thellë që nuk i duket fundi.”

Padyshim që, këto simbole shprehin dashurinë dhe mëshirën që tregon Allahu ndaj robërve të Tij të cilët dëshiron t’i shpëtojë. Nëse

dielli i pishmanllëkut bashkohet me ujin e pendimit tek njerëzit, zemrat e të cilëve janë të ndotura me papastërtitë e gjynahut, Allahu i Lartmadhëruar ata shpirta i merr në qiej. Ai i pastron nga pluhuri, dheu dhe nga të gjitha papastërtitë e pshore. Përsëri do të pasqyrohet në tokë si qenia më e ndershme, pra si mëshirë. Kjo gjë shihet më qartë në namaze. Prandaj edhe namazet e falura në mënyrë të drejtë janë quajtur "Miraxhi i besimtarit"

Meqenëse njeriu nuk arrin shumë herë ta kuptojë këtë të vërtetë dhe humbet në këtë botë, në vend që të qajë shkrihet nga të qeshurat, Allahu i Lartë thotë:

"Po qeshni... Nuk po qani... Silleni në mënyrë të pavetëdijshme..." (en-Nexhm, 60-61)

"Si dënim për ata që kanë bërë le të qeshin pak dhe të qajnë shumë!.." (et-Tevbe, 82)

Pra Allahu dëshiron t'i pastrojë gjynahet e robërve me lot dhe pendim. Mevlana e shpjegon kështu rëndësinë që ka loti:

"Kur qiriu qan dhe derdh lot bëhet edhe më i shndritshëm. Edhe dega e pemës me begatinë e resë që qan dhe ngrohtësinë e diellit gjelbërohet dhe freskohet. Pra që të rritet dhe të zhvillohet një fryt duhet nxehtësi dhe ujë"

"Për pranimin e pendimeve duhet re dhe shkrepimë, pra lot dhe shpirt i djegur."

"Nëse shpirti nuk dridhet dhe reja e syrit nuk nxjerr lot, si mund të shuhet zjarri i gjynahut dhe i mllëfit të egos? Si mund të duket në shpirt fryti i bashkimit, pra shndritja e dritës së dukshme hyjnore? Si mund të kuptohet? Nëse shiu nuk bie, si mundet kopshti i trëndafilave të gjelbërojë? Si munden lulet të qëndrojnë së bashku?"

"Lëre natyrën të qajë. Këto toka kur u mungon uji thahen. Edhe ujërat zverdhen kur qëndrojnë larg lumenjve, marrin erë dhe turbullohen."

"Kopshtet e gjelbëruara zverdhen kur u mungon uji, gjethet vyshken e bien dhe kështu kthehen në një vend sëmundjesh..."

"Për t'u mbrojtur nga një gjendje e tillë sytë e Shuajpit (as) u verbuan. Ndërsa Pejgamberi (a.s.) pati thënë:

Shembullin se si pendimi dhe lotët e pastrojnë gjynahqarin, Mevlana e tregon me ujërat që ndoten, kthehen në aruj dhe përsëri bien në tokë si mëshirë e pastër.



"Sikur të dinit atë që di unë do të qeshnit pak dhe të qanit shumë, nuk do t'u vinte ndër mend të hani dhe të pini..." (Xhamiu's-sagir, V. II, fq. 10).

Vetëm njerëzit shpirtërorë që e pastrojnë gjithë jetën e tyre plagën që kanë në shpirt me lotët që u rrjedhin, mund të bëhen pjesë e shpirtave të dashuruar që mund të hynë në xhenetin e faljes. Prandaj duke filluar që nga pejgamberët, të gjithë të devotshmit, besnikët si në ditë të mira ashtu edhe në vështirësi, në gëzime dhe në fatkeqësi, gjithmonë i kanë qëndruar pranë Allahut të Lartmadhëruar duke iu lutur në çdo moment, pasi për shkak të dukurive të quajtura "**shkarje në gabime**" të bëra jashtë vullnetit të Pejgamberëve, nuk mund të mendohet asnjë rob që nuk mund të ketë nevojë për pendim. Pendimi është rruga e vetme për t'u afruar me Allahun, meqenëse në përmbajtjen e tij të vërtetë shpreh një pendim dhe

një përrulje shpirtërore.

Nga ana tjetër, vuajtjet dhe mundimet që Allahu i Lartmadhëruar u ka dhënë robërve me lotët dhe pendimin që ka dëshiruar prej tyre, janë një lloj marrëdhënieje e përjetshme. Kjo është një marrëdhënie kaq e frytshme sa që ata që e dallojnë nuk ankohen duke përfitur një fitim të pafund. Mevlana si njëri prej tyre shprehet qartë dhe bukur:

“Allahu i Lartmadhëruar merr prej teje në këtë botë disa pika loti, por përkundrejt saj të dhuron sa e sa burime uji të xhenetit. Ai merr prej teje ato rënkime plot mundime dhe dashuri dhe përkundrejt çdo rënkimi të jep me qindra stade shpirtërore, pozita të paarritshme.”

Por duhet ta dish se çdo e qarë nuk është e njëjtë. Ka shumë dallime mes tyre. Gjithashtu ka aq shumë rënkime të ftohta, sipërfaqësore, gënjeshtare që janë thjeshtë mungesë vetëdijëje dhe mashtrimë.”

Sufjani Thevri thotë:

“Të qarit ka dhjetë mënyra. Nëntë nga këto janë hipokrizi dhe dyfytërsi. Vetëm njëra prej tyre është për hir të Allahut. Ja pra, të qash vetëm për hir të Allahut, qoftë kjo edhe një herë në vit, bëhet shkak me ndihmë të Zotit për shpëtimin e robit nga xhehenemi.”

Padyshim që lot të tillë janë lot dhunimi. Është një e qarë që të ngjall, urrejtje dhe që shpreh një lloj meskiniteti. Këta janë lotët e pavlerë të atyre që pastrojnë ballin dhe janë në humbje dhe për njerëz të tillë.

E qara si një kërkesë hyjnore nuk është një lot që do të na ul vlerat tona ndaj miqve dhe

armiqve, por që do të na lartësojë në qiej dhe që do të na bëjë të jetojmë miraxhin në shpirt. Lotët tanë ashtu si detet e thella që mbartin sa e sa materiale dhe i mbrojnë nga mbytja, duhet të bëhen mbrojtësit tanë nga mbytja dhe të na shpëtojnë.

Një tjetër çështje e rëndësishme është që e qara të mos jetë një e qarë ankimi, sepse ka edhe një gjendje mospëlqimi në të qarë e cila asnjëherë nuk është e pranueshme, pasi ankesat e çojnë njeriun deri në revoltim duke e shfarosur gjithë pasurinë e tij. Kjo e çon edhe në një dënim të Zotit. E qara për të cilën flasim nuk kërkon dënimin, por mbart ankthin për të kënaqur mikun e ngushtë dhe për të pastruar gjynahun nga papastërtitë.

Si përfundim, kur të vijë vdekja të gjithë ata që flenë zgjohen, pra hapin sytë dhe shohin të vërtetën, por në atë frymë të fundit kjo nuk ka asnjë dobi tashmë. Kjo është e njëjtë sikurse nuk iu mundësua Faraonit... Sa bukur e shpreh Mevlana:

“Njerëzit e mençur qajnë në fillim, ndërsa të paditurit vrasin mendjen në fund dhe mër-ziten. Ti shihe fundin në fillim të punës që në ditën e gjykimit të mos pendoresh!”

“Le të jetë një mësim për ty gjendja e zogut i cili sapo pa grurin në grackën e gjuetarit u emocionua dhe humbi kontrollin. Kështu që i hëngri kokrrat e grurit në mënyrë të pavetëdijshme, por ra në kurth. Këtë herë lexoi sa e sa Jasin dhe sa Enam lexoi që të shpëtonte, por pa dobi! ... Ç’vlerë ka të qash dhe të rënkohesh pasi të ka rënë në kokë fatkeqësia. Ky rënkim duhej para se të binte në kurth...”

Engjëjt i patën thënë kështu Ibrahimit (a.s.) kur ai mësoi se populli i Lutit do të shkatërron për shkak të poshtërsive që çonin në shpagimin hyjnor, ndërkohë që dëshironte të lutej më mëshirë për ta pasi nuk e dinte se në ç'skallë ishin:

- Tashmë kaloi koha e lutjes!...

Vdekja që ka përcaktuar Zoti nuk dihet se ku, kur dhe si do të na vijë. Për këtë arsye, është e nevojshme që shpirtat të formohen me formulën enigmatike "Vdisni para se të vdisni!" dhe në çdo moment të jenë gati për t'u bashkuar me Zotin. Në të kundërt, fryma e fundit bëhet një kohë e humbur plot me rënkime "Aman, për ku kështu!" ...

Në ajet thuhet:

"Me të vërtetë vjen dehja e vdekjes dhe thuhet: "Ja pra, (o njeri) kjo është ajo prej së cilës je larguar prej kohësh!" (Kaf/19)

Si rezultat, çështja më e rëndësishme e robërve është "pastrimi i epshit" dhe "pastrimi i zemrës". Pendimi dhe loti që shpjeguar deri këtu është vetëm një derë që hapim për t'u pranuar në një gjendje të tillë. Padyshim që pasi të hyjmë brenda është i domosdoshëm edhe kryerja e të gjithë punëve të mira që duhen bërë. Pas kryerjes së farzit, vaxhibit dhe sunetit duhet të plotësojmë edhe të drejtat e robit, të drejtat e prindërve, sadakanë për hir të Allahut dhe t'u afrohem i të gjitha krijesave më mëshirë, dhembshuri dhe falje. P.sh. ata që pajtohen me këtë mundim, janë më të pranueshëm për faljen hyjnore se ata që nuk kanë mëshirë dhe dashuri ndaj krijesave që rënkoj-

në dhe kërkojnë ndihmë kur thonë "Keni mëshirë për ne!", janë udhëtarët e humbur dhe të habitur të jetës.

Prandaj të gjithë shpirtat duhen t'i drejtohen Zotit duke i kryer të gjitha veprimet dhe sjelljet me pendim dhe lot. Një drejtim i tillë, padyshim që përfshin çdo moment të jetës. Gjithashtu ka edhe disa momente apo situata të tjera të cilat janë një fitim krejt tjetër për robërit. E njëjtë sikur bukuritë dhe vlera e stinës së pranverës mes të tjerave ka aq shumë pranvera shpirtërore që i dhurohen robit, muaji më me vlerë është muaji i Ramazanit që përfshin edhe natën e Kadrit që është më me vlerë se një mijë muaj, pra natë në të cilën është zbritur edhe Kurani i cili ndriçoi botën dhe njerëzit. Ky muaj i veçantë është një hënë e shndritshme që me dritën e saj ndriçon shpirtat e errësuar si nata. Është një dritare e hapur nga qiejt për në miraxh. Në këtë aspekt, ajo që u duhet besimtarëve, shpirtat e të cilëve janë të zgjuar, është që të kalojnë gjithë jetën e tyre me fryte dhe begatitë që do të marrin nga kjo atmosferë e veçantë, pra ta kalojnë jetën me përkushtimin e ramazanit, pasi kiameti për shpirtat e devotshëm që jetojnë në këtë mënyrë është thujse një mëngjes bajrami dhe jo një ditë pendimi.

Zoti ynë na mundësoftë të jetojmë një mëngjes të tillë bajrami! Zoti na pranofte në faljen dhe mëshirën hyjnore me lot të dashurisë, të gëzimit dhe lot të sinqertë!

Amin!



FTESA KURANORE PËR UNITETIN E GJITHË NJERËZIMIT

Njeriu si genie me intelekt, gjithmonë ka qenë skenë e ngjarjeve më të rëndësishme dhe komplekse në këtë gjithësi. Në rast se në një vend funksionon, lëviz apo qarkullon diçka, padyshim se aty do të ketë përkrahës dhe kundërshtarë. Këtë mund ta vërejmë në çdo vend të botës dhe në secilën periudhë që jetoi para nesh. Të gjitha mundimet, vrapimet, përparimet dhe zhvillimet që ndodhin në botë, mendojmë se e kanë të vetmin qellim. Ky qellim pa dyshim se është të jetuarit në mënyrë luksoze pa brenga e vështirësi dhe udhëheqja e të tjerëve. Sepse njeriu e pëlqen që atij t'i përulet dikush dhe të kërkoje diç nga ai. Me një thënie tjetër ai është mendjemadh dhe kërkon që të tjerët t'i nënshtrohen. Kur këtë e bën një in-

divid, pse mos ta bëje një shtet? Pse të mos ketë nën kontroll të gjitha vendet e botës? Mu për këtë, Allahu i Plotfuqishëm në Kur'anin Fisnik neve na ka rrëfyer për bashkësinë dhe parinë e popujve të më hershëm, se si ata – gjegjësisht udhëheqësit e tyre janë munduar që ta koordinojnë të gjithë atë pozitë gjeografike ku kanë jetuar por edhe më gjerë. Shembulli më i mirë dhe efikas i kësaj sigurisht se është ai i **Faraonit**, i cili deklaroi se ishte zoti i egjiptianeve.¹ Për këtë shkak Madhëria Hyjnore e Allahut xh. sh. e porositi Pejgamberin Musa duke i thënë: **“Shko te faraoni se vërtet ai e ka tepruar”**² mirëpo edhe megjithëkëtë faraoni **“I tuboi**

(të gjithë të vetët) dhe u mbajti fjalim. E u tha: “Unë jam zoti juaj më i lartë!”³ Në këtë mënyrë krenaria dhe mburrja e bën njeriun që të mos njoh Autoritetin e lartë që e krijoi atë. Me një pushtet të vogël që poseduan disa sundues të njohur, i tejkaluan kufijtë dhe më në fund vetveten e tyre e gjeten në ferr.

Mënyra tjetër e mburrjes së njeriut është atëherë kur ai të përballohet me të vërtetën dhe drejtësinë, mirëpo për shkak të autoritetit të tij nuk e pranon këtë të vërtetë edhe pse e ka kuptuar. Si shembull më efikas të kësaj e kemi rastin e **Velid ibn Mugires**, i cili edhe pse e dëgjoi me vëmendje të madhe Kur'anin dhe sapo desh të dorëzohet para kësaj mrekullie magjepsë, prapëseprapë nuk

1. Më gjerësishtë shih: Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan – N. Mehmed Solmaz, “Kur’ani Kerime Gore Peygamberler ve Tevhid Mucadelesi” f. 172 – 184.
2. Naziât, 79/17

3. Naziât, 79/23-24.

deshi ta humbe atë autoritet që kishte.¹ Në këtë rast ai ra në mendime dhe halle se çfarë të bënte, cilën rrugë ta zgjidhte etj. Ose me shprehjen Kur'anore "Ai sërish thellohej në mendime. Pastaj mrrolej dhe bëhej edhe i vrazhdë."² Më në fund, e shënoi edhe një brutalitet të madh në mohimin e realitetit të kësaj mrekullie, në historinë njerëzore. Për këtë shkak Allahu xh. sh. i dha vend në Kur'an rastit tij për arsye se në të ka mësim për ata që dinë dhe duan t'i marrin.

Dukuria tjetër më e shëmtuar e mohimit të realitetit dhe mburrja e robit del në pah dhe nuk harrohet asnjëherë kur ai me zilinë dhe burrërinë e tij largohet nga e vërteta. Kjo dukuri bëhet edhe më e shëmtuar kur një prijës i një qyteti apo vendi respektohet nga vendasit e tij, mirëpo me ardhjen e realitetit para e tij largohen nga ai kurse ky edhe më tej vazhdon me mohim. Nuk ka dyshim se shembulli më i mirë i kësaj është rasti i **Ebu Xhehlit**. Iniciativat e shumta dhe tentimet e mëdha të Muhammedit a. s. për ta futur në parinë islame këtë njeri të mençur, gjithmonë ishin aktive. Sa që Pejgamberi a. s. Ebu Xhehlin e futi në listën e atyre tre personave që nëse e pranojnë islam, do të merrte një fuqi dhe hov të madh. Mirëpo ky fat nuk e përfshiu atë, dhe nga kjo u quajt Ebu Xhehl- Babai i Injorancës, ngase me vetëdije e mohoi realitetin.

Këto tri raste janë më të preکشmet si në historinë islame ashtu edhe në atë botërore, sepse këta kishin pushtet dhe autoritet të madh në vendet ku vepronin. Në të njëjtën kohë, këta ishin edhe të mençur dhe

1. Shih, Muhammed Ali Sabuni, Safvetu't-Tefâsir, Sureja el-Muddeththir.

2. Muddeththir, 74/21-22.

Njëra nga detyrat më të rëndësishme e pejgamberëve ishte që të krijojnë barazi dhe unitet në mes njerëzve. Kur Pejgamberi Muhammed shkoi në Medinë, menjëherë krijoi vëllazërimin e atyre dhe asnjëherë nuk e mposhti ndonjërin nga ata.



zellshëm, por edhe trima të mëdhenj. Por me gjithë mundimet dhe faktet bindëse që iu paraqiten këtyre, këta e prishen unitetin demokrat të asaj periudhe dhe se qiten në pah vetëm probleme të shoqërisë. Pasi që Allahu xh. sh. nuk ka lejuar që robi të sundoje mbi robin, nuk deshi t'u jepe mundësitë as këtyre që t'i realizojnë planet e tyre. Përfundimi i këtyre që donin të sundonin dhe pushtonin demokracinë njerëzore, ishte tejet i tmerrshëm. Kontrollimi, logjika e shendosh, perceptimi i drejtë i gjërave e tërheq njeriun kah e vërteta. E kundërta e këtyre tre kundërshtareve ndodhi mu në kohën e Pejgamberit a. s. Pasi që Kur'ani i ftoi të gjithë të jenë unik dhe të bashkuar, kishte nga ata që këtë e kundërshtuan dhe thanë se këto vargje janë vetëm se poezi të kota. Kurse pjesa tjetër u dorëzua para kësaj mrekullie

magjepse dhe pranoi shpalljen hyjnore. Në fillim ata Kuranin e pranuan të magjepsur, si pala besimtare ashtu edhe ajo jobesimtare. Pra, përderisa njëra palë magjepsesh dhe besonte, pala tjetër magjepsesh dhe ikte,³ mohonte, refuzonte etj. Edhe pse magjepsesh nga Kur'ani, Velid ibni Mugire, intelektin e tij e përdori për të keq dhe mohoi, kurse Umer Ibni Hattabi me një logjikë të shëndoshë u dorëzua dhe pranoi të vërtetën.

Përmes këtyre shembujve dhe shumë të tjerëve, islami ka caktuar kufij dhe na ka mësuar unitetin ndërmjet popujve. Ai gjithmonë na ka ftuar dhe po na fton në bashkëpunim dhe barazi. Në këtë kontekst, Allahu xh. sh. thotë: "Thuaju (o i dërguar): "O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi)

3. Prof. Sejjid Kutb, Ilustrimi Artistik në Kur'an, f. 33, Shkup 2001.

te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zot pos All-llahut!" E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)!"¹ Njëra nga detyrat më të rëndësishme e pejgambereve ishte që të krijojnë barazi dhe unitet në mes njerëzve. Kur Pejgamberi Muhammed shkoi në Medine, menjëherë krijoi vëllazërimin e atyre dhe asnjëherë nuk e mposhti ndonjërin nga ata.

Në të gjitha kohërat islami është munduar të mbaj një balancim në mes të gjithë krijesave dhe etnive. Ai në vetvete dhe në normat e tija gjithmonë ka mbrojtur të drejtën dhe ka mohuar mashtrimin, të padrejtën. Po ashtu thelbi i fesë islame është paqe, dashuri, barazi dhe unitet. Ajo mbështjell dhe bashkon të gjitha shoqëritë dhe ide të në një burim dhe pikë.² Për këtë arsye edhe ka parinë më të madhe të pjesëtarëve të sajë në botë, por edhe respektin, lidhshmërinë dhe dashurinë e tyre. Për këtë shkak ajo i tubon në Qaben e Bekuar një herë në vit më se tre milion mysliman. Përveç kësaj brenda vitit ky vend i tubon edhe vizitorët që dëshirojnë ta kryejnë Umren. E gjithë kjo dëshmon se islami në të gjithë botën është unik dhe bashkues i të gjithë atyre që i dorëzohen atij.

Shembujt të cilët i cekëm më lartë, e që burimin e kanë në Kur'anin Fisnik, nuk janë të rastësishëm aspak, ngase këta e kanë humbur unitetin e njerëzimit në botë. Përveç kësaj, ata

"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llâhut, e mos u përçani!"

kanë luajtur me ndjenjat, gjakun, të drejtat dhe liritë e këtyre njerëzve. Dhe me plotë bindje e themi se nuk i lejuan krijesës njerëzore lumturi në jetë. Shembujt e ngjashëm janë përsëritur dhe përsëritën edhe me tej... A thua kush mund t'i ndal këto? Nuk besojmë se bindjet e tilla mund të çfarosen përmes forcës apo presionit, assesi. Këtë mund ta ndaloj vetëm besimi në një Zot, shpresa dhe frika ndaj tij. Pasi që dëmi konkret mund të parandalohet edhe nga forcat shtetërore, ai abstraktë pengohet vetëm nga bindja në Allahun Fuqiplotë, sepse çdo gjë e cila është në dëm të krijesave Allahu e ndalon. Ndalimi nga ana e Allahut xh. sh. drejt-përdrejtë ndikon në shpirtin dhe ndjenjat e njeriut, dhe në këtë mënyrë del në pah paqja. Në këtë mënyrë fitohet uniteti i një bashkësie. Ngase feja Islame është një fe e cila rrezatoi dhe ndriçoi me diell dhe dritë çdo anë të errët të botës në të cilën jetojmë. Baza e çdo norme dhe ligji është thënie qiellore dhe hyjnore. Qëllimi final është bashkimi i sinqertë në islamin e vërtetë.

Kontributi i prijësve mysliman gjithmonë ka qenë i shkëlqyeshëm si në kohën e Pejgamberit (a.s.) ashtu edhe në kohërat e

tjera. Edhe periudha e Hulefa-i Rashidinëve ishte një periudhë e artë ngase përqafoi të gjithë, ndihmoi të dobëtin dhe ia rriti vlerën atij. Ata si synim e kishin që shumë etni, të jenë të bashkuar në një formulë. Këtë e bëri edhe Shteti Islam Osman, i cili krijoi një harmoni në mes etnive të shumta e të ndryshme në botë, konkretisht në Ballkan, dhe edhe shumë dijetarë mysliman dhe organizatorë tjerë janë duke e bërë këtë. Këtë ftesë na e bën Kur'ani Fisnik duke u shprehur: **"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llâhut, e mos u përçani! Përkujtoni nimetin (mirësinë) e All-llâhut..."**, **"E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh"**³

Ndaj, si përfundim i kësaj mund të theksojmë se përçarja nuk ka vend në islam dhe as që lejohet kjo. Edhe pse ndonjëherë bashkimi i të gjithë myslimanëve është pak si i vështirë, kjo nuk do të thotë se është e pamundur dhe e porealizueshme. Si ndaj myslimanëve ashtu edhe ndaj jomyslimanëve, ndoshta është shumë me rëndësi që të bëhet së pari një bashkim dhe njohje të kulturave,⁴ ideologjive etj. Mirëpo kjo duhet bërë me hapa të sigurt dhe të ngadalshme në mënyrë që të mos keqkuptohen debatet dhe mesazhet e njëri-tjetrit, sepse në bazë, Kur'ani të gjithë njerëzit i cilësoi dhe nderoi si vëllezër.

1. Ali Imran, 3/64.

2. Dr. Jusuf el-Kardavi, Veçoritë e Përgjithshme të Islamit, f. 268-271. Prishtinë 2002.

3. Âli İmrân, 3/103, 105.

4. Prof. Dr. Jusuf el-Kardavi, Revi - ta "Altınoluk" nr. 262, Dhjetorë, Istanbul 2007.

Zgjohu rini!

Syri çjak po më pikon
ZEMRA IME ËSHTË E PIKËLLUAR
Rini ndalu ku po shkon?
ZOTIN PSE E KE HARRUAR?

A s'U NGOPE ME SHFRENIME
JETË TË ÇUAR PA KUPTIM
KOHË E HUMBUR JANË KËTO ÇASTE
FUNDIN E KE VEÇ DËSHPËRIM

KTHEHU TI NGA ARDHMËRIA
ZGJOHU, ZGJOHU OJ RINI
LËRI VESET E KËQIJA
SE KJO RRUQË NUK ËSHTË PËR TY

Ti je e ardhmja e këtij ymeti
Ti je shpresa që na mban
Ti je drita e këtij vendi
SYTË TEK JU TË GJITHË I KANË

ARDHMËRIA ËSHTË ISLAMI
ZOTI SIÇ NA KA MËSUAR
RRUQA E DRITËS ËSHTË KURANI
PEJGAMBERI NA KA KËSHILLUAR

Gëzim Meaj
Medreseja H. Sh. Shamia
XI-B

Feja burimore (primordiale) e njeriut si bazë e feve të shpallura

Hyrje

Studimi i feve të mëdha botërore tregon se ato posedojnë bazën e përbashkët doktrinare por edhe historike, një fundament, një rrënjë, nga e cila fetë burimore degëzohen në forma dhe trajta të cilat i hulumtojmë, i studiojmë dhe i shohim gjatë historisë njerëzore. Këtu para së gjithash mendohet në Judaizmin, Kristianizmin dhe Islamin Por, me këtë nuk mund t'i përjashtojmë edhe fetë e tjera, të cilat ekzistojnë por dallimi i tyre me fetë qiellore është më i madh, sigurisht për shkak të shtrembëri-meve përgjatë mijëvjeçarëve të tërë.

Ky bazament i përbashkët, ky unitet transcendent i ka interesuar edhe historianët, edhe filozofët edhe mistikët, edhe teologët, edhe antropologët Edhe pse emërtimet dallojnë, megjithatë të gjithë këta përbashkët e kanë be-

simin e vërtetë.

Një fe si shembull

Kur'ani flet për këtë çështje:

"Drejtuhu me përkushtim në fenë e pastër mono-teiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Er-Rrum, 30).

Është e qartë se Allahu së pari e përkufizoi fenë e Tij, dhe vetëm pastaj, sipas saj, e përshtati krijimin e Ademit (njeriut) si qenie e cila këtë fe do ta manifestojë. ("Ti drejtoje veten tënde, si besimtar i vërtetë, nga feja e pastër, nga ajo natyrë e Allahut (fitretullah), sipas së cilës Ai i krijon njerëzit.") (Er-Rrum, 30)¹

1. Xhemaludin Llatiq, Bazat e pedagogjisë kur'anore, Prizren, 2002, fq. 21-22.

Njeriu lindet me prirje për fenë e tij, por varësisht nga feja e familjes, e rrethit, shkollës, vendit, njeriu vazhdon të orientohet, herë drejtë e herë zhdrejtë. Krijuesi i njeriut, Allahu, nga njeriu e pranon vetëm besimin e drejtë:

"Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami...."
(Ali Imran, 19).

"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur."
(Ali Imran, 85).

Islami është feja e Allahut, sipas së cilës AI e krijoi njeriun, dhe e cila është e ndërtuar te vetë njeriu. Zhvillimi i mëtejshëm i fesë dhe manifestimi praktik varet nga rrethanat e jashtme:

"Çdo fëmijë lind me natyrë të pastër (fireh) dhe prindërit e tyre i hebraizojnë, i kristianizojnë apo i bëjnë adhurues të zjarrit."

Esenca dhe forma e pikënisjes së përbashkët

A do të thotë kjo se përfundimi ynë mohon se fetë e tjera sot të pranishme në botë nuk kanë prejardhje qiellore? Jo, këto fe posedojnë prejardhje hyjnore, por mandati i tyre ka qenë i kufizuar edhe në kohë edhe në hapësirë. Po ashtu, edhe ndërhyrja njerëzore në to, sikur në Tevrat dhe Inxhil, ka ndikuar që vlefshmëria e tyre të jetë e kufizuar. Për këtë arsye mund të thuhet se Islami është fe natyrore për njeriun me esencë të pandryshueshme dhe me shumë forma konkrete historike. Në formën e sotme, Islami është forma e fundit dhe përfundimtare e dërguar Muhammedit a.s..

Esenca e Islamit përbëhet prej dy elementeve themelore dhe të amshueshme:

1. Tevhidit (monoteizmit) absolut dhe
2. Përkushtimit dhe bindjes së plotë, të sinqertë dhe pa kushte ndaj Zotit të gjithëfuqishëm.

Feja natyrore nga njeriu kërkon që gjithnjë t'i ketë parasysh dy elemente të njëjta:

- Të besojë në Zotin Një, të Vetëm, të mos e konsideroj askënd, në asnjë mënyrë në asnjë formë të barabartë me Të, të mos e konsideroj askënd për ndërmjetësues ndërmjet Tij dhe krijesave të Tij dhe;

- Plotësisht dhe sinqerisht t'i dorëzohet Zo-

tit dhe këtë ka konfirmojë me nënshtrim dhe ndjekje të përpiktë të Pejgamberit të Zotit, të dërguar në kohën përkatëse dhe me religjionin e shpallur në këtë kohë.

Edhe feja e Musait a.s., edhe feja e Isait a.s. ishin vetëm dy forma të një feje të Allahut, Islamit. Dallimet mes tyre ishin specifika të kohës dhe vendit. Edhe feja e Muhammedit a.s. ishte islam, pikërisht sikurse edhe atë parapraket, por ishte islam përfundimtar deri në Ditën e gjykimit.¹

Përfundojmë se në bazë të të gjitha feve të lashta që kanë pasur shpallje, qëndron një themel, i përbashkët, kurse ai është monoteizmi pa kompromise, i saktë, përkushtim dhe bindje pa kushte.

Dallimi në këto fe qëndron për shkak të religjioneve të ndryshme historike dhe për shkak të ndërhyrjeve njerëzore në fe.

"Thuaj: "O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurujmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!" Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: "Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!" (Ali Imran, 64).

Afrimi që e kërkon Allahu duhet të jetë i bazuar mbi të vërtetën e monoteizmit, i cili ekziston te çdo fe e shpallur. Ky monoteizëm nënkupton sinqeritet si ndaj Krijuesit ashtu edhe në raportet reciproke:

"Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti." (El-Maideh, 48).²

1. Shkrimet e shenjta patën njoftuar për ardhjen e Kur'ani dhe të Muhammedit a.s. Shih gjerësisht: Nexhat Ibrahim, Muslimanët në kërkim të Islamit, I-II, Shkup, 2007, fq. 38-49.

2. Sipas: http://www.znaci.com/druge_tradicije/art99_0.html



Kurani dhe shkenca mbi krijimin e planetit të Tokës

Në Evropë në gjysmën e dytë të shekullit XVIII idetë materialiste po zgjerohnin zonën e tyre të dijes. Po bëheshin përpjekje për t'u shpjeguar nga pikëpamja materialiste prejardhja e qenieve të gjalla dhe ligjet e natyrës. Materialistët francezë Lametre, Didëro dhe Helvec ishin të parët që kozmosin nuk e vështruan si një strukturë statike, por si një strukturë dinamike në evolucion. Në këtë terren të krijuar Kanti boton pa emrin e tij më 1755 librin "Historia e përgjithshme e natyrës dhe teoria e qiellit". Ky titull thuhej dhe ndryshe "Studim mbi ndërtimin dhe prejardhjen mekanike të të gjithë rruzullimit sipas parimeve të Njutonit". Në këtë punim ai mbështeste teorinë e Njutonit mbi gravitacionin që ndikon në bashkëveprimin në mes Tokës dhe Hënës. Ndërsa në punimin e vitit 1755 Kanti thotë se Dielli ka qenë i rrethuar prej një mjegullnaje grimcash. Këto grimca, shpjegon Kanti, lëvizin në mënyrë kaotike rreth Diellit. Më pas lëvizja kaotike e grimcave orientohet dhe nga mjegullnaja u for-

muan planetët. Në lidhje me këtë çfarë shkruante Kanti, Engëlsi në librin e tij Anti - Dyring shkruan me nota entuziazmi "Teoria Kantiane e formimit të të gjitha trupave të sotme qiellore prej masash nebuloze që vërtiteshin ka qenë fitorja më e madhe e astronomisë që nga koha e Kopernikut". Ndërsa më poshtë thekson: "Për të parën herë u trondit përfytyrimi sipas të cilit natyra nuk ka asnjë histori në kohë." Me gjithë notat e entuziazmit që e shoqëronte Engelsin në atë kohë kur ai shkruante këto rreshta në librin e tij Anti - Dyring duam të themi se ai nuk ishte fort i ditur në këtë çështje. Këtë e themi sepse ai çështjen e krijimit të Universit e ka shumë të cunguar dhe mjaft kaotik. Ne duam të themi se hipoteza e Kantit mbi mjegullnajat si materie bazë e formimit të Universit dhe të sistemit tonë diellor bëhet e njohur në Evropë afërsisht 1440 vjet pasi Allahu (xh.sh.) ia shpalli në Kuran njerëzimit dhe kjo shpallje ndodhjet e shkruar në Suren Fuzilet, ajeti 11. Pastaj iu drejtuar qiellit (kupto: krijimit të qiellit në trajtë të rregullt) e ai

ishte mjegullinë”.

Ndërsa Abdul Mexhid Zendani fjalën mjegullinë e komenton si tym (Mrekullitë shkencore të Kuranit fq. 51) Një komentim homolog me Abdyl Mexhid ez-Zendani i bën këtij ajeti dhe Maurice Bucaille në librin e tij “Bibla, Kurani dhe shkenca fq. 156 Tiranë 1999). Gjithashtu një komentim të tillë e ndeshim edhe në librin e Galip Veliut “Universi sipas Kuranit dhe Shkencës fq. 25 Bot. Logos–A, 2000) në ditët e sotme parimi se trupat kompaktë (kupto: yjet) janë formuar nga mjegullnajat por jo në gjendje të ftohtë por ato kishin një farë temperature, është teoria bazë e formimit të Universit (kupto: pas big bengut). Por çështja është krejtësisht e ndryshme kur është fjala për formimin e sistemit tonë diellor. Duhet të shënojmë se kjo është pjesa më e vështirë dhe më enigmatike e cila në hapësirën e vet përmban shumë pikëpyetje të përgjithshme për kozmogoninë edhe në ditët e sotme. Megjithëse shumë hipoteza janë hedhur mbi mënyrën se cila ka qenë rruga e formimit të sistemit tonë diellor të gjitha këto hipoteza si hipoteza e Shmidit, e Xhinsit, e G.P. Kuiperit dhe e C.G. Vaicherit mund të hedhim një ide afër së vërtetës, por jo ta ndërtojmë plotësisht atë (në këtë rast është fjala për mënyrën e formimit të Tokës). Tani le të kthehemi përsëri në temë: kur folëm më sipër për atë që shkencën e Deuterit janë një ndër përgjegjësit kryesorë të koncentrimin të mjegullnajës. Bërthamat e këtyre elementeve të rënda “në temperatura të ulëta janë në gjendje të kapin elektrone e të kthehen në atome e më tej në molekula. Vëzhgimet e fundit tregojnë një shkallë të habitshme të organizimit të lëndës atomike e molekulare në retë ndëryjore. Në një gjendje të tillë ndodhet pra 5 miliard vite më parë edhe një re e zakonshme ndëryjore në galaktikën tonë të cilën po e quajmë reja diellore (M. Hafizi, Bazat e Astrofizikës, fq. 74, Tiranë 1999). Nga kondensimi i mëtejshëm u përshpejtua mjaft lëvizja e atomeve të hidrogjenit të cilët duke u përplasur me njëri-tjetrin çlironin energji bërthamore. Energji kjo e cila çonte më pas në një sërë reaksionesh termo-bërthamore duke formuar lloje të reja atomeve të elementeve të ndryshme. Ky lëmsh i stërmadh në atë kohë me një radioaktivitet 15 herë më të fuqishëm se tani dhe energjia potenciale që u çlirua ndoshta kur

Megjithëse shumë hipoteza janë hedhur mbi mënyrën se cila ka qenë rruga e formimit të sistemit tonë diellor të gjitha këto hipoteza si hipoteza e Shmidit, e Xhinsit, e G. P. Kuiperit dhe e C. G. Vaicherit mund të hedhim një ide afër së vërtetës, por jo ta ndërtojmë plotësisht atë (në këtë rast është fjala për mënyrën e formimit të Tokës).



bërthama e hekurit u mblodh në qendër e ngrihtën temperaturën aq sa Toka kaloi pothuajse e tëra në gjendje të shkrirë” (Patrik M. Harlej, Sa e vjetër është Toka, fq. 129, Tiranë 1989) Në këtë fazë ndodh diferencimi i elementeve sipas peshës specifike. Kështu bërthama e hekurit si elementi më i rëndë u mblodh në qendër të Tokës. Sikurse dihet bërthama e Tokës shtrihet sot nga thellësia 2900 km deri në qendër të Tokës, ndërsa trysnia e kësaj bërthame hekuri fillon nga 2400 km dhe ka trysninë 1 milion 6380 km trysnia arrin në 3.5 milion atmosferë. Sikurse shihet në brendësi të Tokës kemi të bëjmë me një lëndë tepër të rëndë sepse mbështjelljet elektronike janë fshirë nga trysnia që thamë më sipër. Dhe lënda tani ndodhet në një gjendje ku mbështjelljet elektronike janë fshirë dhe lënda është e përbërë kryesisht vetëm nga bërthamat e elementeve përbërës që mendohen të jenë Nikeli dhe Hekuri (Ni + Fe). Natyrisht që nënshtrësë e tillë që ndodhet në brendësi të Tokës

Kjo fazë e ngurtësimit të sipërfaqes së Tokës në Kuran tregohet si formim i një trualli të favorshëm për diçka që do të vijë prapa dhe pikërisht në Suren en-Naziat ajeti 30 lexojmë "E pastaj Tokën e sheshoi"




është e njohur në Suren Zelzele, ajeti 2 "Dhe të nxjerrë Toka atë që ka në brendësinë e saj (barrën e brendshme)" Këtë çfarë thamë më sipër e shohim më të qartë në Suretu El-Inshikak ajeti 4 "E të nxjerrë çfarë ka brenda e të çlirohet: Pra në Suretu El-Zelzele kemi fjalën "Barrë, rëndësinë e brendshme" Ndërsa në Suretu El-Inshikak bën fjalë për diçka të rendë që ka brenda dhe atë ditë (Ditën e Kijametit) do të çlirohet nga kjo barrë që ka brenda. Por le të vazhdojmë më poshtë. Jemi në atë fazë në të cilën Toka është duke u formuar pra para 4.5 miliard vitesh Pas diferencimit të shtresave që folëm më sipër fillon dhe ftohja e sipërfaqes së Tokës dhe Toka gjatë procesit të ftohjes së saj merr pak a shumë pamjen e një trupi të ngurtë. Në lidhje me këtë çfarë thamë më sipër "Harold Xhefri zhvilloi teorinë e ftohjes së mantelit të shkrirë dhe të kristalizimit nga qendra drejt pjesës së jashtme me humbje nxehtësie fillimisht nga shndërrimi në lëng pastaj nga kalimi

drejt gjendjes së ngurtë" (Patrik M. Harlej, shiko po aty) Kjo fazë e ngurtësimit të sipërfaqes së Tokës në Kuran tregohet si formim i një trualli të favorshëm për diçka që do të vijë prapa dhe pikërisht në Suren en-Naziat ajeti 30 lexojmë "E pastaj Tokën e sheshoi" Pas zhvendosjes së shtresave të rënda të cilat u instaluan në qendër të Tokës përsipër dolën shtresat e shkrira të silikateve e shtresat e tjera të lehta. Kjo zhvendosje çliroi një sasi energjie e cila shndërrohet në nxehtësi dhe kjo nxehtësi nuk ekzistonte vetëm në sipërfaqe të Tokës, por edhe në brendësinë e saj në të cilën zhvilloheshin me vrull shumë reaksione kimike ekzotermike. Nga këto reaksione dilte një energji mjaft e madhe duke krijuar kështu mundësinë për kombinime të reja atome të elementeve të ndryshme dhe presioneve të mëdha që ndodheshin nën shtresat masive të Tokës këto gaze shpërthenin në formën e vullkaneve në sipërfaqe të Tokës duke formuar kështu atmosferën e parë të saj primitive që përbëhej nga avuj uji hidrogjen, amoniak etj. Më pas kondensohet duke mbuluar kështu të gjithë sipërfaqen e rruzullit të porsalindur tokësor. Kështu shkencëtarët mendojnë se afro 3 miliard vite më parë Toka ishte e mbuluar e gjitha nga uji. Pra në këtë epokë kemi shndërrimin e gazeve të dala nga Toka në oqean. Në lidhje me këtë çfarë thamë më sipër d.m.th me rrugën nga u formua uji përsëri Allahu (xh.sh.) na e ka bërë të njohur në Kuran përsëri në të njëjtën sure, por në një ajet më poshtë d.m.th në ajetin 31 "Dhe prej saj mori ujin e saj..." Tani jemi në një periudhë e cila mendohet të ketë ekzistuar rreth 3 miliard vite më parë. Planeti i Tokës është i gjithi i mbuluar nga uji. Askund nuk ka jetë dhe në qiell shpërthejnë vazhdimisht dhe pa pushuar rrufe të fuqishme. Askund nuk shikohet ndonjë rrip toke i vetmuar, por çdo gjë e mbuloi uji. Kjo ishte gjendja në sipërfaqe të Tokës në epokën në të cilën po flasim. Ndërsa tani le të shohim se çfarë ndodhte në brendësi të saj. E para, radioaktiviteti në atë kohë ishte padyshim disa herë më i lartë se sa sot. Ndërsa pllakat që përbëjnë litosferën për shkak të këtij radioaktiviteti të lartë që është burimi i energjisë termike të Tokës ishin më të holla. Duke qenë më të holla dhe nga ky shkak natyrisht që ishin më të lehta pllakat e litosferës veprimi dinamik i tyre ndaj atmosferës mjaft plastike të asaj kohe dhe falë rrymave konvek-

tive rritën në mënyrë të ndjeshme ekuilibrin hidrostatik të blloqeve të litosferës në bazë të ligjit të izostazisë. Kështu rrymat konvektive synonin të largonin nga njëra-tjetra pllakat e litosferës të cilat futeshin njëra nën tjetrën duke formuar në sipërfaqe vargmale dhe ishujt e parë. “Gjeologët të cilët përkrahnin hipotezat mobiliste” i kanë gjetur tani dëshmitarët e këtyre harqeve ishullore parësore në Kanada e në Rodezi në shkëmbinjtë e vjetër andezitikë të erës arkezoike të formuar nga shpërthimet e vullkaneve shumë të lashtë më se 1 miliard vite më parë” (Asti Papa, Duke zbuluar të fshehtat e Tokës, fq. 196, Tiranë 1984) Këto ishuj dhe male erdhën duke u zgjeruar si rezultat i ngritjes së pllakave të tjera dhe erozionit. Për këtë formim të maleve dhe ishujve të parë Allahu (xh.sh.) na tregon në Kuran në Suren Fussilet, ajeti 10: “Ai që në të vuri kodra të forta...”. Në 3.9 – 2.6 miliard vjet ndodh formimi i proto-kontinenteve, ndërsa shfaqja e bimësisë, epokë e cila quhet Eoni i Fareezonit, daton 0.6 miliard vjet më parë dhe vjen si fazë e rëndësishme pas fazës së formimit të hidrosferës, por natyrisht e lidhur ngushtë me këtë të fundit Dhe pikërisht e njëjta gjë ndodh dhe në Kuran në të njëjtin rresht të ajetit tregohet në mënyrë të lidhur krijimi i bimësisë pas formimit të hidrosferës. Për këtë çfarë thamë le të shohim përsëri ajetin 31 në Suren en-Naziat “Dhe prej saj nxori ujin e saj dhe kullosat e saj”. Fjala “kullosë” në këtë ajet të tërheq vëmendjen se përse bimët nuk quhen bimë, por “kullosë”. Kjo fjalë të lë të kuptosh qartë për qëllimin e krijimit të bimëve që do të shërbejnë si “kullosa” për qenie të tjera të gjalla që do të vijnë më pas. Nga kjo ne nxjerrim një përfundim se pas bimëve të gjelbërta, Allahu (xh.sh.) ka filluar aktin e krijimit të kafshëve. Ndërsa tani do të vështrijmë përsëri ajetin 10 në Suren Fussilet “... ia shtroi asaj të mirat dhe brenda katër ditëve të plota caktoi të gjitha kushtet për të jetuar në të”, në këtë rast na duket e arsyeshme të sqarojmë se fjala “ditë” në Kuran “ejjam” “... kuptimi i së cilës më tepër është një periudhë më e gjatë kohore se sa një periudhë prej 24 orësh” (Kurani dhe Shkenca moderne, Dr. Maurice Bucaille, fq.9) Kuptimi i katër ditëve të plota në Kuran ka kuptimin e katër transformimeve rrënjësore në planetin tonë të cilin këto katër akte transformimi plotësuan të gjitha kushtet për jetë. Dhe mendojmë

Ndërsa tani do të vështrijmë përsëri ajetin 10 në Suren Fussilet “... ia shtroi asaj të mirat dhe brenda katër ditëve të plota caktoi të gjitha kushtet për të jetuar në të”, në këtë rast na duket e arsyeshme të sqarojmë se fjala “ditë” në Kuran “ejjam” “... kuptimi i së cilës më tepër është një periudhë më e gjatë kohore se sa një periudhë prej 24 orësh”



se këto katër ditë kanë plotësuar këto transformime në Tokë.

Dita e parë – Formimi i atmosferës

Dita e dytë – Formimi i hidrosferës

Dita e tretë – Formimi i kontinenteve

Dita e katërt – Formimi i bimësisë

Është e qartë dhe nuk mund të mohohet se të katër këto akte krijuese formojnë së bashku të gjitha kushtet për jetesë në planetin tonë. Kjo çfarë thamë më sipër është një pikë ujë nga oqeani i pafundmë i së vërtetës Hyjnore të krijimit të Tokës nga Allahu (xh.sh.). Mendojmë se fjalët tona nuk kanë vlerë për të gjetur atë që është e vërtetë, sepse argumentet janë në Kuran, ju lutem shikojini ato.

“E atyre që u është dhënë dija se kjo që të është shpallur nga Zoti është e vërtetë dhe udhëzon në rrugën e të Gjithëfuqishmit të Lavdëruarit”

OSMANIET

Popujt dhe kombet i japin vazhdimësi vitalitetit të tyre në skenën e historisë në sajë të elementëve të vetëdijshmërisë besimore-fetare, gjuhësore dhe historike. Besimi me fenë si forma e institucionalizuar e tij janë synimi final i krijimit dhe natyrës njerëzore, janë koleksion sistematik i ligjeve hyjnore që rregullon jetën mes shpërgënjeve dhe qefinit dhe, kështu, e përgatit njeriun për lumturinë e jetës tjetër, ahiretit; gjuha është mjeti shprehës i drejtësisë dhe i të vërtetave të parashtruara nga besimi dhe feja; kurse historia është një pish-tar i cili, me anë të evidentimit dhe analizës së shkaqeve dhe rezultateve të përjetuara nga njerëzimi në kornizën e këtyre dy elementëve, u ndriçon popujve dhe kombeve rrugët e tyre veti-ake. Nga ky këndvështrim, në veprën “Osmanët me personalitetet dhe institucionet e tyre monumentale” e shkruar nga Osman Nuri Top-bash, duke u mbajtur parasysh e vërteta se këta tre elementë nuk mund të ndahen nga njëri-tjetri, autori është përpjekur që, me anë të përshkrimit të jetës dhe veprës së personaliteteve monumentale të historisë osmane, t’u shpalosë lexuesve një sërë shembujsh domethënës dhe urtësish.

T’i dalësh për zot denjësisht trashëgimisë historike e kulturore si amanete të shenjta të së kaluarës, nuk do të thotë vetëm t’i meremetosh a t’i restaurosh veprat materiale arkitekturore, etj., të shndërruara në rrënoja. Thelbësore është ta gjallërosh para sysh qytetërimin ashtu siç ka qenë dhe

t’ua përcjellësh të vërtetat historike brezave të ardhshëm. Njerëzit mendojnë me anë të fjalëve. Kurrë s’është e mundur të hapesh për në horizontet e meditimt të thellë islam me anë të një të ashtuquaj-ture gjuhë që i janë reduktuar dhe shtrembëruar konceptet, për rrjedhje, fjalët si mjete dhe pretekste për shprehjen e tyre! Dhe gjersa të mos bëhet kjo, nuk realizohet dhe nuk fiton dot nivel serioz mediti-mi si motivi shtytës themelor i veprimt.

Nga ana tjetër, edhe historia duhet njohur me entitetin e saj të vërtetë, përndryshe, është e pamundur që, me një sërë historianësh vendas me pasione të sëmura së bashku me veprat e shkruara nga autorë armiq të Islamit, të mund ta shpjegojmë saktë e drejt një qytetërim gjithëbotëror dhe, duke e mësuar denjësisht të kaluarën, të mund ta orientojmë të ardhmen tonë.

Historia është dëshmitare që kombet dhe individët e rregullojnë jetën nën dritën e eksperiencës së kaluar. Historia është kujtesa e një kombi dhe përmbledhja e eksperiencës kombëtare. Është për këtë arsye që, ashtu siç nuk jeton dot individi i shkëputur dhe indiferent nga eksperiencia e kaluar e vet, edhe popujt dhe kombet janë gjithmonë nevojtarë për tërheqjen e vëmendjes dhe orientimit të ngjarjeve historike. Me të vërtetë, ngjitjet dhe zbritjet që përjeto-hen në fatin e popujve dhe kombeve, janë një grumbull eksperiencash që i përcillen së ardhmes. Kurse ballafaqimi në mënyrë të drej-

të i shkaqeve dhe përfundimeve bashkë me ngjarjet e reja, vazhdon të luajë për popujt dhe kombet një rol ndriçues të së ardhmes.

Për sa kohë që një komb i njeh historinë e vërtetë dhe udhëzuesit materialë-shpirtërorë të tij, si dhe i vlerëson ata siç duhet, tregon se është një komb i madh e i përparuar. Po që se brezat e rinj e njohin historinë e vet më mirë se historinë e të tjerëve dhe marrin mësim nga e kaluara, nuk kihat frikë për të ardhmen! Por po që se rritet një brez i cili i kthen shpinën historisë së vet, për më tepër, e fyen atë, i cili nuk i njeh udhëzuesit e tij materialë-shpirtërorë duke u bërë i huaj, kështu, për origjinën e vet, i cili, si një trashëgimtar mosmirënjohës ndaj një trashëgimie të shkëlqyer, i shpall tradhtarë heronjtë e mëdhenj të së kaluarës, kurse tradhtarët, heronj, e ardhmja bëhet e errët dhe e frikshme. Sepse kurrë s’ka qenë e sigurt e ardhmja e atyre që nuk mbështeten në të kaluarën. Prandaj, rrënjët duhet të na zgjaten kah e kaluara, kurse degët, kah e ardhmja!

Është gabim i madh ta pandehësh historinë vetëm si një përmbledhje të thjeshtë ngjarjesh dhe ashtu ta konsiderosh. Shkenca e vërtetë historike është një shkencë e cila e tregon truallin bazë të së vërtetës ose gënjeshtërisë, të së drejtës ose të shtrembrës në mënyrën e jetesës së popujve, të mbushur plot ngjarje të ndryshme, surpriza dhe aventura. Për të mund ta sistematizuar në një formë të përkryer të tashmen dhe të ardhmen

Me personalitetet dhe institucionet e tyre monumentale

OSMANET



Osman Nuri Topbash



Thonë se historia përsëritet...

Po të merrej mësim, a do të përsëritet vërtet?

Historia mbështetet në **arkivat**. Ndërsa dokumentet mbi një qytetërim të madh si Osmanët sapo kalohen nëpër duar, me kalimin e kohës po del në shesh se akuzat e qëllimshme ose injorante nuk kanë asnjë vlerë...

Kombet me histori të pasur dhe me qytetërim madhështor janë kombe të mëdhenj. Edhe nëse sot dalin në shesh shumë vepra arti, **Sulejmania** do të vazhdojë të mbetet një veper madhështore dhe impresionuese. Është një e vërtetë e pamohueshme se edhe sot, përgjithësisht, vendet ku turistët ulen dhe e çlodhin shpirtin duke soditur me mahnitje dhe admirim, janë veprat osmane.

Studiuesit të ndryshëm, madje edhe perëndimorë, ende bëjnë përpjekje për ta kuptuar gjeninë e këtij shteti botëror dhe për të përfituar prej gjërave që mësojnë. Është për këtë arsye që arkivat turke mbushen më shumë me shkencëtarë të huaj sesa turq.

E djeshmja dhe e sotmja e historisë botërore nuk mund të njihen pa u njohur historia osmane, në mënyrë të veçantë historia më e vonë e popujve të Ballkanit.

Njeriu ka dy vlera shumë të çmuara që i përkasin kësaj bote. Njëra është jeta, fryma, kurse tjetra, mundësitë materiale. Me këta dy elementë bëhet dhënie-marrja në lidhje me pëlqimin hyjnor dhe xhennetin, parajsën. Është për këtë arsye që njerëzit e përkushtuar dhe personalitetet monumentale që ia kanë dhënë veten Zotit, mjaftohen me dhurimin e këtyre dy vlerave. Dhe kjo është një çështje shumë me rëndësi. Sepse dallimi i vetëm mes kombeve sundues dhe kombeve të sunduar është një grusht njerëzish të përgatitur ose, e thënë ndryshe, është dallimi i njeriut vetëmohues të përkushtuar Allahut dhe kombit me pasurinë dhe jetën e tij!

e shoqërive, për të mund të ballafaquar shkaqet dhe përfundimet e ngjarjeve që na vë para historia, është kusht që trualli në fjalë të njihet drejt dhe të bëhen vlerësimet e duhura duke përfituar nga mësimet dhe pësimet e domosdoshme prej tij.

Edhe libri ynë i lartë, Kur'ani i Shenjtë, për këtë arsye ia përcjell njerëzimit urtësitë dhe mësimet e ngjarjeve të ndryshme pozitive ose negative të përjetuara nga popujt e shkuar. Për shembull, faktin që popujt të cilët kanë ushtruar dhunë, padrejtësi dhe kanë mbajtur qëndrim kundërshtues ndaj Zotit, kanë humbur në plehërishten e historisë me një fund të hidhur, të

goditur nga persekutimi hyjnor, na e bën të ditur kështu:

“Dhe i bëmë ata një të shkuar dhe shembull domethënës për popujt e ardhshëm...” (edh-Dhuhruf, 56)

Dhe kjo tregon se nuk mund të rrihet indiferent ndaj kësaj metode kur'anore e cila i bën konkrete qëndrimet dhe sjelljet e drejta ose të gabuara dhe, në këtë mënyrë, e lehtëson përfitimin prej tyre. Rëndësinë e mësimëve që duhen marrë në këtë specifikë, Mehmet Akif Ersoji, poet i shquar turk me origjinë shqiptare dhe autori i hymnit kombëtar turk, na e përshkruan kështu:

Dhe kjo shkon gjer atje, sa qetësia dhe prehja e shoqërive e vazhdon ekzistencën jetësore të saj vetëm me anë të këtyre njerëzve vetëmohues. Në të njëjtën mënyrë, edhe nderi dhe fama e popujve është, në përgjithësi, e gjatë sa jetëgjatësia e këtyre njerëzve vetëmohues. Më shumë se çdo herë tjetër, sot jemi të detyruar të zbresim në thellësitë shpirtërore të zemrave të mbushura plot besim dhe ekstazë të atyre njerëzve të sakrificës, t'i dëgjojmë ata, t'i kuptojmë dhe të përfitojmë nga struktura ndjesore e tyre.

Ata që ndodhen më në kulm të njerëzve vetëmohues janë profetët, të urtët dhe njerëzit e edukuar prej tyre, Brenda një kohe shumë të shkurtër, ata e bartën emocionin e besimit që kishin në zemra, në të katër anët e botës, gjithashtu, qenë ata që i mbushën faqet e arta më të zgjedhura të historisë!

Shteti osman i cili përbën një ndër kulminacionet më të shkëlqyera të historisë islame pas periudhës së sahabeve, është një shtet që e bëri të shquhet tërë popullsinë e vet, nga sundimtari e gjer te bariu, me dashurinë për Profetin! Krahas lutjes për paqe e mëshirë për **Profetin** (a.s.s.) sa herë që përmendej emri i tij, she mbujt më të mrekullueshëm të shfaqjeve të panumërta të respektit, si vënia e dorës në zemër, dëgjimi kolektiv në këmbë i vargjeve të mevludit ku përshkruhet lindja e Tij, sundimtarët në krye të këtij shteti të lartë i patën shndërruar në traditë. Nuk ka sundimtar osman që të ketë urdhëruar hapjen dhe leximin e postës së ardhur nga Medina, pa marrë sërish abdest, pa u ngritur vetë në këmbë dhe pa i puthur dhe vënë në ballë letrat dhe shkresat e ardhura që atje!

Veç kësaj, fakti që, në meremetimin e Faltores Profetike, osmanët të cilët e vinin çdo gur në vend me Besmele pasi ishin larë dhe kishin marrë abdest, i mbështillnin çëkçët me lëkurë duke u druajtur

*Historia është
dëshmitare që kombet
dhe individët e
rregullojnë jetën nën
dritën e eksperiencës
së kaluar. Historia
është kujtesa e një kombi
dhe përmbledhja e
eksperiencës kombëtare.*

se mos e shqetësonin shpirtin e Profetit, janë modele edukate dhe respekti të papërsëritshëm!

Gjithashtu, në periudhën e osmanëve, **suitta e dhuratave** që shkonte për në **Medinën e Ndrithshme**, bënë konak diku afër para se të hynin në qytet, ku përgatiteshin për atmosferën shpirtërore të Medinës së Ndrithshme dhe, pas bërjes së këshillimit të quajtur *istihare* dhe marrjes së shenjës shpirtërore, afroheshin te **audienca profetike** dhe e kryenin vizitën. Pastaj, në kthim, merrnin me vete nga dheu i bekuar i Medinës së Ndrithshme për ta dërguar si begati dhe shëndet në vendin e vet.

Kush e di, vallë, se **tufa e thekave** në anë të çallmës në miniaturat e portreteve të sulltanëve osmanë të kohës është një imitim fshese? Me këtë, ata e konsideronin veten fshesarë të dy Qyteteve të Paprekshëm, prandaj dhe fshesarëve të atyre qyteteve ua jepnin rrogën nga pasuria e vet personale.

Fjalët e fundit të dëshmorit të Kosovës, prijësit të madh shpirtëror, sulltan Muratit I, ndërsa kufoma e paqme po i mbulohej nga gjakërat e bekuara të dëshmorësisë, janë model i bukur i dëshmorësisë së vërtetë:

"I qeshë lutur dhe përgjëruar Zo-

tit që të ma mundësonte sherbetin e dëshmorësisë nëse fitorja e Islamit do të kushtëzohej prej vdekjes sime! Kështu, pra, lutja m'u pranua! Lavdëruar dhe falenderuar qoftë Allahu! Po e mbyll jetën pasi e pashë fitoren e ushtarëve islamë!"

*

Osmanët patën zënë vend gjithmonë në anë të të vuajturve dhe viktimave. Në vendet ku patën ngadhnyer, ata patën bartur njerëzillëkun dhe shërbimin më të bukur. Në vendet e ngadhnyera, as mes popullsisë që e patën vazhduar jetën si krishterë nuk qe lënë askush i uritur dhe i pastrehë, gratë e veja qenë mbrojtur, strehuar dhe ushqyer. Ideat e sulltanëve osmanë qenë përqëndruar mbi idenë e **"rregullit botëror"** dhe urtësia e ekzistencës së shtetit qe mbështetur në mendimin e "sundimit botëror mbi parimet islame dhe njerëzore"!

Kjo shprehje e thënë para se të triumfohej Stambolli nga fisniku bizantin **Notaras** i periudhës së **sulltan Mehmetit II, Ngadhnyesit**, është një reflektim i bukur i drejtësisë së vërtetë dhe tolerancës së ndërgjegjes në Islam:

"Parapëlqej të shoh në Stamboll çallmën e turqve sesa shapkën e kardinalëve!.."

Duhet menduar se ç'mund të ishte ai motiv që e pati shtyrë të dilte në luftë i sëmurë një sulltan plak të rrëguar, një sulltan botëror si **Sulejman Kanuniu, Ligjvënësi**, i cili e kishte drejtuar shtetin për gjysmë shekulli me radhë? Si mund të shpjegohet gjendja e **Abdylhamitit I**, i cili, duke mos e duruar dot humbjen e kalasë Özi, vdiq nga hidhërimi pak kohë pas kësaj? Ç'ndjeshmëri madhështore besimi që ia pati mbushur zemrën me dhimbje dhe e pati bërë të rënkonte me një "ah" që do ta çonte në vdekje sulltanin i cili vuante thellë duke thënë: "Bijtë tanë ushtarë dhe populli i pafajshëm na u copëtuan!"

Për t'i ndjerë thellësisht këto të

vërteta, për ta kuptuar ankthin e tyre, për ta përjetuar vetëdijen e tyre historike dhe për ta njohur klimën moralo-shpirtërore që i ka sendërtuar ato, është e domosdoshme analiza e drejtë dhe e saktë e ngjarjeve dhe personaliteteve. Edhe shkrimi dhe leximi i veprave të kësaj specifike përsa i përket përjetimit në mënyrë të gjallë në zemra i të gjitha kujtimeve të të parëve tanë, përsa i përket mbajtjes së freskët të emocionit moralo-shpirtëror, veçanërisht të dashurisë ndaj Profetit (s.a.s.), është kusht.

Prandaj, në këtë libër autori Osman Nuri Topbash në veprën e tij "Osmanët me personalitetet dhe institucionet e tyre monumentale" është përpjekur të përcjellë shërbimet dhe heroizmat plot mëshirë, dhembshuri dhe dashuri, të kryera për pëlqimin hyjnor, në vendbanimet ku kanë qeverisur, të një sërë personash të përkushtuar e të zemrës të cilët kanë kaluar në histori si modele dashurie, si monumente nderi dhe njerëzillëku.

Ai duket se e ka ndjerë të nevojshme që, krahas disa personaliteteve nga sulltanët Osmanë, të përkrahë edhe disa nga personalitetet e shkencës, artit dhe kulturës që patën stolitur periudhat e tyre, duke e ndarë librin në dy pjesë.

Kështu, në këtë libër do të gjeni disa nga sulltanët e një perandorie botërore që qeverisën njerëzimin, disa nga miqtë e Zotit, dije-tarët, burrat e shtetit si dhe nga të tjerët figura të shquara që u dhanë orientim atyre, do të lexoni rreshtat kushtuar botës së tyre ndjesore që shpalos personalitetin shembullor të tyre. Të atyre që i patën treguar gjithë njerëzimit se perandoria osmane, sa ç'ndodhej në kulm përsa i përket aftësisë shtetformuese dhe asaj ushtarake, po aq zinte një pozitë të veçantë në dituri, kulturë, moral dhe art, si dhe që i patën shpalosur në mënyrën më të bukur veçoritë materiale-shpirtërore të kombit që shkruan e poepë në çdo fushë!

*Sepse kurrë s'ka
qenë e sigurt e
ardhmja e atyre që
nuk mbështeten në të
kaluarën. Prandaj,
rrënjët duhet të na
zgjaten kah e kaluara,
kurse degët, kah e
ardhmja!*

Veçanërisht tre shekujt e parë të osmanëve janë një pishtar i lartësimit të Fjalës (fesë) së Allahut që pati përfshirë botën duke flakëruar me besimin dhe besnikërinë e Hz. Ebu Bekrit, me guxim dhe drejtësinë e Hz. Umerit, me drojtjen, pasionin dhe ekstazën e Hz. Uthmanit dhe me diturinë, kulturën dhe heroizmin luftarak të Hz. Aliut.

Në historinë e asnjë kombi nuk ka ndodhur që për tre shekuj me radhë të dalë, në mënyrë të pandërprerë, një varg sundimtarësh luftarakë të shquar në trimëri, dhe gjenish. Në historinë e botës nuk është themeluar ndonjë shtet edhe jetëgjatë sa osmanët.

Fara e mbjellë me anë të katërqind kalorësve e këtij shteti të famshëm u bë një rrap madhështor, degët e tij futën nën hijen e vet tre kontinente, jetoj gjashtë shekuj me nder dhe dinjitet dhe, pastaj, duke lënë shumë shtete të vegjël e jetimë, u mblodh brenda një tyrbeje të famshme në varrezën me emrin histori. Ajo që na takon neve tani, është të bëhemi shërbyes të denjë të kësaj tyrbeje të famshme!

Auroti i veprës "Osmanët me personalitetet dhe institucionet

e tyre monumentale", Osman Nuri Topbashi, nuk mëton se është një historian i mirëfilltë. Është për këtë arsye që, në vend që të shkruante një histori kronologjike, ai është përpjekur që, duke trajtuar disa personalitete-referencë të historisë osmane si dhe pozitën e tyre të veçantë në dituri, kulturë dhe art, të parashtrijmë truallin moralo-shpirtëror të ngjitjes sonë materiale e formale së bashku me shkaqet dhe urtësinë esenciale të shembjes të trishtuar.

Sigurisht, personalitetet e përkushtuar që ia patën dhënë veten një kauze të shenjtë, nuk janë vetëm ata që janë trajtuar në libër. Edhe pse është e mundur që kjo listë të zgjerohet tejte, autori Osman Nuri Topbashi e ka kufizuar numrin me aq sa do të ishte e mjaftueshme për të krijuar një ide dhe opinion të përplotësuar.

Paraqitja e një burimi bibliografik në vepra të tilla, sa ç'është domosdoshmëri e një zakoni të përgjithshëm, është, shpesh herë, edhe një taktikë e përdorur për t'i dhënë veprës pamje "shkencore". Kurse autori, në këtë vepër nuk e ka përdorur këtë metodë edhe me qëllim për të mos e rëndojë lexuesin me pirgje bibliografike, edhe për të mos dalë me pretendime "shkencore".

Me këtë rast, duam të parashtrijmë dhe pohojmë edhe këtë, që asnjë autor nuk lind me njohuritë dhe konkluzionet e vlerave që vë në shesh. Një sërë udhëzuesish u japin formë shpirttrave dhe mendjeve të tyre dhe i udhëzojnë në kahje të drejtë apo të shtrembër. Kurse ata që mbeten të privuar nga një asistencë e tillë, shtegtojnë e ikin nga kjo botë me një zë joharmonik e të pakëndshëm si fëshfërima e thatë e një plepi, kurse veprat u mbeten thjesht si një pirg njohurish. Për rrjedhojë, asnjë njeri me ndikim dhe vepra e tij nuk dalin në shesh pa një asistencë shpirtërore!

XHAMIA SULEJMANIJE



Xhamia u ndërtua mes viteve 1550 dhe 1557 në Stamboll në emër të sulltanit Sulejmanit nga ana e arkitektit Sinan.

Xhamia e Sulejmanijes, që cilësohet si vepra e periudhës së kalfës për arkitekt Sinanin, është vetëm një pjesë përbërëse e kompleksit Sulejmanije që përbëhej edhe prej medresesë, bibliotekës, spitalit, hamamit dhe kuzhinës publike.

Nga veçoritë dhe karakteristikat arkitektonale xhamia Sulejmanije përbën një nga shembujt më të spikatur dhe të veçantë të arkitekturës klasike osmane. Megjithëse

që nga viti kur u ndërtua dhe deri më sot Stambolli është tronditur nga qindra tërmete me fuqi të ndryshme, mes tyre edhe atyre shkatërruese, në muret e xhamisë nuk dallohet as edhe një e çarë e vetme si pasojë e këtyre lëvizjeve të fuqishme të tokës. Kubeja e xhamisë që mbështetet mbi katër kolona të mëdha është 53 metra e lartë dhe me një diametër 26,5 m. Kubeja kryesore e xhamisë, ashtu sikur se vërehet edhe në rastin e kubesë së Shën Sofisë, përforcohet edhe me dy kube të tjera. Në lartësinë e kubesë gjenden 32 dritare.

Në secilën prej qosheve të xhamisë gjendet nga një minare. Dy prej katër minareve,



pikërisht ato që gjenden ngjitur me xhaminë kanë nga tri sherefe dhe janë të larta 76 metër, ndërsa dy minaret e tjera që gjenden në qoshen veriore në dy anët e portës së portikut të hyrjes për në xhami kanë dy sherefe dhe janë të larta 56 metra. Xhamia është ndërtuar në mënyrë që të mundësojë qarkullimin e ajrit dhe me këtë mënyrë të sigurohet pastrimi i saj nga bloza e kandilëve që përdoshin atëherë për ndriçim. Bloza e lëshuar nga kandilët që gjenden brenda xhamisë mblihdeshin në sajë të rrjedhës së ajrit në një dhomë që gjendet mbi portën kryesore ballore të hyrjes së xhamisë dhe më pas përdoshin për bojë shkrimi. Në mesin e oborrit të xhamisë që rrethohet nga 28 revakë ndodhet një shatërvan në formë katrore. Në anën e kibles së xhamisë ndodhen varret e sulltan Sulejmanit, gruas së tij të famshme Hyrremes dhe arkitektit të njohur Sinan.

Xhamia është e thjeshtë dhe jo e rënduar për nga zbukurimet e brendshme. Dritaret në murin e mihrabit janë të zbukuruara me vitrazhe. Në medalionet prej çinije që gjenden mbi dritaret në të dy anët e mihrabit janë shkruar pjesë nga sureja Feth, ndërsa


në mesin e kubesë kryesore të xhamisë është e shkruar sureja Nur. Kaligrafi osman që i realizoi këto shkrime në xhami qe Hasan Çelebiu.

Thuhet se numri katër i minareve të xhamisë korrespondon me faktin që sulltan Sulejmani qe sulltani i katërt po të merret si pikëreferimi ngadhënjimi i Stambollit prej turqve, ndërsa numri dhjetë i sherefeve të xhamisë korrespondon me faktin që po i njëti sulltan qe i dhjeti për nga kronologjia e sulltanëve osmanë.

Kompleksi i Sulejmanijes është për nga madhësia dhe tërësia e objekteve arkitekturore që përmban i dyti nga rradha, pas kompleksit Fatih, të ndërtuar nga sulltan Mehmeti II. Kompleksi është ndërtuar në kodrën më të lartë të qytetit të Stambollit nga e cila shihen Haliçi, Marmaraja, sarajet Topkapi dhe gryka e Bosforit.

Sipas Evlija Çelebiut kostoja e ndërtimit të kësaj xhamije kapi vlerën e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tre qind e tetëdhjetë e tre barrëve me flori.

Xhamia e Parrucës



Shkodra është qytet mijëra vjeçar, në historinë kombëtare zë një vend nderi. Në mugëtirën e shekujve kur ende historia mbështetet në gojëdhënat apo në ato pak dokumente materiale, Shkodra del gjithnjë si kryeqendër e krahinës. Me hapjen e qytetit nga fusha, krahas lagjeve të reja u ndërtuan edhe xhamitë së bashku me to. Këto dhe institucionet tjera të kultit islam në Shkodër janë të shumta. Në Shkodër numëroheshin rreth 40 xhami e mesxhide, medrese, mejtepe, biblioteka, tyrbe, varreza, puse, hamame, çinar, parqe, fusha e qoshqe etj.

Të gjitha këto u zhdukën, u rrafshuan për tokë, u shtetëzuan, u dogjën nga regjimi komunist dhe fryma e tij ateiste.

Qëndroi në këmbë vetëm xhamia e Plumbit dhe ajo e kthyer në magazinë, e mbytur nga plehrat

dhe ujërat që vërshonin pa pengesë rrotull sajë.

Lagja e Qafës dhe xhamia e Plumbit në nëntor 1990 u bënë dëshmitare të një revolucioni të vërtetë shpirtëror kur në ditët e parat ë nëntorit 1990 u mblodhën rreth saj mijëra e mijëra banorë nga e gjitha Shkodra e vendi për të krenuar hapjen e xhamisë së parë në Shqipëri.

Lagja ku bën pjesë xhamia e Parrucës është një nga lagjet më të rëndësishme të Shkodrës.

Shtirirja e saj me kohë ka ndryshuar, herë është zgjeruar e herë është rrudhur në vartësi të kushteve politike, shoqërore, administrative të kohës.

Familjet kryesore të lagjes Parrucë në kohë të ndryshme kanë qenë familja Parruca, Juka, Kazaçi, Bushatlinjtë, Kuka, Rroji, etj., etj.

Në vend të disa objekteve të shembura janë ngrihur të reja. Në mes tyre përmendim: Xhamia e Fushës Çelë (sot bën pjesë në lagjen "Vasil Shanto"), e shembur nga diktatura komuniste, u rindërtua edhe më madhështore sa që mbetet xhamia kryesore në Shkodër e në krejt Shqipërinë; xhamia e Parrucës e shembur në vitin 1967, u rindërtua nga Haxhi Sait Fishta me kontributin e vetëm të tij ashtu siç ishte dhe së fundmi u zbukuria brenda dhe jashtë me shpenzimet e shoqatës turke "Tika".

Institucionet më të rëndësishme të vendosura në këtë lagje janë: Prefektura, Bashkia, Gjykata e Prokuroria, Kryemyftinia, Rektorati i Universitetit "Luigj Gurakuqi", Biblioteka e shtetit "Marin Barleti", Gjumnazi "28 Nëntori", Shkolla e Parrucës (e shembur), kjo shkollë sot quhet Shkolla 9 vjecare "Ismail Qemali", Grand Hotel Evropa, Shatërvani, Monumenti Heronjtë e 2 Prillit, banka të ndryshme, etj. etj. firma tregtare të mëdha e të vogla që e bëjnë të gjallë jetën ekonomike të kësaj lagjeje.

Xhamia e Parrucës: Xhamia e vjetër

Kjo xhami ka qenë një ndërtesë guri e mirëmbajtur, data e ndërtimit nuk dihet. Nga të dhënat popullore duket se është ndërtuar në shekullin XVIII me fondet e familjes Juka. Kjo njihet një ndër fa-

miljet më të vjetra të kësaj lagjeje. Për vjetërsinë e kësaj xhamie flet edhe varri i Selman Dërgutit, arkëtar (haznedar) i Mustafa Pashës. Selman Dërguti vdiq në vitin 1221 hixhri (1816), kjo datë gjendet e gdhendur në mbishkrimin e gurit të varrit të tij që gjendej para portës së xhamisë së vjetër të Parrucës. Këtë e thekson Hamdi Bushati në librin “Shkodra dhe motet”.¹

Xhamia e vjetër nuk kishte ndonjë stil të dalluar, ose ndonjë zbukurim artistik. Kishte një kapacitet mesatar si xhamitë tjera të qytetit. Nga një fotografi e hershme e sheshit të Parrucës, e hoteleve dhe e xhamisë, duket xhamia, varret dhe një muslluk uji për abdes. Xhamia, oborri dhe varrezat kanë qenë të rrethuara me mur guri.

I bashkëngjitur me xhaminë ishte edhe godina e mejtepit. Ky u bë i njohur në kohën kur dha mësim Molla Fasli Zylja.

Imamët e myezinët më në zë të kësaj xhamie si dhe ligjëruesit më të shquar në vite kanë qenë:

Hafiz Salih, Ali Çnga, Hafiz Sait Çanga, Molla Fasli Zylja, Hafiz Murati, Hafiz Halim Rrustem Hajdari, Hafiz Hamdi Seit Çanga, Hafiz Ramadan Smajl Shiroka, Hafiz Riza Adem Boriçi, Sali Efendiu, Hafiz Xhevdet Zylja, Hafiz Hysni Puka, Hafiz Xhemal Çanga.

Varrezat e Parrucës

Hamdi Bushati thekson se në ato varreza janë eshtrat e personaliteteve të njohura të kulturës e të patriotizmit, të fisnikërisë e të trimërisë, të bujarisë e të bamirësisë, shqiptarë dhe të huaj. Populli i Shkodrës disa nga ato të vdekur i kujton me nderim. Me prishjen e varrezave shumë nga gurët historikë janë zhdukë. Disa gurë mermeri të sjellë nga jashtë, shpëtuan për një kohë, por të tjerët u thyen me maj: “... për fajin e brigadierëve të pagdhendur, të cilët as nuk pyetën fare në se disa nga gurët ishin të vlefshëm për historinë e vendit”.² Këtu kanë qenë varrosë tre valinj e komandantë të Vilajetit të Shkodrës: 1. Shefqet Pasha (1872, Vali i Shkodrës për të dytën herë), 2. Ali Hajdar Pasha (erdhi në Shkodër në vitin 1877 dhe vdiq në vitin 1879), 3. Hasan Riza Pasha, Vali e Komandant i Shkodrës, erdhi në vitin 1911, me gradën kolonel. Më 30 janar 1913 vritet tradhtisht duke dalë nga shtëpia e Esad Pashë Toptanit që gjendej në Parkun e sotëm “Luigj Gurakuqi”. Ka qenë varrosë tek Xhamia e Parrucës. Me nismën e

1. Hamdi Bushati, Shkodra dhe motet, Redaktorë: N. Bushati, F. Luli, I. Dizdari, M. Dërguti, Shtypshkronja “Rozafat”, Shkodër, 1998, fq. 197.

2. Hamdi Bushati, vepër e cituar.

Kryetarit të Bashkisë, Zenel Prodani, në vitin 1936, eshtrat e Hasan Riza Pashës u bartën në varrezat e Komaneve. Rivarrimi që bëri me një ceremoni madhështore. Sot ky varr gjindet në memorialin e ngritur në Sheshin e Parrucës, pranë Gjymnazit “28 Nëntori”...Varri i **Selman Dërgutit**, ka qenë para derës së vjetër të Xhamisë së Parrucës dhe ka pasë datën 1231 (1815), një nga varret e vjetër të kësaj xhamie. Varri i **Sali Efendi Hylos**, është nja nga protagonistët e Luftës së Miletit për mbrojtjen e Ulqinit ku ishte Myfti. Vdiq në Shkodër me 8 Xhemazul-ahar 1310 (1893), ditën e mërkurë, ora 4 allaturka.³

Xhamia e Parrucës e vitit 1936, me dy minare

Në vitin 1936 Zyra e Kryemyftinisë së qytetit pat hy në marrëveshje me Bashkinë për shpronësimin e varrezave të xhamisë në Fushë të Çelës që Bashkia donte t’i kthente në një park të madh, sikurse janë sot. Kundrejt kësaj Bashkia pranoi t’i paguante Kryemyftinisë 600 napolona ar. Kryemyftiu, Sali Myftija, i mbështetur në atë fond dhe i bindur se do ta ndihmonte popullata myslimane me kontribute të mjaftueshme, mori iniciativën të ndërtonte një xhami të re. Kjo u pat ndërtuar në bazë të projektit të inxhinier Sadi Pashollarit. Ka qenë një nga xhamitë më të bukura të Shqipërisë, me dy minare të holla e të larta afër 40 metra. Xhamia ka qenë themeluar me 16.V.1937 me një dua nga zëvendësi i Myftiut, Hafiz Halil Puka dhe me një bisedë të Hafiz Esat Myftisë në prani të autoriteteve dhe të popullit. Xhamia pat përfunduar në vitin 1943. Për kujdesin e ndërtimit të xhamisë dhe për mbledhjen e ndihmave që krijuar një komision i kryesuar nga Salih Efendi Myftija.

Nga një artikull në revistën “Kultura Islame” të vitit 1943, mësojmë se në këtë vit janë mbledhur nga populli bujar 100000 fr. shqiptarë dhe përsëri populli dha edhe 40000 fr. shqiptarë, tue shfaq dëshirën që në rast mosmjaftimi, janë gati të ndihmojnë edhe me shuma të tjera për deri sa të plotësohet siç lypet faltarja madhështore”.⁴

Xhamia mbas shumë sakrificash, përfundoi. Kjo xhami e hijshme në pjesën e brendshme u bojatis nga disa mjeshtrë italianë, hytben dhe disa punime tjera druri i përfunduan vëllezërit Karini. Shkrimet artistike të mihrabit dhe të kubeve i pat marrë përsipër mësuesi i mirënjohur Shefqet Kraja.

3. Të dhënat janë marrë nga libri i Hamdi Bushatit, “Shkodra dhe motet”, vepër e cituar.

4. Një iniciativë e lavdërueshme e Kryemyftiutisë së Shkodrës, Revista “Kultura Islame”, viti V, nr. 12, gusht 1943, faqe 215.

Por në vitin e mbrapsht 1967 kjo xhami shumë e bukurosh u shemb nga diktatura komuniste.

Mesxhidi i Parrucës,¹

Pas ditës së bardhë të 16 nëntorit, hapjes së Xhamisë së Plumbit, Myftiu i Shkodrës, Haxhi Faik Hoxha, bëri të gjitha përpjekjet për ngritjen e institucioneve fetare të shkatërruara në Shkodër dhe në fshatrat e rrethit. Kudo që të ishte e mundur u krijonte një vend për falje. Xhamina e Plumbit, e cila me ndihmat që dha populli dhe posaçërisht rinia, u përgatit për faljen e xhumasë së parë. Po kështu në shtëpinë e familjes Banja u sajua një sallë faljeje. Edhe salla e mbledhjeve të ndërtesës së Zyrës së Informatikës Ekonomike të Rrethit u muar për këtë qëllim. Falja në këtë mesxhid filloi në vitin 1993 dhe vazhdoi punën si e tillë deri sa u ndërtua xhamia e re e Parrucës, në vitin 2007. Në vitin 1996 deri në 2000 shërbeu për praktikant fetare të nxënësve të Medresesë "Haxhi Sheh Shamia". Në ditën e xhuma nxënësit e Medresesë zhvillonin praktikën fetare (djemtë), duke kryer detyrën e hatibit (ligjëruesit), të imamit dhe të myezinit. Ndërsa mesxhidi ishte i vogël e vendi i ngushtë, në fillim këtu bëheshin ceremonitë fetare të organizuar nga Myftinia, këndohej mevludi, mbaheshin ligjërata etj. Për faljen e bajramit shpesh herë, kur koha ishte e mirë, falja kryhej jashtë në lulishten e ndërtesës para mesxhidit.

Komuniteti Mysliman nuk ka emëruar imam zyrtarë për këtë mesxhid, por Myftinia e Shkodrës duke parë nevojën e domosdoshme që kishte lagja emëroi si imamë disa persona që e kryen detyrën pa shpërblim. Haxhi Faik Hoxha, Myftiu i Shkodrës, ka kryer detyrën e imamit në dy vaktet e mesditës dhe të akshamit, e sidomos të hatibit në të gjitha ditët e xhuma, në ditët e Bajramit dhe gjatë të gjitha teravive.

I pari imam i kësaj salle është Idmir Plaku, i cili sapo i kishte mbaruar studimet. Kanë prirë si imamë zotërinjtë Daut Shaba, Adem Bajri.

Shejh Haxhi Vehbi Gavoci gjatë kohës që ka qenë në Shkodër ka treguar rregullisht vasë në këtë sallë. Gjithashtu edhe vëllai i tij Haxhi Nuh Gavoci.

Në periudha të ndryshme kanë prirë si imam edhe mësuesi i Medresesë nga Egjipti Zotni Muhamed Ali, mësuesi nga Kosova Muhidin Ahmeti, Koordinator i Medresesë, nga Gostivari, Zotëri Etem Haliti.

Me mbarimin e punimeve të ndërtimit të xhami-

1. Të dhënat për mesxhidin e Parrucës u morën nga Zotëri Faik Hoxha, ish Myftiu i Shkodrës, datë 6 tetor 2008.

së së Parrucës, në vitin 2007, mesxhidi u prish sepse përfshihej në perimetrin e ndërtesës së xhamisë dhe të rrethimit të saj. Ai tashti nuk ekziston më.

Xhamia e re, e rindërtuar në vitin 2007.²

• Projekti u hartua nga arkitekt Enver Kotrri, konstruksionin e hartoi Ingj. Belkize Dibra, përpunues i tushimit të projektit është tekniku Adnan Bushati, ndërsa preventivues është tekniku M. Selmani, mjeshtrë i zbatimit është Inxh. Belkize Dibra dhe Hysejn Bushaj.

• Punimet e ndërtimit kanë filluar më 15 maj 2002 dhe kanë përfunduar në vitin 2007.

• Kapaciteti total është $297+139=436m^2 : 0,6$ vetë/ $m_2 = 727$ vetë, përafërsisht 800 vetë.

• Xhamia ka dy minare, në të dy anët e objektit me lartësi 38 metra nga toka.

• Në pjesën e brendshme janë katër kolona të mëdha me diametër 60 cm të mbështetura mbi bazamente beton armeje mbi të cilat mbështetet konstruksioni mbajtës.

• Sallat e faljes janë të shtruara me parket, kurse korridoret e shkallët me mermer.

Xhamia është e pajisur me mjete ndriçimi, vendin kryesor e zënë llambadarët që varen nga katër kupolat, llambadari kryesor është ai i kupolës qendrore, ndërsa në mure dhe jashtë ka mjete tjera ndriçimi.

E gjithë puna dhe shpenzimet janë përballuar nga bamirësi Haxhi Sait Fishta.

Imami i parë i kësaj xhamie ka qenë Zotëri Alban Kali, ish nxënës i Medresesë, i cili ka kryer studimet e larta në Turqi. Me kalimin e Zotëri Albanit në një detyrë tjetër, mbas tij imam u emërua Zotëri Naim Drijaj, i cili ka kryer studimet e larta islame në Turqi.

Përrurimi i xhamisë u bë me datën 23.3.2007 me një ceremoni madhështore dhe me shumë të ftuar nga qyteti, e nga të gjitha rrethet e vendit. Pati shumë miq të ardhur nga vendet tjera.

Ishte një ditë e bardhë, të gjithë ishin të gëzuar, por më krenar ndihej bamirësi Sait Fishta, i cili nga pjesa më e shëndoshë e pasurisë së tij kishte dhënë aq shumë për të realizuar një ëndërr të madhe të të gjithë besimtarëve dhe të gjithë banorëve të

2. Materiali është nxjerrë nga të dhënat me shkrm nga mj - shtri zbatues Hysejn Bushaj dhe Inxh. Belkize Dibra, Shkodër më 7.10.2008

Shkodrës dhe më gjerë, për ndërtimin nga e para të Xhamisë së Parrucës.

Myftiu i Shkodrës Imam Ndiçim Sulejmanin mbajti përshëndetjen e rastit. Ai mes tjerash tha i emocionuar: "...Kaluan plot 40 vite që nga dita kur dora e zezë vrastare e faraonëve të kuq komunistë, dhunoi duke e rrënuar xhaminë e qytetarisë shkodrane, xhaminë e traditës së vëllazërimit dhe të bashkimit, vendtubimin e njerëzve të shquar, dijetarëve, intelektualëve e besimtarëve të nderuar të qytetit të lashtë besimtar.

Në Kuranin Famëlartë lexojmë: "E kush mund të jetë më mizor se ai që në xhamitë e All-llahut pengon të përmendet emri i Tij (të bëhet ibadet) dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre."- (2:114).

E, pikërisht sot, ne dëshmojmë se si reja e zezë e mizorisë femohuese, që kishte okupuar këtë vend, u largua dhe rrezet e dritës së besimit filluan të ndriçojnë më shumë se asnjëherë tjetër, ato rreze i ndejmë më pranë se kurrë, këtu, në Shkodër, në këtë shesh, pranë kësaj xhamie, ku nga minaret e bardha të saj do të thirret sërish ezani i besimit, ezani i njësitimit të Zotit, ezani i dashurisë, ezani i përparimit dhe i qytetërimit islam!

Shpresa e baballarëve tanë që shkuan me pikëllim, e hoxhallarëve të shumtë që shërbyen në këtë xhami, të cilët ia shtuan Shkodrës krenarinë dhe ia lartësuan asaj emrin, nuk u shua asnjëherë në rilindjen dhe rizgjimin e ndërgjegjes besimtare në këtë vend, as dhuna femohuese e sistemeve ateiste s'e fshiu dot nga shpirtat dhe zemrat besimtare të qytetarëve shkodranë.

Ja, sot, me lejen e All-llahut dhe mbarësinë e Tij, po përurojmë pas 40 viteve tragjike, xhaminë madhështore të Parrucës, që i jep dritë, mbarësi e begati besimtarëve e qytetarëve shkodranë, Shkodrës tonë të dashur.

E gëzofshim xhaminë e re!"

Në xhaminë e re të Parrucës filluan të organizohen shumë ceremoni fetare, falja e përditshme e namazeve, këndimi i mevludeve, lidhja e martesave të reja, koncerte e shumë e shumë pritje miqsh e vizitorësh.

Me 12 prill 2007, ditën e enjte, pas namazit të iqindisë, u zhvillua ceremonia e madhe e Mevludë Sherifit. Në këtë ceremoni morën pjesë Myftiu, Imam Ndricim Sulejmani i shoqëruar nga hoxhallarët e vjetër dhe imamët tjerë të xhamive të qytetit, e shume besimtarë që kishin ardhur me këtë rast.¹

1. Gazeta udha Islame, nr. 55, prill 2007, fq. 2

Xhamia e zbukuruar nga brenda e nga jashtë, viti 2008

Që para përfundimit të ndërtimeve pati ndërhyrje pranë Tikas për të gjetur fonde për zbukurimin e xhamisë, nga Islam Dizdari, Arif Qerozi dhe Shuajb Bashkan. Këto çuan në bisedimet dhe planifikimet zyrtare mes Myftinisë së Shkodrës dhe TIKËS.

Haxhi Bashkim Bajraktari, Myfti i Shkodrës i shkruan TIKË-s: "... ju paraqesim Ju kërkesën tonë për të na ndihmuar në kompletimin dhe përfundimin e një ndër xhamive me të lashta në qytetin e Shkodrës...është e nevojshme që kjo xhami të dekorohet me ato motive shkrimesh dhe kaligrafi të pjesëve kuranore që ka pasur ose të paktën t'i përshataten në maksimum."²

Me 31 dhjetor 2007 Myftiu i Shkodrës, Ndricim Sulejmani, së bashku me të gjithë stafin e Myftinisë pritën në zyrë koordinatorin e agjencisë "TIKA" me qendër në Tiranë, Zotëri Murat Akarsu dhe ekipin dizajnues të përbërë nga pesë veta. Nën drejtimin e Dr. Alim Korkmaz, grupi i dizajnit po punon me vrull për ta përfunduar xhaminë në afatet e duhura.

"Punimet ka një muaj që po vazhdojnë dhe me shpejtësinë që po ecet, shpresojmë që të përfundojnë në afatet e caktuara."³

Projekti i paraqitur dhe realizimi i tij është shumë i bukur, ai është vepër e Profesorit Mehmet Artan të Universitetit të Ankaras. Zbukurimi i xhamisë brenda e jashtë përfundoi

Tani kemi një xhami madhështore, jo vetëm pamja e saj e jashtme, jo vetëm konstruksioni, jo vetëm madhështia e saj duken që larg, por besimtari ose vizitori i zakonshëm apo specialisti që hyn brenda sheh në këtë xhami nivelin e lartë të një mjedisi qetësues, çlodhës dhe frymëzues për shpirtin e tij, por edhe për trupin që prehet i qetë në këtë ambient paqeje.

2. Shkresë e Myftinisë së Shkodrës, Myftiut Haxhi Bas - kim Bajraktari drejtuar Shoqatës Tika, me Nr. Prot 152, datë 03.01.2006, Arkivi i Myftinisë, dosja e vitit 2006.

3. Haxhi Fejzi Zaganjori, "Xhamia e Parrucës përgatitet për përuhimin e dytë", Gazeta "Udha Islame", nr. 65, Shkurt 2008, fq. 5.

OKB: ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME VOTOI PRO KËRKESËS SË SERBISË

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi kërkesën që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të japë opinionin e saj, nëse shpallja e pavarësisë nga Kosova përputhet apo jo, me të drejtën ndërkombëtare.

Rezultati i votimit sot në Asamblenë e Përgjithshme ishte 77 vota pro, 74 abstenime dhe 6 vota kundër.

Shumë nga vendet që abstenuan apo që votuan kundër rezolutës për t'ia referuar çështjen Gjykatës, thanë se e bënë këtë, pasi Serbia po i kalonte një organi juridik një çështje që në thelb është politike.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me seli në Hagë është organi kryesor juridik i Kombeve të Bashkuara.

Shtetet e Bashkuara ishin një prej 6 vendeve që votuan kundër rezolutës. Përfaqësuesja amerikane Rozmari Di Karlo tha se kërkimi i opinionit të gjykatës për këtë çështje do të ishte "i panevojshëm dhe i dëmshëm", dhe ajo shtoi se Shtetet e Bashkuara kanë besim se njohja e pavarësisë së Kosovës nga një numër gjithnjë e më i madh vendesh është në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

"Nga pikëpamja praktike, pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme. 48 vende e kanë njohur Kosovën si një shtet të pavarur, përfshirë 22 nga 27 vendet e Bashkimit Evropian,"- tha zonja Di Karlo.

Britania abstenoj nga votimi dhe më pas, ambasadori Xhon Sojers tha se ndërsa qeveria e tij e mbështet gjykatën ndërkombëtare, ajo është skeptike për sa i takon qëllimit të të kërkuarit të një vendimi, që nuk ka fuqi ligjore, për këtë çështje.

"Për ne nuk ka kuptim kërkesa e bërë nga Serbia. Opinioni këshillues nuk mund të jetë në vetvete përcaktues për statusin e Kosovës,"- tha ai.

Ministri i Jashtëm i Serbisë Vuk Jeremiç e paraqiti rezolutën në Asamble, duke thënë se votimi kundër saj do të thoshte se asgjë nuk mund të bëhet ndaj gjithë atyre që kërkojnë shkëputje dhe argumentojnë se rasti i tyre është i veçantë.

MARRËVESHJA MES SHTETIT DHE KOMUNITETEVE FETARE

Marrëveshje mes qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare në Shqipëri.

Kryeministri Berisha mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes mes qeverisë shqiptare dhe komuniteteve fetare në Shqipëri.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm drejtuesit e komuniteteve fetare në Shqipëri, Kryetari i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, Haxhi Selim Muça. Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Anastas Janullatos, Kryegjyshi i Kryegjyshit të Botërore të Bektashinjve, Baba Dede Reshat Bardhi dhe Arqipeshkvi i Durrësit dhe Tiranës, Imzot Rrok Mirdita. Në ceremoni morën pjesë edhe Ministri i Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ylli Pango dhe Kryetari i Komitetit të Kulteve, Rasim Hasanaj.

Kryeministri vlerësoi se kjo marrëveshje që firmoset mes qeverisë shqiptare dhe autoriteteve më të larta fetare në vend shënon një kapitull të ri në marrëdhëniet midis shtetit shqiptar dhe besimeve fetare në Shqipëri.

“Nuk ka patur dhe nuk ka njollë më të zeze në tërë historinë tonë kombëtare se sa barbaria ateiste e imponuar”, u shpreh Kryeministri duke iu referuar ndalimit të besimit fetar gjatë regjimit diktatorial.

Kryeministri Berisha vlerësoi personalitetet fetare, të cilat me shpejtësi rivendosën traditën dhe gjënë më të çmuar që ka kombi shqiptar, tolerancën, harmoninë dhe bashkëpunimin fetar.

Marrëveshja e nënshkruar krijon lehtësira fiskale duke përjashtuar komunitetet fetare nga taksat dhe mundëson përshpejtimin e punës për rikthimin dhe kompensimin e pronave të tyre.

Gjithashtu marrëveshja parashikon hartimin e një ligji specifik për financimin e bashkësive fetare nga shteti duke u bazuar në përvojën europiane për mbështetjen e veprimtarive të bashkësive fetare.

Kryetari i Komitetit të Kulteve, Rasim Hasanaj duke falenderuar qeverinë për mbështetjen e vazhdueshme që u ka dhënë komuniteteve fetare në vend, ndërsa theksoi se në projektligjin për fenë që do të përgatitet do të gjejnë pasqyrim edhe problemet që do të kenë bashkësitë dhe grupet e tjera fetare.

Z. Hasanaj tha se vetëm gjatë këtij viti qeveria ka akorduar 2 milionë dollarë për resturimin e objekteve të kultit pa llogaritur investimet për infrastrukturën rrugore që çon në objektet e kultit dhe sidomos në vendet e pelegrinazhit.

Përfaqësuesit e komuniteteve fetare shprehën falenderimet e tyre ndaj qeverisë për ndihmën që u ka dhënë atyre gjatë gjithë kësaj kohe.

Në fjalën e tij Kryeministri Berisha u shpreh:

Marrëveshja që ne sot firmosim me autoritetet më të larta fetare të vendit shënon një kapitull të ri në marrëdhëniet midis shtetit shqiptar dhe besimeve fetare në Shqipëri. Por nuk mund të mos theksoj se kjo marrëveshje në vetvete mbart detyrimin madhor të këtij shteti për t'u paraqitur një ndjesë të thellë, një falje të gjithë atyre klerikëve shqiptarë, besimtarëve shqiptarë që për besimin tek Zoti, tek e vërteta u flijuan, u sakrifkuan, por qëndruan të pamposhtuar, pasuruan altarën e martirëve të këtij kombi, me vlera që ndrisin dhe do ndrisin përjetë. Është me vend për të paraqitur një ndjesë ndaj të gjithë besimtarëve shqiptarë që një regjim, që një shtet me një akt të paprecedent në këtë shkallë në histori, jo të kombit, por të Europës i privoi ata nga mundësia e shërbimit të fundit, i privoi ata nga mundësia e ndarjes nga familja dhe shoqëria me shërbimet që meritonin.

ZEMRA ARTIFICIALE

Zemra artificiale e ideuar për të mënjanuar vështirësinë në dhurimin e organeve pritet të jetë shpresa e 20 mijë vetëve për një vit

Deklarohet se zemra artificiale e ideuar për të shmangur vështirësitë në dhurimin e organit do të bëhet gati për provat klinike në vitin 2011.

Studiuesit Europeanë që përgatitën prototipin, që është plotësisht artificial, njoftuan se do të fillonin me provat klinike të zemrës në vitin 2011.

Prodhimi i zemrës artificiale do të bëhet në një vend afër Parisit nga specialisti i transplantimit të zemrës Alain Carpentier, firma Truffle dhe firma Carmat biomedikale në mbështetje të agjencisë Franceze të zbulimeve të reja.

Shkencëtari Carpentier në një deklaratë të bërë agjencisë AFP tha: "Tashmë kemi kaluar nga faza e studimit në atë të zbatimit klinik dhe pas një pune 15 vjeçare do të fillojmë prodhimin e zemrës artificiale"



Në zemrën artificiale e bërë nga indet e kafshëve në të cilat janë kryer funksione kimike përdoret një teknologji e ngjashme me protezën e prodhuesve të kapakëve të zemrës e zhvilluar nga Carpentier dhe e përdorur gjerësisht në mbarë botën.

Carpentier theksoi se indet e kafshëve të përdorura në zemrën artificiale janë ideuar në mënyrë që të pengojnë refuzimet për këtë organ të sistemit dhurues të sëmurit.

Carpentier, i cili theksoi se zemra artificiale deri tani është provuar edhe te kafshët edhe me rrugë stimulimi dixhital, tërheq vëmendjen në faktin që gjatë provave nuk ka pasur komplikacione.

Shpresohet që zemra artificiale e cila ka pamjen e një zemre të vërtetë, të zgjidh problemin e 20 mijë dhuruesve të zemrës për çdo vit në mbarë botën.

VITAMINA B NË ALZHEIMER NUK KA INFLUENCIM

Në një projekt në të cilin morën pjesë të sëmurë Alzheimer në gradë të lehtë – të mesme u vu re se marrja e vitaminës B në doza të larta nuk kishte ndonjë ndikim tek i sëmuri.

Shkencëtarët u ndalën në vitaminën B meqenëse kishte ulur shkallën e amino acidit e parë në lidhje me dëmin e molekulave të trurit, të ngjashme me atë në Alzheimer. Në fund të studimit u vu re që

mes të sëmurëve të dhënë me vitaminë B dhe plassebo nuk kishte ndonjë dallim përsa i përket prapambetjes së kujtesës, përqëndrimit, gjuhës dhe orientimit.

Në punimin e botuar në “Journal of the American Medical Association” studiuesit theksuan se është e nevojshme që këto vitamina të mos përdoren nga të sëmurët Alzheimer.

Autori i këtij punimi, profesor Paul Aisen i shkencave Neurologjike të Universitetit San Diego në Kaliforni, në një bisedë telefonike theksoi se kjo ide nuk ka dhënë dobi në kurën Alzheimer. Në këtë kurim kemi nevojë emergjente për një ide edhe më të mirë.

Sipas shoqërisë Alzheimer në SH B A afërsisht 5.2 milion njerëz janë të sëmurë nga kjo sëmundje. Sëmundja zë vend në radhën e gjashtë mes shkaqeve të vdekjes në gjithë botën.

“Njerëzit duhet ta dinë që çdo lloj kure që nuk është vërtetuar aq sa mund të sjellë dobi mund të sjellë edhe dëm., edhe sikur të ketë dalë në tre në shitje si sipliment në farmaci apo në vende ku shiten materiale ushqimore të shëndetshme.”

Në punimin e bërë në datat Shkurt 2003 – Dhjetor 2006 morën pjesë 340 persona të sëmundjes Alzheimer. 202 individëve iu dha kombinimi i vitaminës B6 me B12.

Dy profesorët e universitetit të Oxfordit në Angli Robert Clarke dhe Derrike Bennet në lidhje me këtë temë thanë: “Akoma nuk dihet shkaku i prerë në lidhje me përcaktimin e ndikimit pozitiv të vitaminës B mbi shpejtësinë e prapambetjes informacioni në punimin e përbashkët të sëmundjes Alzheimer. Përderi sa të mos kemi të dhëna të reja nuk mund të kemi një përcaktim të plotë”

Sipas Aisen studiuesit tashmë duhet të heqin dorë nga të menduarit e homosteinës dhe duhet të përqëndrohen në në patologjinë specifike që përfshin edhe pllakën dhe lajën.



70 VJETORI I MAKINËS SË FOTOKOPJES

Sipas të dhënave të marra nga Xerox, firma feston 70 vjetorin e shpikjes së fotokopjes. E pranuar si një nga gjetjet më të rëndësishme të kohës, makina e fotokopjes ndryshoi formën e ndarjes së informacionit dhe në të njëjtën kohë krijoi një treg që i kalon 100 miliard xhiro në vit. Firma studiuuese e pavarur Info Trends parashikon që çdo vit me makineritë e zyrave në katër anët e botës, ka shtypur dhe ka shumëfishuar 3.1 trilion letër në formë dokumentesh.

Chester Carlson, i cili njihet edhe si shpikësi i teknologjisë së kopjimit e cila krijoi një revolucion në botë, ka arritur të marrë pamjen e parë kserografike në laboratorin që gjendej në Neë York Astoria me shkrim "10 - 22 - 38 Astoria", 70 vjet më parë më 22 tetor 1938.

Në kohën që pamjen e parë xerografike Chester Carlson punonte si asistent në një zyrë regjistrimi. Chester Carlson vazhdimisht shtypte dokumente. Atëherë për shumëfishimin e një dokumenti nevojitej ose fotografimi ose kopjimi me shkrim. Duke e parë se një punë e tillë është shumë e vështirë Carlson filloi kërkimet për të gjetur një rrugë më të lehtë për kopjime.

Duke ndjekur kërkimet shkencore të shkruara mbi fotografimin, Carlson filloi të bënte prova në lidhje me këtë temë. Më pas ai bëri prova elektrostatische mbi materialet me veçori dritëpërçuese dhe zbuloi që materialet pasqyroheshin në dritën elektrike.

Kjo gjetje u quajt "Xerografi" një fjalë kjo greke e përbërë nga dy fjalë "e thatë" dhe "shkrim". Firma e quajtur Haloid që merrej me shitjen e materialeve fotografike, vendosi të investonte për këtë gjetje pasi kuptoi rëndësinë e gjetjes që kishte bërë Chester Carlson. Pas një kohe të shkurtër doli në treg makineria e parë fotokopjuese.

Firma Haroild në vitin 1961 e ndryshoi emrin në "Xerox Corporation."



Auto Servis ÇIMI



Lyerje
Luçidim



Adresa:

L: Naim Gjylbegu
Rr: Fahri Ramadani
Pranë shkollës "Oso Kuka"

Mobil/Cel: 00355 (0) 69 2252694

*Këtu mund të jetë
reklama juaj*

*Këtu mund të jetë
reklama juaj*

**Këtu mund të jetë
reklama juaj**

*Këtu mund të jetë
reklama juaj*

*Këtu mund të jetë
reklama juaj*

Firma ILIRIA sh.p.k.
me qendër në Shkodër



Firma Ilir Muçaj sh.p.k.
me qendër në Shkodër

**Tregton artikuj të
ndryshëm ushqimorë
dhe industriale me
shumicë dhe pakicë.**



Pajisje për ambiente lokalesh
Prodhim dyer e dritare
Dhoma fëmijësh
Pajisje kuzhine
Pajisje zyrash
Dhoma gjumi

Mobil/Cel: 00355 (0) 69 2523565

Mobil/Cel: 00355 (0) 68 4067440

Piceri "Dari"



Adresa: Pranë Medresesë "H.Sh.Shamia"
dega e vajzave
Cel: +355 (0) 225 17 81

Farmaci "Parruca"



*Përberë në dispozicion
të qytetarve me përkushtim!*

Tel: 00355 (0) 224 79-80

Piceri "Ismeti"



Adresa: Pranë teatrit "Migjeni"
Cel: 069 21 01893

Albtiefbau Company



Ndertime rrugore
Ndertim ura dhe vepra arti
Ndertime hidraulike e hidroteknike
Ndertime civile dhe ekonomike
Prodhim-material ndertimi
Impiante teknologjike dhe te veçanta
Vepra te veçanta e punime speciale.

Tel/Fax: +355 22 43849
E-mail: albtiefbau@albtiefbau.com